# DOKUMENTAT STANDARDE TË TENDERIT PËR

# PROCEDURËN E HAPUR

# SHËRBIME[1]

**” Përmiresimi i sistemit të faturimit dhe sigurisë, moduleve të taksave, leximeve dhe pagesave me palët e treta, mirëmbajtje dhe monitorim i sigurisë së sistemit dhe moduleve ”**

[1] **Në rastet e mosparashikimeve konkrete në këtë set dokumentash autoriteti /enti kontraktor do ti referohet parashikimeve të legjislacionit dhe rregullave të prokurimit publik në fuqi.**

## NJOFTIME

### NJOFTIMI PARAPRAK I INFORMACIONIT/ NJOFTIMI PERIDIOK I INFORMACIONIT

*(Për t'u Plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor nëse aplikohet)*

**1.1 Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor**;

Emri ____________________________________________

Adresa ____________________________________________

1.2 **Lloji i Autoritetit/Entit Kontraktor:**

| | |
|---|---|
| Institucion qendror<br>□ | Institucioni i pavarur<br>□ |
| Njësi e autoriteteve vendore<br>□ | Të tjera<br>□ |

1.3 **Kategoria e Autoritetit/Entit Kontraktor:**

| | |
|---|---|
| Autoritet/ent kontraktor që prokuron për nevoja të veta<br>□ | Organ Qendror blerës<br>□ |
| I deleguar<br>□ | Të tjera<br>□ |

**1.4 Emri dhe adresa e personit të kontaktit**:

Personi (at) përgjegjës për prokurimin: ____________________________________________
Tel/faks ____________________________________________________________
E-mail ____________________________________________________________

**1.5 Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër dhe kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP):**

______________________________________

**1.6 Lloji i procedurës së prokurimit:** ____________________________

**1.7 Tipi i kontratës**:____________________________________________

**1.8 Fondi limit i përllogaritur për këtë kontratë/marrëveshje kuadër/Fondi limit i përllogaritur për këtë objekt siç është planifikuar në parashikimin buxhetor të Autoritetit/Entit Kontraktor**

(*në rastin e marrëveshjeve kuadër ose kontratave shumëvjecare*) :
___________________________________________________________________

**1.9 Kohëzgjatja e përafërt e kontratës/marrëveshjes kuadër :**________________________________

**1.10 Përshkrimi i shkurtër i kontratës/marrëveshjes kuadër dhe/ose Lotit (eve), nëse përdoren:**
_____________________________________________________________________________________
__________________________________________________

**1.11. Lloji i Marrëveshjes Kuadër, nëse është rasti:**
_____________________________________________________________________

**1.12 Kohën e përafërt për zhvillimin e procedurës së prokurimit:**
__________________________________________________________

**1.13 Informacion tjetër që konsiderohet i dobishëm nga autoriteti/enti kontraktor:**_____________________________________________________________________________
_______________________________________________________________

*(Për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor )*

**NJOFTIMI I KONTRATËS**

**Seksioni 1: Autoriteti/Enti Kontraktor**

### 1.1 Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor

| | |
|---|---|
| Emri: | Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a. |
| Adresa: | Rruga e Kavajës,Ndërtesa nr.133,Njësia Administrative 6,Kodi Postar 1027,Tiranë |
| Tel/Faks: | 0 800 44 88 |
| E-mail: | info@ukt.al |
| Adresa e ueb-faqes: | www.ukt.al |
| Personi/at përgjegjës për prokurimin: (emri, e-mail) | A.Kocaqi<br>drejtoriaeprokurimeve@ukt.al |

### 1.2 Lloji i Autoritetit/Entit Kontraktor:

| | |
|---|---|
| Institucion qendror | Institucioni i pavarur |
| ☐ | ☐ |
| Njësi e autoriteteve vendore | Të tjera |
| ☐ | **x** |

### 1.3 Kategoria e Autoritetit/Entit Kontraktor:

| | |
|---|---|
| Autoritet/Ent kontraktor që prokuron për nevoja të veta | Organ Qendror blerës |
| x | ☐ |
| I deleguar | Të tjera |
| ☐ | ☐ |

**1.4. Kontratë në bazë të një marrëveshje të posaçme midis Shqipërisë dhe një shteti tjetër:**

**Po** ☐ **Jo** **x**

**1.5 Kontratë që bashkëfinancohet nga një organizatë ndërkombëtare ose një institucion financiar ndërkombëtar:**

**Po** ☐ **Jo** **x**

**1.6 Kontratë e rezervuar :**

**Po** ☐ **Jo** **x**

**Seksioni 2: Objekti i Kontratës: "Përmiresimi i sistemit të faturimit dhe sigurisë, moduleve të taksave, leximeve dhe pagesave me palët e treta, mirëmbajtje dhe monitorim i sigurisë së sistemit dhe moduleve "**

**2.1 Numri i referencës së procedurës/Lotit (eve) REF- 20140-09-17-2024**

- **2.2 Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP)**
- Sistem faturimi 48444100-3

**2.3 Lloji i Kontratës: "Kontratë Publike për Shërbime"**

**2.4 Kontrata në bazë të Marrëveshjes Kuadër:**

Po ☐ Jo ☐

**2. 5 Lloji i Marrëveshjes Kuadër:**

**Me një Operator Ekonomik** ☐
**Me disa Operatorë Ekonomikë** ☐
**Të gjitha kushtet janë të përcaktuara** Po ☐Jo ☐

**2.6 Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik:**

Në rastin e Marrëveshjes Kuadër me një Operator Ekonomik, kur janë përcaktuar të gjitha kushtet, më poshtë të jepen arsyet e përzgjedhjes

| |
|---|
| |

**2.7 Marrëveshje Kudër me disa operatorë ekonomikë:**

**Numri i operatorëve ekonomikë, me të cilët do të lidhet Marrëveshja Kuadër: ___** (*Këtu, duhet të përcaktohet numri maksimal i operatorëve ekonomikë, me të cilët do të lidhet Marrëveshja Kuadër)*

**2.8 Kushtet që duhet të zbatohen në rastin e rihapjes së konkurrimit:**

| | | |
|---|---|---|
| | | |

**2.9 Autoriteti Kontraktor/Autoritetet kontraktore ose Enti/Entet kontraktore që do të jenë palë në Marrëveshjen Kuadër:** *(këtu duhet të listohen të gjitha autoritetet/entet kontraktore që do të jenë palë përfituese nga marrëveshja kuadër)*

________________________________________________

**2.10 Përshkrimi i shkurtër i kontratës / Marrëveshjes Kuadër**

1. Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: *144.043.333,3* (njeqind e dyzet e kater milion e dyzet e tre mije e treqind e tridhjete e tre presje tre ) lekë pa tvsh.

Vlera e fondit Limit ne monedhen nderkombetare Euro sipas kursit te Bankes se Shqiperise eshte 1.450.879,67(nje milion e katerqind e pesedhjete mije e tetqind e shtatedhjete e nente presje gjashtedhjete e shtate) euro pa TVSH

Kursi zyrtar i kembimit sipas Bankes te Shqiperise datë 17.09.2024 është 99.28 euro.

2. Në rastin kur, objekti i prokurimit përbëhet nga disa artikuj, **shumatorja e çmimeve për njësi është** _________

3. Burimi i financimit: Të ardhurat e UKT sha

**Shenim: Financimi i objektit të prokurimit do të bëhet për një periudhe tre vjecare përkatësisht 2024,2025,2026**

4. Kodi Output: 6022099

5. Tipi:

| | | |
|---|---|---|
| Investime ☐ | Kodi: | Vlera: |
| Shërbime **x** | Kodi: 602 | Vlera: 144.043,333.3 |

**2.11 Kohëzgjatja e kontratës ose afati i zbatimit të kontratës:**

**36 muaj nga date e nenshkrimi i kontrates**

**2.11.1. Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuadër:**

| |
|---|
| **Kohëzgjatja në muaj: ____** *ose* **ditë:_____(nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër)**<br><br>*Ose* **fillon më ____/____/________ (d/m/v)**<br><br>**mbaron më ____/____/________ (d/m/v)** |

**2.12 Vendi i dorëzimit të objektit të kontratës:**

**2.13 Ndarja në Lote:**

**Po** □ **Jo** **x**

*Nëse po,*

**2.14 Përshkrimi i shkurtër i Loteve:**

(objekti dhe fondi limit për secilin Lot)

1.____________________________

2.____________________________

**2.14.1 Një ofertues mund të aplikojë për:**

□ një Lot,

□ disa Lote,

□ të gjitha Lotet.

Për secilin Lot duhet të paraqitet një ofertë e veçantë.

**2.14.2 Numri maksimal i Loteve për ofertues:**

Specifikoni numrin maksimal të Loteve që mund t'i jepen një ofertuesi __________

**2.14.3 Kriteret/rregullat që duhet të zbatohen për të përcaktuar Lotet që do t'i jepen ofertuesit:**

Specifikoni kriteret për të përcaktuar Lotet që do të jepen, kur ofertuesi shpallet fitues i më shumë Loteve sesa numri maksimal i lejuar në pikën 2.14.2.

________________________________________________________________________________

________________________________________________________________________________

______________________________________________________________________________

**2.14.4 Kombinimi i Loteve në një kontratë/kontrata të përbashkëta (Kur të njëjtit ofertues mund t'i jepet më shumë se një Lot):**

**Po** ☐ **Jo** **X**

Nëse po, specifikoni grupin e Loteve që mund të kombinohen

______________________________________________________________________________________
______________________________________________________________________________________
________________

**2.15 Pranohen variantet:**

**Po** ☐ **Jo** ☐

**2.15.1 Pranohet nënkontraktimi:**

**Po** ☐ **Jo** ☐

**Nëse lejohet nënkontraktimi, specifikoni përqindjen e lejuar për nënkontraktim:**
*(nuk lejohet nënkontraktimi në një masë më të madhe se 50 % e vlerës së kontratës)*
________________________________

**2.15.2 Autoriteti/Enti Kontraktor do të kryejë pagesa direkte tek nënkontraktori:**

**Po** ☐ **Jo** ☐

**Shënime të tjera** *(nëse vlerësohen të nevojshme nga autoriteti/enti kontraktor)*

___________________________________________________________________________
______________________________________________________________________________________
_______________________________________________________________________________

**2.16. Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera:**

Specifikoni nëse autoriteti/ enti kontraktor kërkon që detyra/punë/aspektet kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjë prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë,për të cilin ofertuesi nuk lejohet të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera.

**Po** ☐ **Jo** **X**

**Nëse po, të specifikohet detyra, puna, aspektet kritike, që nuk lejohet mbështetja:**

_______________________________________________________________________

**2.17 <u>Gjatë procesit të prokurimit në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) përdoren standardet e përgatitura nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit:</u>**

**Po** ☐ **Jo** **X**

**<u>2.18. Gjatë procesit të prokurimit në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK), në rast se standardet nuk janë të zbatueshme, merret një miratim paraprak nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit:</u>**

**Po** □ **Jo** **X**

**Seksioni 3: Informacione juridike, ekonomike, financiare dhe teknike**

**3.1 Sigurimi i ofertës:** (*e zbatueshme në rastin e procedurave të prokurimit me një vlerë më të lartë se sa prokurimi me vlerë të vogël).*

Në rastin e kontratave sektoriale, enti kontraktor, në bazë të diskrecionit të tij, mund të kërkojë sigurimin e ofertës edhe për procedurat nën kufirin e lartë monetar.

Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Sigurimit të Ofertës, sipas Shtojcës 3.

Shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës 2.880.866,66 (dy milion e teteqind e tetedhjete mije e teteqind e gjashtedhjete e gjashte presje gjashtedhjete e gjashte ) leke pa TVSH.

Shuma e kerkuar e sigurimit te ofertes ne monedhen nderkombetare Euro sipas kursit te Bankes se Shqiperise eshte 29.017,59 (njezet e nente mije e shtatembedhjete presje pesedhjete e nente) euro pa TVSH.

Kursi zyrtar i kembimit sipas Bankes te Shqiperise datë 17.09.2024 është 99.28 euro.

Në rastet e paraqitjes së ofertave për Lote të veçanta, vlera e sigurimit të ofertës për secilin Lot do të jetë si më poshtë:

Loti 1 ____________________ (*shuma,monedha)*
*Loti 2* ____________________ *(shuma monedha)*

**3.1.2** Autoriteti/ enti kontraktor pranon vlerën e pagesës së sigurimit të ofertës nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit/entit kontraktor __________________________(*të shënohet numri i llogarisë bankare të autoritetit ose entit kontraktor*)

| Nr | EMERTIMI | Numri I Llogarise | IBAN |
|---|---|---|---|
| 1 | BKT | 403003524CLPBCLALLAW | AL372051103800 3524CLPBCLALLA |
| 2 | Raiffesein | 002003376 | AL192021117800 00000002003376 |
| 3 | CREDINS | 1005371 | |

**3.1.3** Autoriteti/enti kontraktor pranon pagesën e vlerës së sigurimit të ofertës nga ofertuesi edhe në formën:
i. garancisë bankare X
ose
ii. nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente **X**

**3.2 Periudha e vlefshmërisë së ofertës: 150** *(dite)*

**Seksioni 4: Procedura**

**4.1 Lloji i procedurës:** ___________________

**4.2. Është përdorur njoftimi paraprak / periodik i informacionit:**

**Po** □ **Jo** **X**

Nëse Po, numri i referencës është _____________________

**4.2.1**.**Aplikohet shkurtimi i afatit për pranimin e ofertave** *(e aplikueshme për procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar).*

**Po** □ **Jo** **X**

**4.3 Procedurë e rishpallur:**

**Po** **Jo X**

Nëse është një procedurë e rishpallur, ju lutemi plotësoni të dhënat identifikuese të procedurës së anuluar:

b) Objekti i prokurimit të procedurës së anuluar të prokurimit

c) Fondi limit i procedurës së anuluar të prokurimit :

**4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:**

A) **Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto** □

Sipas rëndësisë:

çmimi □ pikët□□

_______□□ pikët □□

_______ □ □ pikët □□

_______ □□ pikët □□

Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për secilin kriter të përcaktuar të vlerësimit.

**OSE**

B) **oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X**

**Në rastin e marrëveshjes kuadër, kur do të përdoret kriteri i vlerësimit të çmimit për njësi, për qëllime krahasimi, vlerësimi i ofertave të paraqitura do të bëhet në bazë të shumatores së çmimeve për njësi (***Kjo, metodë vlerësimi nuk do të përdoret nga autoritetet/entet kontraktore kur sasitë janë të llogaritshme në bazë vjetore, sipas eksperiencës së mëparshme, dhe kur marrëveshja kuadër përdoret për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve të vazhdueshme. Në këtë rast, çmimi i ulët do të vlerësohet me vlerën totale më të ulët të ofruar).*

**4.5 Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave:**

Data: **21.10.2024** *(d/m/v)* **ora 10:00**

Vendi: **www.app.gov.al**

**Kur oferta kërkohet të paraqitet në mënyrë elektronike, ofertuesit duhet ta paraqesin atë në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të APP, www.app.gov.al.**

**Informacioni mbi ofertat e paraqitura në mënyrë elektronike i transmetohet të gjithë atyre Operatorëve Ekonomikë që kanë paraqitur oferta, me kërkesë të tyre.**

**4.6 Aplikohet shkurtimi i afatit për pranimin e ofertave, sipas parashikimeve në nenin 42 pika 6 të LPP** *(e aplikueshme për procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar).*

**Po** ☐ **Jo**

Nëse po, argumentoni arsyet e shkurtimit të këtij afati:

| |
|---|
| |

**4.7 Gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat:**

**Shqip** **X** **Anglisht**

**Seksioni 5: Informacione shtesë:**

**5.1 Dokumente me pagesë** *(zbatohet vetëm për procedurat që nuk zhvillohen me mjete elektronike):*

**Po** ☐ **Jo** **X**

*Nëse po*

**Monedha** __________ **Çmimi** ________

Ky çmim mbulon kostot aktuale të kopjimit dhe shpërndarjes së Dokumenteve të Tenderit (DT) tek Operatorët Ekonomikë. Operatorët Ekonomikë të interesuar kanë të drejtë të konsultojnë DT përpara blerjes së tyre.

**5.2 Informacione shtesë (vendi, zyra, mënyra e blerjes së dokumenteve të tenderit (**kur është e aplikueshme)

---

---

**Operatori ekonomik fitues, për nënshkrimin e një kontrate publike duhet të ketë:**

- Kopje të Certifikatës Elektronike të Fiskalizimit, për tatimpaguesit që përdorin Platformën Qendrore të Faturave.
- Kopje të Certifikatës Elektronike të Fiskalizimit dhe kopje të vlefshme të kontratës së lidhur me Kompaninë e Çertifikuar për zgjidhjen softuerike në përdorim, për tatimpaguesit që lëshojnë fatura përmes zgjidhjes softëerike.

Data e dorëzimit të këtij njoftimi 18.09.2024

[*Për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër në rihapjen e procesit të mini-konkurrimit*]

**FTESË PËR OFERTË**

(*shënoni emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor*) fton për paraqitjen e ofertave në procedurën për kryerjen e shërbimeve në vijim:

…………………………………………………………………………………………………………………
…………………………………………………………………………………………………………………
……………………………………………………………………………………

(jepni një përshkrim të saktë të shërbimeve të kërkuara:

**Vendi i kryerjes së shërbimit**: (jepni një përshkrim të shkurtër*)* _____________

**Kohëzgjatja e shërbimit**:____________

**Ofertat duhet të paraqiten në:**
………………………………………………………………………………………*[jepni adresën e saktë*]

**Afati i fundit për pranimin e ofertave:**

……………………………………………………………………………………………………

[Përcaktoni datën dhe orën]

**Kriteret për përcaktimin e ofertës fituese** ________________________________________

**Forma e komunikimit**:

Forma shkresore □ Forma elektronike (e-mail, faks, etj.) □

**NJOFTIMI I SHKURTUAR I KONTRATËS**

*(Për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor, për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike)*

**1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor:**

| | |
|---|---|
| Emri | Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a. |
| Adresa | Rruga e Kavajës, Ndërtesa nr.133,Njësia Administrative 6,Kodi Postar 1027,Tiranë. |
| Tel/Faks | 0800 44 88 |
| E-mail | info@ukt.al |
| Ueb-faqe | www.ukt.al |
| Personi/at përgjegjës për prokurimin: (emri, e-mail) | A.Kocaqi<br>drejtoriaeprokurimeve@ukt.al |

**2. Lloji i procedurës së prokurimit: E hapur mbi kufirin e lartë monetar"-Sherbim**

**3. Numri i referencës së procedurës /Lotit: REF- 20140-09-17-2024**

**4. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: " Përmiresimi i sistemit të faturimit dhe sigurisë, moduleve të taksave, leximeve dhe pagesave me palët e treta, mirëmbajtje dhe monitorim i sigurisë së sistemit dhe moduleve"**

**5. Fondi limit**: *144.043.333,3* (njeqind e dyzet e kater milion e dyzet e tre mije e treqind e tridhjete e tre presje tre ) lekë pa tvsh.

Vlera e fondit Limit ne monedhen nderkombetare Euro sipas kursit te Bankes se Shqiperise eshte 1.450.879,67(nje milion e katerqind e pesedhjete mije e tetqind e shtatedhjete e nente presje gjashtedhjete e shtate) euro pa TVSH

Kursi zyrtar i kembimit sipas Bankes te Shqiperise datë 17.09.2024 është 99.28 euro.

**7. Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 36 muaj nga data e nënshkrimit të kontrates .**

**8. Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: 21.10.2024   Ora:10:00**

[*Për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër*]

**PLANIFIKIMI I**

**KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

| ☐ Shërbime:<br><br>Numri i përafërt i kontratave të planifikuara për t'u dhënë në bazë të Marrëveshjes Kuadër<br>_____ | | |
|---|---|---|
| **Numri i kontratës** | **Titulli i kontratës** | **Përshkrimi i shkurtër i kontratës** |
| **01** | __________ | _______________ |
| **02** | __________ | _______________ |
| **03** | __________ | _______________ |
| **…** | __________ | _______________ |

Shënim: *Ky planifikim është i përafërt bazuar në nevojat që mund të ketë autoriteti/enti kontraktor dhe orientues për palët në proces.*

(*Për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor* )

**NJOFTIMI PËR NDRYSHIMIN E DOKUMENTAVE TË TENDERIT**

1. **Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor**

Emri ____________________________________________

Adresa ____________________________________________

Tel/Faks ____________________________________________

E-mail ____________________________________________

Ueb-faqe ____________________________________________

2. **Kontaktet e personit (ave) përgjegjës për prokurimin:**

Emri ______________________________________________

E-mail _____________________________________________

**3. Lloji i procedurës së prokurimit: ______________________________**

**4. Lloji i kontratës /Marrëveshjes Kuadër: ______________________________**

**5. Numri i referencës për procedurën / Lotin:________________________**

**6. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: _______________________**

**7. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP):_______________**

**8. Fondi limit :____________________________________________**

**9. Justifikimi, argumentat përkatëse dhe referencat ligjore për nevojën e ndryshimit të dokumenteve të tenderit:**

**______________________________________________________________________________________**

**______________________________________________________________________________________**

**10. Nëse shtyhet afati i fundit për pranimin e ofertave, të shënohet afati i ri i përcaktuar:___________**

**<u>Shënim:</u>**

**Këtij njoftimi duhet t'i bashkëngjitet shtojca e ndryshimeve në dokumentet e tenderit.**

*(Për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)*

**NJOFTIMI PËR MODIFIKIMIN E MARRËVESHJES KUADËR/KONTRATËS GJATË ZBATIMIT**

**1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor:**

Emri ____________________________________________

Adresa ____________________________________________

Tel/Faks ____________________________________________

E-mail ____________________________________________

Ueb-faqe ____________________________________________

**2. Kontaktet e personit (ave) përgjegjës për prokurimin:**

Emri ____________________________________________

E-mail ____________________________________________

**3. Lloji i procedurës së prokurimit: ______________________________**

**4. Lloji i kontratës /Marrëveshjes kuadër:______________________________**

**5. Numri i referencës për procedurën / Lotin:_________________________**

**6. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër :_______________________**

**7. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP):_______________**

**8. Fondi limit:** ____________________________________________

**9. Situata sipas parashikimeve të nenit 127 të LPP dhe argumentet përkatëse për ta përdorur atë:**

__________________________________________________________________________________________

__________________________________________________________________________________________

________________________________________

**10. Përshkrimi i modifikimit të kontratës/Marrëveshjes Kuadër, përfshirë natyrën dhe sasinë ose vlerën e shërbimeve:**

__________________________________________________________________________________________

__________________________________________________________________________________________

_______________________________________________________________________________________

**11.Vlera totale e kontratës së nënshkruar/marrëveshjes kuadër: ________________________________**

**12. Vlera e ndryshuar (nëse është rasti):_______________________________________**

**13. Kohëzgjatja e kontratës / Marrëveshjes Kuadër: _________________________**

**Dhe afati i ri (nëse është rasti):** _____________________________

**14. Emri dhe adresa e operatorit/ëve Ekonomikë:**

Emri_____________________________

NIPT: ________________________

Adresa ___________________________

Kontaktet __________________________

15. **Data e nënshkrimit të modifikimit :**______________________

16. **Burimi i financimit:** ________________________________

17. **Informacion tjetër që vlerësohet i nevojshëm nga autoriteti/enti kontraktor**______________________________________________________________________________
________________________________________________________________________________

# DOKUMENTET E TENDERIT

**Përmbajtja:**

**Seksioni I:** **Udhëzime për Operatorët Ekonomikë (Udhëzime)**

Teksti në Seksionin I nuk mund të modifikohet nga Autoriteti/Enti kontraktor ose operatorët ekonomikë, përveç informacionit të plotësuar sipas Njoftimit te Kontratës.

**Seksioni II:** **Shtojcat**

Seksioni II përfshin Shtojcat, të cilët duhet të plotësohen nga Operatori Ekonomik dhe të paraqiten si pjesë e ofertës së tij, si dhe Shtojcat që duhet të plotësohen nga autoriteti/enti kontraktor si, specifikimet teknike, termat e references, kriteret e përzgjedhjes së ofertuesve, shërbimet dhe grafiku i ekzekutimit.

**Seksioni III.** **Termat dhe Kushtet e Kontratës (TKK)**

Seksioni III përmban Kushtet e Përgjithshme dhe të Vecanta që do të zbatohen për të gjitha Kontratat, Formularin e sigurimit të kontratës, si dhe formularë që duhet të nënshkruhen nga të dy palët si, draftet e marrëveshjeve kuadër, sipas llojeve të tyre.

**Seksioni IV:** **Ankimi dhe Njoftimet për mbylljen e procesit**

Seksioni IV përfshin formularët standard që përdoren nga operatorët ekonomikë, në procesin e ankimit pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe njoftimet që duhet të plotësohen nga autoriteti/enti kontraktor në përfundim të procesit të prokurimit.

# Seksioni I: Udhëzime për Operatorët Ekonomikë

## A. TË PËRGJITHSHME

**1. Objekti i prokurimit**

1. Objekti i procedurës së prokurimit, si dhe numri i kontratave (Loteve) dhe objektet e tyre përcaktohen në njoftimin e kontratës.

2. Përveç nëse specifikohet ndryshe më poshtë, përkufizimet dhe interpretimet në këto Dokumente të Tenderit do të jenë sipas përcaktimeve të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) dhe Kushtet e Përgjithshme të Kontratës (KPP).

**2. Operatorët Ekonomikë të përshtatshëm**

a) Operator Ekonomik është çdo person fizik ose juridik ose ent publik apo grup personash/entesh, sipas Udhëzimeve për Operatorët Ekonomikë (këtu e më tej referuar si "Udhëzimet").

Në rastin e një bashkimi operatorësh ekonomikë (BOE):

1.1. të gjithë operatorët, anëtarë të këtij bashkimi do të kenë përgjegjësi të përbashkët dhe solidare;

1.2. BOE i bashkëlidh Ofertës së tij një marrëveshje ndërmjet palëve ku caktohet dhe autorizohet edhe Përfaqësuesi, i cili do të ketë autoritetin të përfaqësojë BOE gjatë procedurës së prokurimit dhe, në rast se BOE shpallet fituese e Kontratës, edhe gjatë zbatimit të Kontratës.

b) Operatori Ekonomik duhet të konsultohet me të gjitha udhëzimet, formularët, termat dhe specifikimet në Dokumentet e Tenderit. Mosdhënia nga operatori ekonomik e të gjithë informacionit ose dokumentacionit të kërkuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor në Dokumentet e Tenderit do të cojë në refuzimin e Ofertës.

**3. Sqarimi i Dokumenteve të Tenderit**

Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti/enti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkese për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave.

Autoriteti/Enti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit.

**4. Ndryshimi i Dokumenteve të Tenderit**

1. Në çdo kohë para afatit të fundit për paraqitjen e ofertave, Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i ndryshojë Dokumentet e Tenderit duke hartuar një shtojcë, me këto ndryshime.
2. Çdo shtojcë do të jetë pjesë e Dokumenteve të Tenderit dhe do të

publikohet në të njëjtën mënyrë sic është bërë publikimi i Dokumentave të Tenderit.

3. Nëse ndryshimi i Dokumenteve të Tenderit bëhet në gjysmën e parë të afatit për pranimin e Ofertave, autoriteti apo enti kontraktor mund të zgjasin afatin për pranimin e ofertave. Nëse dokumentet e tenderit ndryshohen në gjysmën e dytë të afatit për paraqitjen e ofertave, autoriteti/enti kontraktor zgjat afatin e fundit për paraqitjen e ofertave me të paktën 10 ditë për procedurat mbi kufirin e lartë monetar dhe me të paktën 7 ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar.

## B. PËRGATITJA E OFERTAVE

**1. Shpenzimet e ofertimit**

Operatori Ekonomik përballon të gjitha shpenzimet që lidhen me përgatitjen dhe paraqitjen e ofertës së tij, dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk ka detyrime apo përgjegjësi për këto shpenzime, pavarësisht nga zhvillimi apo rezultati i procedurës.

**2. Gjuha e Ofertës**

Oferta, si dhe të gjitha korrespondencat dhe dokumentet në lidhje me procedurën e prokurimit do të paraqiten në gjuhën/gjuhët e specifikuar në njoftimin e kontratës. Dokumentet mbështetëse dhe literatura e printuar që janë pjesë e Ofertës mund të jenë në një gjuhë tjetër me kusht që ato të shoqërohen nga një përkthim zyrtar i fragmenteve përkatëse në gjuhën e specifikuar në njoftim.

**3. Dokumentet përbërëse të Ofertës**

Oferta do të përmbajë të gjitha dokumentet mbështetëse siç kërkohet nga Autoriteti/Enti kontraktor.

**4. Formularët e tenderit dhe Listat e Çmimeve**

Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Ofertës në përputhje me formularin e paraqitur në Seksionin II: Të gjithë Formularët shoqërues duhet të plotësohen pa ndonjë ndryshim, nuk do të pranohet asnjë zëvendësues. Të gjitha vendet bosh duhet të plotësohen me informacionin e kërkuar.

Për procedurat e prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, origjinali i ofertës duhet të shtypet ose të shkruhet me bojë që nuk fshihet. Të gjitha fletët e ofertës duhet të lidhen së bashku dhe të numerizohen. Të gjitha fletët e ofertës, përveç literaturës së pandryshueshme dhe të printuar duhet të pajisen me inicialet ose të nënshkruhen nga Personi (at) e Autorizuar. Çdo ndryshim në ofertë duhet të jetë i lexueshëm dhe i nënshkruar nga Personat e Autorizuar.

**5. Ofertat Alternative**

Përveç nëse përshkruhet ndryshe në njoftimin e kontratës dhe dokumentat e tenderit propozimet alternative ose kohët alternative për përfundimin, nuk do të merren parasysh.

**6. Çmimet**

1. Çmimet e ofruara nga Operatori Ekonomik në Formularin e Ofertës do të jenë në përputhje me kërkesat e specifikuara në njoftimin e kontratës dhe dokumentat e tenderit.

2. Operatori Ekonomik duhet të plotësojë Formularin e Ofertës bashkangjitur me këto DT, duke përcaktuar shërbimet që do të kryhen dhe çmimin e tyre.

3. Të gjitha çmimet duhet të kuotohen në Monedhën sipas Njoftimit të

Kontratës, duke përfshirë edhe tatimet dhe taksat që zbatohen, pa përfshirë TVSH-në. Nëse çmimet kuotohen në valutë të huaj siç përcaktohet në Njoftimin e Kontratës, atëherë ato duhet të konvertohen në Lekë shqiptare (Lekë) sipas kursit të këmbimit të caktuar nga Banka Qendrore e Shqipërisë në ditën e dërgimit për publikim të Njoftimit të Kontratës dhe duhet të ruhen në atë kurs deri në skadimin e periudhës së vlefshmërisë së ofertës.

4. Ofertuesi duhet të shënojë në Formularin e Ofertës, çmimet totale të Ofertës për të gjitha Shërbimet pa TVSH. Vlera e TVSH-së, kur aplikohet, i shtohet çmimit të dhënë dhe përbën vlerën totale të Ofertës.

Në rastin e një Marrëveshje Kuadër ku NUK përcaktohen të gjitha kushtet, çmimet për kontratat bazuar në Marrëveshjen Kuadër nuk janë të fiksuara, ato janë objekt i ndryshimit pas një mini – konkurrimi midis Operatorëve Ekonomikë, palë në Marrëveshjen Kuadër.

**7. Monedhat**

Monedha (at) e ofertave dhe monedha (at) e pagesës do të jenë siç specifikohet në njoftimin e kontratës.

**8. Provueshmëria e Kualifikimeve të Operatorit Ekonomik**

Për të provuar kualifikimet e tij për realizimin e Kontratës, Operatori Ekonomik do të japë informacionin e kërkuar në Seksionin II: Shtojcat.

**9. Periudha e vlefshmërisë së Ofertës**

1. Ofertat do të jenë të vlefshme për periudhën e specifikuar në Njoftimin e Kontratës pas afatit të paraqitjes së Ofertave të përcaktuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor; Oferta për një periudhë më të shkurtër nuk është e vlefshme dhe do të refuzohet.
2. Sigurimi i Ofertës mund të paraqitet në njërën nga format e mëposhtme:

   a) Pagesa nga ofertuesi, në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit/entit kontraktor

   b) Garanci bankare

   c) Garanci sigurimi

   Dokumentet e mësipërme duhet të jenë të vlefshme gjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së Ofertës.

3. Periudha e vlefshmërisë së Ofertës fillon nga momenti i hapjes së ofertave. Në çdo rast, të paktën 5 ditë para përfundimit të afatit të vlefshmërisë së ofertave, Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Ofertuesit me shkrim të zgjasë periudhën e vlefshmërisë, deri në një datë të caktuar. Ofertuesi mund ta refuzojë këtë kërkesë me shkrim, pa humbur të drejtën për rimbursim të Sigurimit të Ofertës, kur ka një të tillë. Ofertuesi që bie dakord të zgjasë periudhën e vlefshmërisë së Ofertës njofton Autoritetin/Entin Kontraktor me shkrim dhe paraqet një sigurim oferte të zgjatur, nëse ka pasur një të tillë. Oferta nuk mund të modifikohet. Nëse Ofertuesi nuk i përgjigjet kërkesës së bërë nga

Autoriteti/Enti Kontraktor në lidhje me zgjatjen e periudhës së vlefshmërisë së Ofertës, ose nuk e pranon kërkesën në fjalë, ose nuk paraqet një sigurim të zgjatur të ofertës, kur kërkohet, atëherë Autoriteti/Enti Kontraktor e refuzon Ofertën.
Nëse autoriteti/enti kontraktor nuk i ka bërë një kërkesë me shkrim operatorit ekonomik për të zgjatur periudhën e vlefshmërisë së ofertës, sipas parashikimit të paragrafit të parë të kësaj pike, atëherë operatori ekonomik nuk mund të penalizohet për këtë, pra sigurimi i ofertës së tij nuk konfiskohet.

**10. Formati dhe Nënshkrimi i Ofertave**

Në përgjigje të Njoftimit të Kontratës, çdo Operator Ekonomik paraqet ofertën sipas formularëve standard në këtë DT. Oferta nënshkruhet nga personi/personat përgjegjës të autorizuar për këtë qëllim.

## D. PARAQITJA DHE HAPJA E OFERTAVE

**11. Paraqitja e Ofertave**

11.1 Në procedurat e prokurimit që zhvillohen me mjete elektronike, operatorët Ekonomikë duhet të ngarkojnë ofertën e tyre në sistemin e prokurimit elektronik, sipas përcaktimeve në manualet përkatëse.

11.2 Lidhur me procedurat e prokurimit, që zhvillohen në rrugë shkresore, Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin vetëm ofertën origjinale të mbyllur në një zarf jotransparent, të vulosur dhe të firmosur me emrin dhe adresën e Ofertuesit dhe të shënuar: "Ofertë për kryerjen e Shërbimeve; Njoftimi Nr. __.

**“MOS E HAPNI, ME PËRJASHTIM TË RASTEVE KUR ËSHTË I PRANISHËM KOMISIONI I VLERËSIMIT TË OFERTAVE, JO PËRPARA ------------- d/m/v, në orën-----------” .**

**12. Afati i fundit për paraqitjen e Ofertave**

Oferta duhet të paraqitet brenda afati të përcaktuar nga autoriteti/enti kontraktor. Nëse autoriteti/enti zgjat afatin kohor për pranimin e ofertave, operatorët ekonomikë, mund të paraqesin ofertat e tyre brenda afatit të zgjatur.

Data e hapjes së ofertave do të jetë e njëjtë me afatin e fundit të paraqitjes së ofertave. Nëse për arsye objektive, të shkaktuara nga një situatë e paparashikuar nga autoriteti/enti kontraktor në kohën e fillimit të procedurës, është e pamundur të respektohet afati për hapjen e ofertave nga autoriteti ose enti kontraktor, arsyeja duhet të dokumentohet dhe të caktohet një datë e re për hapjen e ofertave.

Ofertuesit ose përfaqësuesit e tyre të autorizuar, të cilët kanë paraqitur oferta, ftohen të marrin pjesë në hapjen e ofertave, nëse janë të interesuar. Mosparaqitja e tyre nuk pengon hapjen e ofertave.

**13. Ofertat me vonesë**

Autoriteti/Enti Kontraktor nuk merr në shqyrtim asnjë ofertë që vjen pas afatit të fundit për paraqitjen e tyre siç specifikohet në Njoftimin e Kontratës. Sistemi i prokurimit elektronik nuk lejon paraqitjen e ofertave që janë në tejkalim të afatit të fundit për paraqitjen e tyre.

**14. Tërheqja,**

1. Operatori Ekonomik mund ta tërheqë, zëvendësojë ose modifikojë ofertën e

| | |
|---|---|
| **Zëvendësimi dhe Modifikimet** | tij, në cdo kohë deri përpara afatit të fundit të pranimit të ofertave.<br><br>2. Në procedurat e prokurimit të cilat zhvillohen në rrugë shkresore, ofertuesit mund të modifikojnë ose tërheqin ofertat e tyre me kusht që modifikimi ose tërheqja të bëhet para skadimit të afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave. Si modifikimet ashtu edhe tërheqjet duhet t'i komunikohen Autoritetit/Entit Kontraktor me shkrim, para datës së afatit të fundit për paraqitjen e ofertave. Zarfi që përmban deklaratën e Ofertuesit duhet të shënohet: "MODIFIKIM OFERTE" ose "TËRHEQJE OFERTE".<br><br>3. Asnjë ofertë nuk mund të tërhiqet, zëvendësohet ose modifikohet pas afatit të fundit për paraqitjen e ofertave. |
| **15. Hapja e Ofertave** | Ofertat hapen pas përfundimit të afatit të fundit të përcaktuar për pranimin e ofertave në dokumentat e tenderit. |

**E. SHQYRTIMI I OFERTAVE**

| | |
|---|---|
| **16. Konfidencialiteti** | Autoriteti/enti kontraktor duhet të ruaj konfidencialitetin sipas përcaktimeve të nenit 16 të LPP-së. |
| **17. Sqarimi i ofertave** | 1. Autoriteti/Enti Kontraktor, gjatë procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, mund të kërkojë sqarime nga operatorët ekonomikë ofertues. Çdo sqarim i paraqitur nga Operatori Ekonomik që nuk i përgjigjet një kërkese nga Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të merret në konsideratë. Nuk mund të kërkohet, ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në çmimet ose përmbajtjen e ofertave, përveç rasteve të konfirmimit të korrigjimit të gabimeve aritmetike të konstatuara nga Autoriteti/Enti Kontraktor gjatë vlerësimit të ofertave. |
| **18. Përgjegjshmëria e ofertave** | 1. Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e Dokumenteve të Tenderit pa devijime materiale, rezerva ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë:<br>(a) "**Devijim**" është shmangia nga kërkesat e specifikuara në Dokumentet e Tenderit;<br>(b) "**Rezervim**" është përcaktimi i kushteve kufizuese ose mospranimi i plotë i kërkesave të specifikuara në Dokumentet e Tenderit; dhe<br>(c) "**Mospranim**" është mosparaqitja e një pjesë ose e të gjithë informacionit ose dokumentacionit të kërkuar në Dokumentet e Tenderit.<br><br>2. Nëse një ofertë nuk i përgjigjet kërkesave të Dokumenteve të Tenderit, ajo refuzohet. |

**F. VLERËSIMI I OFERTAVE**

| | |
|---|---|
| **19. Kualifikimi i Operatorit Ekonomik** | 1. Për një pjesë të kritereve të pranimit të kërkuara në dokumentat e tenderit, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit si një provë paraprake në formën e një deklarate, ku shprehet |

se Oferta e tij është në përputhje me Kërkesat Teknike, kushtet dhe kriteret e përcaktuara në Njoftimin e Kontratës dhe në Dokumentet e Tenderit.

2. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar për të gjitha kriteret për të cilat nuk lejohet vetdeklarim.

4. Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjithë dokumentacionin e paraqitur si pjesë e Ofertës. Në rast të verifikimit të përmbajtjes së dokumentacionit të paraqitur, ose të Vetëdeklarimeve, kur përmbajtja e tyre nuk rezulton të jetë e vërtetë, Operatori Ekonomik është në kushtet e parashikuara në nenin 78, pika 1, gërma (a) të Ligji për Prokurimin Publik (LPP).

**20. Konvertimi në valutë të vetme**

1. Për qëllime vlerësimi dhe krahasimi, monedha (et) e Ofertës do të konvertohet në një monedhë të vetme siç specifikohet në Njoftimin e kontratës.

**21. Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese**

1. Autoriteti/Enti Kontraktor përcakton ofertën ekonomikisht më të favorshme në bazë të kritereve të përcaktimit të ofertës fituese që janë përcaktuar në Njoftimin e Kontratës dhe në Dokumentet e Tenderit si më poshtë.

**Opsioni 1) – Oferta Ekonomikisht më e Favorshme, bazuar në kosto:**

Lidhur me kriteret e vlerësimit, duhet përcaktuar qartë pesha specifike e secilit kriter, përkatësisht numri i pikëve për secilin kriter dhe mënyra se si do të llogariten pikët për ofertuesit e njëpasnjëshëm.

Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave janë objektive dhe shprehen në shifra. Në çdo rast, kur ka më shumë se një kriter, pesha specifike e kriterit të çmimit nuk duhet të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që mund të marrë një Ofertë do të jenë 100.

Formula me të cilën llogariten pikët e ofertuesve, në çdo rast duhet të jetë:

Po= Pk1+Pk2+Pk3+.....

Ku:

Po - janë pikët totale të ofertës së vlerësuar

Pk1/Pk2/Pk3/... - janë pikët për secilin kriter të vlerësuar

Pikët për secilin kriter llogariten sipas formulës:

Pk1= Vmink1 x Pmaxk1/Ok1

Pk1 _____ Pikët e kriterit që vlerësohet

Vmink1 Vlera më e ulët e kriterit që vlerësohet

Pmaxk1 Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

Ok1 Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

**<u>Opsioni 2) – Oferta Ekonomikisht më e Favorshme, Bazuar në Çmim:</u>**

Kontrata do t'i jepet ofertuesit i cili ka ofruar çmimin më të ulët të ofertës.

**SHËNIM:** Autoriteti/Enti Kontraktor do të zgjedhë vetëm një nga Opsionet si kriter i vlerësimit. Përdorimi i të dy opsioneve në DT e bën procedurën të pavlefshme.

2. Autoriteti/Enti Kontraktor do t'i japë kontratën Operatorit Ekonomik, Oferta e të cilit ka rezultuar të jetë ekonomikisht më e favorshme.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor përdor si kritere vlerësimi nje nga kriteret e përcaktuara në Njoftimin e Kontratës.

**22. Vlerësimi i ofertave dhe korrigjimi i gabimeve aritmetike dhe ofertave anomalisht të ulëta**

1. Autoriteti/Enti Kontraktor kontrollon ofertat e paraqitura nëse kanë gabime arithmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime arithmetike, autoriteti/enti i korrigjon këto gabime si më poshtë:

**(a)** Nëse ka një mospërputhje midis çmimit për njësi dhe çmimit total, që rezulton nga shumëzimi i çmimit për njësi me sasinë, çmimi për njësi do të mbizotërojë dhe çmimi total do të ndryshohet përkatësisht.

**(b)** Nëse ka ndonjë mospërputhje në çmimin total, kur totali është shuma ose diferenca e nën-totaleve, çmimi nën-total mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet bazuar në të.

**(c)** Nëse ka ndonjë mospërputhje midis fjalëve dhe numrave, shuma me fjalë do të mbizotërojë. Përjashtim nga ky rregull është situata kur shuma ka të bëjë me gabimin, i cili do të korrigjohet sipas pikave (a) dhe (b) më lart, prandaj në këtë rast shuma në numër mbizotëron dhe ajo me fjalë do të korrigjohet.

**(d)** Nëse ekziston një mospërputhje midis fjalëve dhe shifrave, shuma me fjalë do të mbizotërojë, përveç nëse shuma e shprehur me fjalë lidhet me një gabim aritmetik, rast në të cilin shuma në shifra do të mbizotërojë në bazë të (a) dhe (b) më sipër.

Në çdo rast, Ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur:

- vlera absolute e të gjitha korrigjimeve është më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;

- vlera absolute e të gjitha korrigjimeve është më pak se 2%, por korrigjimi nuk pranohet nga ofertuesi.

2. Kur autoritetet /entet kontraktore vërejnë se oferta është anomalisht e ulët, i kërkojnë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin dhe në përputhje me dispozitat e këtij neni.

- Në rast kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta konsiderohet anomalisht e ulët kur zvogëlohet më shumë se 25% të fondit limit të përllogaritur.
- Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta konsiderohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më pak se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Nëse një ose disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, para se të marrë një vendim për kualifikimin e tyre ose jo, në përputhje me nenin 93 të LPP-së.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementet specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

**O - Oferta**

**MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme**

**N - Numri i ofertave të vlefshme**

**PR (Zm) – Zbritje e mundshme**

**MO = O1 + O2 + O3 + … On / N**

**PR = 85 % Mo**

**Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR ......... rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët**

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes se shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja

e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

## D. DHËNIA E KONTRATËS

**23. Njoftimi i Fituesit**

1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

**24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës**

1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.

2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

a) garanci bankare

b) garanci nga shoqëri sigurimi.

## DH. ANKESAT

**25. Procedura e ankesës**

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore.

2. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

## E. ANULIMI I PROCEDURËS

**26. Anulimi i procedurës**

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.

2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:

a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë përkatëse në procedurat me faza;

b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;

c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;

d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;

e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 te LPP dhe nenin 75 te VKM 285/2021.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

**SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE**

Shtojca 1. Formulari i Ofertës

Shtojca 2. Listat e Çmimeve të Shërbimeve

Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 6. Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 7. Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 8. Formulari i Kritereve te Përzgjedhjes se Ofertuesve

Shtojca 9. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 10: Formulari i Njoftimit tw skualifikimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraprak)

Formulari 12- Formulari i Njoftimit të Fituesit (Në përfundim të afateve të ankimit)

Shtojca 13:Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Paraprak)

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Në përfundim të afateve të ankimit)

**Shtojca 1.**

*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)*

**FORMULARI I OFERTËS**

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor**]

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i [**Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

**(a)** Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[*shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE*]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

**(b)** Ne **[*vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti*)**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[*vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit*]**.

**(c)** Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

**(d)** Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontratës;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
8. Listat e Çmimeve të Shërbimeve.

**(e)** Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ------------- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

**(f)** Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ------------- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

| | |
|---|---|
| **Emri i përfaqësuesit të ofertuesit** | |
| **Nënshkrimi** | |
| **Vula** | |
| **Datë _________________** | |

**Shtojca 2.**

*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)*

**LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE**

**Data**: ____________________________________

**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
____________________________________

**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë** (në rast BOE): ________________________________________________

**Monedha**: ____________

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për sherbimet. Shërbimetpa çmim do të konsiderohen si sherbime të paofruar dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

**Lista e Çmimeve**

| NR | EMËRTIMI | Njesia | SASIA | AFATI lëvrimit, nga nënshkrikimi |
|---|---|---|---|---|
| **1** | Përmirësimi dhe Përshtatja e Sistemit të Faturimit Al-Billing (ose ekuivalent) | Set | 1 | **4 muaj** |
| **2** | Përmirësimi dhe Implementim i Shërbimit të Pagesave (web service) me palët e treta. Lidhja me 1 nga Bankat (*). | Set | 1 | **6 muaj** |
| **3** | Permiresimi dhe Implementimi i Sistemit të administrimit te Leximeve dhe Taksave me PDA | Set | 1 | **6 muaj** |
| **4** | Oracle Database Enterprise Edition (Processor License, së bashku me shërbimin e Partitioning) ose ekuivalente, *përfshirë shërbimet që lidhen me zbatimin dhe migrimin, dhe* ***shërbimet e replikimit online me bazën e të dhënave Cloud****.* | Procesore | 3 | **15 dite** |
| **5** | Sistemim i auditimit të bazave të të dhënave Oracle si Core Audit Application (Processor | Procesore | 3 | **15 dite** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | License) ose ekuivalente. | | | |
| **6** | Server cloud së bashku me mbrotjen e të dhënave, për zbatimin e komponenteve online me bankat si dhe me klientet (vite) | Vite | 3 | **15 dite** |
| **7** | Bazë e të dhënave të hostura Oracle e integruar me bazën e të dhënave në on-premise (vite) | Vite | 3 | **15 dite** |
| **8** | Sistemi i hostuar i raportimit BI, me një numër minimal prej 10 përdoruesish (vite) | Vite | 3 | **15 dite** |
| **9** | Mirëmbajtje dhe garanci prodhuesi per Sistemit të Faturimit Al-Billing(ose ekuivalent), Reader, Taksa dhe WS të pagesave, **bazat e te dhenave enterprise edition**, **particionimit**, **core audit** për periudhë vjecare (vite) (**) | Vite | 3 | **15 dite** |
| **10** | Administrimi i Projektit si dhe levrimi i dokumentacioneve baze te sistemit :<br>- Draft rregullore per operimin e sistemit AL-Billing(ose ekuivalent);<br>- Draft rregullore per operimin e sistemit të administrimit te Leximeve dhe Taksave me PDA,<br>- Perditesimin e Manualin te perdorimit te sistemit, dhe perditesimin e tij, pas cdo nderhyrje permiresuese ne sistem. Vecanerisht lidhur me permiresimet e planifikuara ne kete projekt. Keto manual duhet te perfshine edhe komponentet e tjere te sistemit Al-Billing(ose ekuivalent), si Sistemit Raportimit BI, Shërbimit të Pagesave (web service) per shkembimin e te dhenave me Bankat, etj.;<br>- Diagrama e qarkullimit te Informacionit ne sistemin e Al-Billing(ose ekuivalent);<br>- Draft rregullore per krijimin dhe mirembatjen e perdoruesve ne sistemin AL-Billing(ose ekuivalent);<br>- Diagrama e qarkullimit te Informacionit ne sistemin e administrimit te Leximeve dhe Taksave me PDA;<br>- Draft rregullore per krijimin dhe mirembatjen e perdoruesve ne sistemin e administrimit te Leximeve dhe Taksave me PDA; | Muaj | 6 | **6 muaj** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **11** | Trajnim i vazhdueshem i perdoruesve te sistemeve | Klasa | 10 | **36 muaj** |

*Shenim:*

*(*): Numri i bankave, që do të bashkohen në këtë shërbim të përmirësuar është në varësi të vetë bankave apo vullnetit të tyre për t'ju bashkuar shërbimit. Numri maksimal i mundshëm është sa numri i bankave që do të operojnë në Shqipëri përgjatë kohes së zbatimit të kontratës; Gjatë lëvrimit të shërbimit, OE kërkohet që brenda 6 muajve të kryej të bëj lidhjen e suksesshme me njërën nga bankat; Në vijim (brenda shërbimit të mirëmbajtjes) operatori kërkohet të ofrojë Mbështetje teknike në procesin e lidhjes të cdo banke tjetër, që do të zbatojë këtë shërbim.*

*Plani i lidhjes per secilen nga Bankat, do te kryhet pergjate periudhes se mirembajtjes se sistemeve. Grupit te punes se UKT qe do te ndjek zbatimit te projektit, dhe koordinimin me Bankat per realizimin e lidhjeve. Plani i integrimeve, do te percaktohet nga UKT dhe OE do te njoftohet paraprakisht (per te lejuar pregatitjen e personelit te OE) te pakten dy jave para cdo fillim integrimi.*

**Shtojca 3.**

[ *Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)*

[*Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve*]

## FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi *(nëse zbatohet):* Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

*Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra]* si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [*emri i autoritetit/entit kontraktor*] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kerkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontrates së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [*njoftimin e kontratës*].

**[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]**

**Shtojca 4.**

*(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)*

**Lista e Informacionit Konfidencial**

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

| Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial | Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale | Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni | Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni |
|---|---|---|---|
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |

**VËMENDJE**

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Përfaqësuesi i Ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**Vula**

**Shtojca 5.**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor*]

**FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Specifikimi i Materialeve

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

## 1. Situata Aktuale në UKT

Shoqëria Ujësjellës Kanalizime Tiranë përdor aktualisht për Administrimin e Abonentëve, Faturimin, Arkëtimin, Ankesë/Kërkesat, Faturën Online sistemin e faturimit AL-BILLING, Web Service të Pagesave dhe atë të Leximeve për realizimin e leximeve të matësave nga Lexuesit në terren dhe administrimin e tyre (marrjen online dhe kalimin e tyre për faturim). Përsa i përket administrimit të Taksave dhe Tarifave Vendore sistemi i faturimit Al-Billing mundëson llogaritjen e tyre sipas zonave dhe faturimin e tyre duke i shfaqur ato ne sistem per faturim dhe aketim, ndërkohë përdoret edhe sistemi i administrimit dhe rregjistrimit të informacionit të abonentëve për taksat vendore nëpërmjet programit mobile, një program Android dhe modul administrimi web.
Baza e të dhënave aktuale është Oracle Database 10g Enterprise Edition me licensim për 2 CPU (4 core) nderkohe qe licensat aktuale nuk kane nje kontrate suporti me prodhuesin.

Shoqeria ka ne total rreth 300,000 abonente me kontrate aktive. Numri i faturave mujore eshte rreth 300,000 fatura ne muaj. Numri i perdoruesve te sistemit te faturimit Al-Billing eshte rreth 400 perdorues kurse sistemi i leximeve ka rreth 250,000 abonente dhe rreth 175 lexues qe lexojne matesat nepermjet PDA, mbledhin leximet nga ujematesit dhe te dhena qe lidhen me kontrollet dhe taksat. Perqindja e arketimeve qe vijne nga institucionet financiare nepermjet komunikimit me web servicet eshte rreth 40%.

Lidhur me sigurine e sistemeve IT, infrastruktura e shoqerive ujesjelles kanalizime eshte kategorizuar si infrastrukture kritike dhe si e tille duhet te zbatohen te gjithe teknikat e sigurise per ta bere ate te sigurt nga sulmet keqdashese qe mund te shkaktojne demtimin e te dhenave.

## 2. OBJEKTIVAT, QËLLIMI DHE REZULTATET E PRITURA

### 2.1. Objektivi i Përgjithshëm

- ✓ Përmirësimi i Sistemit të Faturimit Al-Billing për shtimin e kapacitetit të përpunimit të të dhënave të abonentëve dhe administrimit të tyre
- ✓ Përmirësimi i Sistemit të Faturimit Al-Billing për administrimin e plotë të abonentit duke ndihmuar në saktësimin e të dhënave të tij si dhe duke mundësuar lidhjen e më shumë se një kontrate për abonent
- ✓ Përmirësimi i sistemit të faturimit për shtimin e dashboard-eve me analiza grafike lidhur me faturimin, arkëtimin, leximet dhe përdoruesit aktiv
- ✓ Përmirësimi i sistemit të faturimit për administrimin e tarifave të faturimit duke i lidhur ato me kontratat dhe duke i sjellë ato dinamike me përqindje referuar furnizimeve
- ✓ Përmirësimi i sistemit të faturimit për shtimin e mundësive të pagesave pjesore apo atyre kreditore
- ✓ Përmirësimi i sistemit të faturimit duke mundësuar analizimin e menjëhershëm të planit të faturimit me faturimin mujor
- ✓ Shtimin e një moduli monitorimi mbi sistemin e faturimit krahasimisht me planifikimin/et dhe periudha e tjera si dhe mundësinë e njoftimeve për anomali të mundshme
- ✓ Përmirësimi i Sistemit të Faturimit Al-Billing referuar administrimit të plotë të Akt-Marrveshjeve duke mundësuar më shumë se një akt-marrveshje, analizën automatike të tyre lidhur me respektimin dhe lejuar pagesat e kësteve duke i reflektuar ato saktë në raporte
- ✓ Saktësimi dhe implementimi i shërbimeve të pagesave online në kohë reale nëpërmjet përdorimit të web service dhe ofrimin e tyre për të gjithë kanalet e pagesave
- ✓ Permiresimi i proceseve qe lidhen me leximet e matesve, te dhenat rreth taksave, kontrolleve te cilesise se te dhenave qe mblidhen me ane te App mobile ne pajisjet mobile PDA dhe integrimet me sistemin e faturimit Al-Billing. Synimi eshte te automatizohen proceset qe e ofrojne kete mundesi, te rritet siguria dhe te unifikohen standardet me sistemin e Al-Billing, te rritet shpejtesia e funksionimit, lehtesia e perdorimit te App mobile nga lexuesit, optimizimet e integrimeve, shtimi i kontrolleve te avancuara per kontrollin e cilesise, raportim efikas. Te gjithe keto permiresime do e kryhen nepermjet nje sistemi te pershtatshem qe i ploteson kerkesat teknike e funksionale qe do te shpjegohen ne vazhdim te dokumentit.
- ✓ Implementim i sistemit të auditimit të bazave të të dhënave Oracle si Core Audit application

- ✓ Saktësim dhe implementim auditi në nivel aplikimi dhe raportimi adekuat i detajuar
- ✓ Ngritja e alerteve automatike për akseset e pa autorizuara në bazën e të dhënave dhe bllokimi i tyre
- ✓ Implementimi i sistemit të faturimit Al-Billing, leximeve dhe bazes së të dhënave ne serverat ekzistues te cilet perdorin sistemin operativ Linux, si dhe upgrade, update dhe instalimi i versioneve te fundit te bazes se te dhenave dhe patcheve te fundit te sigurise.
- ✓ Implementim i modulit të raportimit dinamik duke lejuar IT në nivel përdoruesi aplikimi të krijojnë raportet e nevojshme
- ✓ Rritja e nivelit të përgjithshëm të sigurisë në modulet e Al-Billing dhe në mënyrë të vecantë të moduleve të ekspozuara web service online të pagesave apo të konsultimit të faturave nga klientet.
- ✓ Automatizimi i shkembimit te konfirmimit te pagesave te realizuara ne Bankat. Rakordimi automatik, te arketimeve te perfituara me faturat e leshuara.
- ✓ Rritja e mjeteve të raportimit të sistemit dhe operacioneve të UKT nëpërmjet zbatimit të një sistemi të raportimit inteligjent të tipit Business Reporting Tool.

### 2.2. Qëllimi

Përmirësimi i mëtejshëm i sistemit të faturimit Al-Billing dhe sigurimi i vijimësisë së punës për administrimin e abonentëve, faturimit, pagesave me palet e treta dhe realizimin e leximeve dhe taksave nëpërmjet pajisjeve mobile (PDA) nga lexuesit, përmirësimi i procesit të administrimit dhe kontrollit të të dhënave dhe raportimit. Shtimi i auditimit nëpërmjet përdorimit të Oracle Core Audit Application ose ekuvalente i cili do të sigurojë auditin e plotë të kontrollit si dhe shtimin e sigurisë për aksesin e të dhënave.

Në projekt kërkohet edhe rritja e përgjithshme e sigurisë së sistemit. Për këtë vecanërisht kërkohet implementim i pavarur i sistemit te adminsitrimit te leximeve dhe taksave me PDA, instalimi i pjesës së shërbimeve online i web serviceve për pagesat si dhe atij të konsultimit të llogarive në një ambjent të sigurtë dhe të pavarur nga baza e të dhënave të AL-Billing. Në këtë mënyrë, ekspozimi i shërbimeve dhe i të dhënave të Al-Billing kërkohet të jetë plotësisht i izoluar nga ekspozimi në internet. Ky ambjent kërkohet të ruhet në një ambjent të sigurtë cloud dhe të mbrojtur nga versionet më të fundit të firewall, web application firewall (WAF) si dhe lidhje të sigurtë VPN me rrjetin e UKT si dhe operatorët e pagesave. Lidhja me bankat duhet te mundesoje gjithashtu edhe marrjen automatike te konfirmimeve te pagesave, te realizuara ne bankat. Per secilen pagese, sistemi duhet te mundesoje rikoncilimin automatik, dhe ndryshimin e gjendjes se fatures ne paguar apo te paguar ne menyre te pjesshme.

Njëkohësisht kerkohet mirëmbajtja e sistemit pas implementimit të të gjithë kerkesave ne kete dokument.

Automatizimin e proceseve kryesore të faturimit, futja dhe regjistrimi i automatizuar i të dhënave, njoftimet dhe rikujtesat e faturimeve apo pagesave duke lejuar që UKT të fokusohet në detyra të tjera të rëndësishme në vend të atyre rutinë.

Dërgimin e faturave me email për klientët që kanë të regjistruar adresën e tyre të email në modulin e konsultimit të faturës online, shtuar këtu konfirmimin e tyre për këtë shërbim.

### 2.3. Rezultatet e përgjithshme që duhet të arrihen nga Kontraktori

- ✓ Përmirësimi i mëtejshëm i Sistemit të Faturimit Al-Billing dhe përshtatja me kërkesat e UKT
- ✓ Përmirësimi i modulit të administrimit të abonentëve duke mundësuar kontrollet e nevojshme si dhe shtuar informacionin e nevojshëm
- ✓ Përmirësimi i modulit të administrimit të tarifave, duke e sjellë në linjë me administrimin e saktë të tarifave dhe taksave
- ✓ Përmirësimi i sistemit të faturimit për shtimin e mundësive të pagesave pjesore apo atyre kreditore
- ✓ Përmirësimi dhe përshtatja e formës së konsultimit për shfaqjen e të gjithë të dhënave të mundshme (kontrollin e faturës së fiskalizuar, faturës së printuar me të gjithë elementët)
- ✓ Përmirësimi i sistemit të faturimit për shtimin e dashboard-eve me analiza grafike lidhur me faturimin, arkëtimin, leximet dhe përdoruesit aktiv
- ✓ Përmirësimi i sistemit të faturimit duke mundësuar analizimin e menjëhershëm të planit të faturimit me faturimin mujor
- ✓ Përmirësimi i Modulit të Faturës Online duke reflektuar të gjithë ndryshimet e faturës apo ndryshimeve tek abonenti
- ✓ Saktësimin e të dhënave Online edhe për ankesë/kërkesat apo shfaqjen e plotë të të gjithë të dhënave të abonentëve
- ✓ Përmirësimi i sistemit të faturimit Al-Billing referuar administrimit të plotë të Akt-Marrveshjeve duke mundësuar më shumë se një akt-marrveshje, analizën automatike të tyre lidhur me respektimin dhe lejuar pagesat e kësteve duke i reflektuar ato saktë në raporte
- ✓ Mundësimi i transferimit të të dhënave të faturimit dhe arkëtimeve në sistemin Microsoft Dynamics NAV (përcaktimet e fushave do të bëhen gjatë fazës së integrimit)
- ✓ Shtimin e opsioneve për anullimi i taksave që të realizohen pa prekur kunsumin e ujit dhe ky proces të mund të bëhet nëpërmjet dhënies së të drejtës Drejtorisë së Taksave
- ✓ Përmirësimi i modulit të raportimit dinamik duke lejuar IT në nivel përdoruesi aplikimi të krijojnë raportet e nevojshme
- ✓ Krijimin e evidencave që pasqyron faturimin e taksave vendore të cdo muaji të ndarë për secilen taksë dhe njësi/zonë
- ✓ Krijimin e evidencës që pasqyron faturimin e kamatës progresive ditore dhe mujore
- ✓ Krijimin e evidencës që pasqyron faturimin e vlerës së rilidhjes
- ✓ Pasqyrimi i faturës së gjobës në SMI dhe rishikimi i procesit
- ✓ Krijimin e evidencës mujore që të përfshijë zerat e ndarë në nr. abonentesh, konsum ne m3, vlerë konsumi uji në lekë, tarifë dhe taksa vendore

- ✓ Shtimi i zërave tek raporti arkëtime ditore debitore sic janë të ndarë zërat tëk evidenca e arketimeve të grupuara
- ✓ Implementim i sistemit të auditimit të bazave të të dhënave Oracle si core audit application ose ekuivalent
- ✓ Implementimi i mjeteve të avancuara të raportimit të tipit *Business Intelligence*, si dhe lidhjen me bazën e të dhënave të AL-Billing për mundësimin e operatoreve dhe përdoruesve të sistemit të pavarsisë në ndërtimin e raportimeve të reja.
- ✓ Shtimi i sigurisë së aksesimit të sistemit nga përdoruesit duke propozuar politikat e sigurisë së fjalëkalimit (kompleksiteti minimal në gjatësi, karaktere speciale apo numra si dhe periodiciteti i ndryshimit) dhe implementuar jo vetëm ndryshimin e detyruar të fjalëkalimit por edhe duke shtuar 2FA
- ✓ Krijimi i një ambjenti të sigurtë të hostimit dhe komunikimit të të dhënave backup, dhe për operim të moduleve web service të komunikimit të sistemit AL-Billing online. Shkembimi i informacionit qe lidhet me pagesen e faturave te realizuara ne Banka.
- ✓ Shtimi i mjeteve të sigurisë së aksesit të sistemeve/shërbimeve online nëpërmjet mundësimit te VPN, sistem firewall (FW) dhe web application firewall (WAF) që do të kontrollojnë të gjithë komunikimet online.
- ✓ Qëndrueshmëria dhe Zgjerueshmëria e Sistemit, si dhe ruajtja e te dhenave ne nje ambjent te sigurte ne cloud.
- ✓ Përditesimi dhe aplikimi i modifikimeve të lidhura me zhvillimet
- ✓ Ruajtja e historikut të ndryshimeve të leximeve, faturimeve dhe arkëtimeve
- ✓ Implementimi i nje sistemi te pershtatshem per menaxhimin e mbledhjes e leximeve kryerjes se kontrolleve dhe proceseve qe lidhen me taksat duke ofruar panelin e administrimit ne web dhe App mobile per operatoret qe mbledhin te dhenat ne terren
- ✓ Parapërgatitja e rregulloreve për përdorimin e sistemit
- ✓ Parapërgatitja e rregulloreve operacionale për veprimet sistemuese duke saktësuar të gjithë veprimet dhe mënyrën e sistemimit duke mundësuar realizimin e tyre nga aplikimi e jo në bazën e të dhënave
- ✓ Përpilimin e dokumentit për të gjithë diagramën e qarkullimit të informacionit nëpërmjet sistemeve dhe moduleve
- ✓ Parapërgatitja e dokumentacionit të dokumentimit të bazë së të dhënave me detajet dhe elementët teknik të përfshira
- ✓ Parapërgatitja e rregullores për administrimin e përdoruesve dhe ripërcaktimi i roleve dhe të drejtave duke saktësuar edhe format e të drejtave referuar rregullores.
- ✓ Trajnimin e IT për zhvillim dhe përshtatje të sistemit

## 3. SUPOZIMET DHE RISQET

### 3.1. Supozimet e Projektit

Realizimi i këtij projekti bëhet nën supozimin që do të ketë një përfshirje totale të aktorëve kyç si në përmrësimin e sistemit Al-Billing, azhornimin dhe administrimin e të dhënave, apo implementimet e nevojshme lidhur me të gjithë modulet si dhe trajnimit të përdoruesëve. Përfshirja e plotë e aktorëve kyç është thelbësore për mbarëvajtjen me sukses të projektit.

### 3.2. Risqet

Mos përfshirja e të gjithë aktorëve kyç do të sjellë mangësi në zhvillim, implementim dhe funksionalite të kërkuara si dhe në saktësinë e të dhënave. Kryerja e gabimeve gjate azhornimeve dhe ndryshimeve eq do te kryhen me sistemin Al-Billing dhe ne bazen e te dhenave mund te shkaktoje demtim te te dhenave qe mund te rezultoje i veshtire per tu zbuluar dhe mbartje te ketyre gabimeve per nej kohe te gjate duke i shkaktuar deme UKT dhe abonenteve te saj.

Implementimi jo i pershtatshem i sistemit te adminsitrimit te leximeve dhete dhenave nga terreni mund te sjelle vonesa ne kryerjen e proceseve te punes ne stafin e UKT e cila demton arritjen e objektivave mujore qe kulmojne me leshimine e plote dhe te sakte te faturave per te gjithe abonentet e saj.

Mos implementimi i pershtatshem i zgjidhjes BI dhe i raporteve qe do te perdoren sjell pamundesine e shoqerise per te analizuar te dhenat, nxjerre indikatoret e duhur ne kohen e duhur dhe ti perdore ato per vendimarrje efikase.

Mos zbatimi i kerkesave lidhur me sigurine mund te krijoje vulnerabilitete te cilat mundte keqperdoren nga nderhyrje te pa autorizuara qe mudn te shkaktojne demtim serioz te te dhenave ose te vazhdimesise se biznesit.

Keqfunksionimi i web serviceseve mund te shkaktoje gabime ne regjistrimin e pagesave, pamundesi te rakordimit me institucionet financiare, mungese besueshmerie tek abonentet per perdorimin e ketyre kanaleve pagesash gje e cila mund te shkaktoje ulje te arketimeve.

Menaxhimi jo i pershtatshem i projektit mund te sjelle vonesa ne dorezimin e tij ose mos realizim te kerkesave ne menyren me optimale.

Mos zbatimi i praktikave te pershtatshme gjate ofrimit te mirembajtjes mund te sjelle nderprje te sherbimit ose procese pune te ngadalta per shkak te mos pergjigjes dhe mos kryerjes se detyrave nga ana e OE.

## 4. QËLLIMI i PUNËS

## 4.1. Të përgjithshme

Institucioni administrues pranë të cilit do të realizohet përmirësimi lidhur me Sistemin AL-BILLING, Pagesat Online dhe Sistemin e Leximeve për Leximet dhe Taksat me Mobile (PDA) dhe trajnimi i përdoruesëve do të jetë Shoqëria Ujësjellës Kanalizime Tiranë Sh.a.

Përmirësimi i moduleve dhe implementimet do të mundësohen edhe remote, ndërsa prezantimet dhe testimet e tyre do të bëhen fizikisht në zyrat e UKT sëbashku me stafin e IT dhe atë përgjegjës sipas moduleve.

Në kuadrin e projektit, kërkohet gjithashtu të rritet siguria dhe qëndrueshmëria e sistemeve të UKT në mënyrë të vecantë komponentet e hapur në modelin web service të nevojeshme për bashkëpunimin me sisteme të jashtme sic janë ato që lidhen me pagesat dhe aksesin e klienteve në portal. Lidhja me bankat duhet te mundesoje gjithashtu edhe marrjen automatike te konfirmimeve te pagesave, te realizuara ne bankat. Per secilen pagese, sistemi duhet te mundesoje rikoncilimin automatik, dhe ndryshimin e gjendjes se fatures ne paguar apo te paguar ne menyre te pjesshme. Këto komponentë kërkohet të instalohen në mënyrë të sigurtë në cloud dhe gjithashtu t'i mbeshteten mjete të larta sigurie.

Komponent tjetër i rëndësishëm është zbatimi i sistemit të raportimit online në një platformë *te tipit BI*, që mundëson në mënyrë të sigurtë dhe të pavarur raportimin e nevojshëm. Sistemi i raportimeve kërkohet gjithashtu të operoje në nje ambjent të sigurtë dhe që lidhet me bazën e të dhënave te AL-Billing.

Ne kuadrin e projektit, kerkohet qe ne kohe reale (nepermjet replikimit) te realizohet ruajtja e nje kopje te te dhenave ne nje database te sigurte *cloud*. Baza e te dhenave dhe baze e te dhenave te sigurte cloud duhet te perdoret ne cdo komunikimet (*Web Service)* te publikuara nga UKT per perdorues te jashtem te infromacionit sikurse jane bankat, shoqerite e pagesave, sistemi i leximit me PDA. Sistemet e jashtme nuk duhet te komunikojne me komponentet e instaluar ne datacenter lokal te UKT por vetem me komponentet ne cloud. Kjo do te ndikoj ne rritjen e shkalles se sigurise.

Keto sherbime, sisteme (baza e te dhenave si dhe sistemi raportimit BI) kerkohet te hostohen, te mbrohen, e te mirembahen ne menyre te integruar direkt nga ofruesi i sherbimit ne cloud. Hostimi si dhe mirembajtja nga ofruesi i sherbimit ne cloud i ketyre komponenteve te mesiper nenkupton qe ofruesi i sherbimit duhet te jene pergjegjes per:

- monitorimin e sistemeve,
- matjen dhe performancen, si dhe nderhyrjet automatike;
- perditesimet dhe patchet qe lidhen me sigurine,
- perditesime automatike te versioneve,
- sigurine dhe aksesin e jashtem mbi sistemet,
- zbatimin e shkalles se larte te ruajtjes se *pasword*-eve dhe te drejtave mbi sistem;
- zbatimin e teknologjive per sigurine;
- zbatimin e teknologjive qe lidhen me rolet dhe shkallen e aksesit mbi te dhena;
- realizimin e backup automatike ne nje datacenter te dyte brenda EU, te pakten 100 Km distance nga datacenter primar;

Sherbimi ne cloud qe do te ofrohet duhet te kete partneritet me prodhuesin e teknologjive te ofruara sic jane database Oracle si dhe zgjidhja BI e ofruar. Kjo garanton qe keto

komponente teknologjike do te jene te instaluara ne menyre optimale dhe qe shpejtesia e nderhyrjes ne rast nevoje te ekipit te support cloud dhe prodhuesit te teknologjise perkatese.

Keto zgjidhje ofrojne shkalle te larte te operimit te sistemeve mbi 99,99% dhe mbrojtje nga humbjet apo demtimin e te dhenave apo aksesi i paautorizuar. Ofruesi i sherbimit cloud, kerkohet gjithashtu te ofroje mjetet dhe teknologjite me te larta te sigurise si Firewall, Intrusion prevention, WAF, backup automatik si dhe identifikimin e sigurte e te shumfishte (multifactor MFA).

Gjithashtu ne forcimin e shkalles se sigurise se sistemit, OE kerkohet qe ne kuadrin e zbatimit te projektit te realizoje dhe levroje dokumentacionin:

- Draft rregullore per operimin e sistemit AL-Billing;
- Draft rregullore per operimin e sistemit të administrimit te Leximeve dhe Taksave me PDA,
- Perditesimin e Manualin te perdorimit te sistemit, dhe perditesimin e tij, pas cdo nderhyrje permiresuese ne sistem. Vecanerisht lidhur me permiresimet e planifikuara ne kete projekt. Keto manual duhet te perfshine edhe komponentet e tjere te sistemit Al-Billing, si Sistemit Raportimit BI, Shërbimit të Pagesave (web service) per shkembimin e te dhenave me Bankat, etj.;
- Diagrama e qarkullimit te Informacionit ne sistemin e Al-Billing;
- Draft rregullore per krijimin dhe mirembatjen e perdoruesve ne sistemin AL-Billing;
- Diagrama e qarkullimit te Informacionit ne sistemin e administrimit te Leximeve dhe Taksave me PDA;
- Draft rregullore per krijimin dhe mirembatjen e perdoruesve ne sistemin e administrimit te Leximeve dhe Taksave me PDA;

### 4.1.1. Kërkesat funksionale

Kërkesat funksionale do të jenë të listuara sipas pikave kryesore që do të realizohen si objekt i këtij prokurimi lidhur me përmirësimin, automatizim dhe integrime të Al-Billing, Sistemi i administrimit te leximeve dhe taksave me PDA dhe Web Serviceve Pagesa për Shoqërinë Ujësjellës Kanalizime Tiranë Sh.a.

***<u>Përmirësimi i Sistemit të Faturimit Al-Billing</u>***

Në këtë kërkesë supozohet që të rishikohen të gjithë format e regjistrimit dhe administrimit të të dhënave me qëllim përmirësimin apo shtimin e informacioneve të reja si dhe azhornimin e atyre egzistuese duke mos u kufizuar vetëm në fusha por edhe funksione.

Pika kryesore por që do të mund të saktësohen apo shtohen në fillim të zhvillimeve dhe implementimit nga grupi i punës janë:

✓ Sistemi te bazohet plotesisht ne teknologji web

✓ Përmirësimi dhe përshtatja e formave të administrimit të abonentit dhe të dhënave të lidhura me të dhe kufizimi për marrjen e të dhënave të detyrueshme si NID, NIPT, etj.

✓ Shtimi i kontrolleve dhe përshtatjeve për njohjen dhe kontrollin e NID si element të detyrueshëm

- ✓ Shtimi i opsionit të printimit të kontratës tip për të gjithë klientët e UKT përfshirë klientët agzistues si dhe të ri
- ✓ Shtimi dhe saktësimi i statuseve të kontratave të abonentëve
- ✓ Shtimi i zonave të furnizimit dhe saktësimi i abonentëve për secilën zonë
- ✓ Saktësimi dhe azhornimi i formës së regjistrimit të matësave dhe të formularit të montimit
- ✓ Identifikimi dhe kontrolli i numrave serialë të matësave dhe njoftimi për dublikata dhe mos lejimi i tyre për regjistrim
- ✓ Shtimi i administrimit të listës së lexuesve dhe lidhja e tyre me UK Reader në formë automatike referuar sinkronizimeve
- ✓ Indeksimi i abonentëve sipas vendndodhjes dhe rrugëve, referuar nevojës si dhe specifikimeve të UKT
- ✓ Shtimi në faturë i njoftimit të detyrmit si me vlerë ashtu edhe me numër faturash
- ✓ Shtim i formës së kontrollit për abonentë pasivë dhe rasteve me anomali me qëllim faturimin e saktë të taksave dhe tarifave
- ✓ Përmirësimi i formës së administrimit të tarifave që të jenë dinamike dhe ndahen në dy tarifime referuar përqindjes së faturimit apo kërkesave të ujësjellësit, dinamike kjo mujore
- ✓ Saktësimi i zonave dhe nënzonave të faturimit dhe përshtatja e tyre me të dhënat e Bashkive dhe Njësive Administrative
- ✓ Përmirësimi dhe përshtatja e formës së konsultimit për shfaqjen e të të gjithë të dhënave të mundshme (kontrollin e faturës së fiskalizuar, faturës së printuar me të gjithë elementët, fotot e matësave, etj.)
- ✓ Shtimi i mundësisë së importimit të leximeve nëpërmjet file csv apo format tjetër për abonentët biznes apo integrimin me sisteme të tjera në dispozicion të UKT
- ✓ Përmirësimi i modulit të pagesave duke shtuar tabela të reja në strukturën e bazës së të dhënave me qëllim mundësimin e pagesave pjesore apo kreditore
- ✓ Azhornimi dhe kalimi i saktë i pagesave të faturave apo kamatave tek këto tabela dhe lidhjet e tyre
- ✓ Kontrolli i raporteve të pagesave egzistuese dhe atyre pas azhornimeve në bazën e të dhënave
- ✓ Krijim, ndarje dhe saktësim të raporteve për faturimin dhe debinë sipas zonave dhe njësive, referuar edhe volumit të të dhënave
- ✓ Përmirësimi dhe saktësimi i të gjithë raporteve të pagesave duke reflektuar ndryshimet në strukturën e të dhënave
- ✓ Përmirësimi dhe shtimin e disa raporteve të kontrollit për të dhënat
    - **Abonenti**
        - Raport auditi për ndryshimet në të dhënat e abonentit me të gjithë elementët si ishin dhe si janë bërë
    - **Faturimi**
        - Faturim total mujor sipas kategorive dhe kontroll sipas zërave

    - Raport kontrolli krahasimor me të njëjtin muaj të vitit paraardhës dhe opsional për të njëjtat kontrata
- **Përdoruesit**
    - Raport auditi për ndryshimet në të dhënat e përdoruesve
    - Raport auditi për veprimet e kryera nga përdorues në sistem (konsultim, update, printim, etj sipas nevojës së UKT)

✓ Shtimi i elementëve të detyrimit ligjor për fiskalizimin në faturë referuar modulin e konsultimit të faturës online (NIVF, NSLF, Datë, etj.)

✓ Saktësimi i arkave, bankave apo kanaleve të tjera të pagesave online si dhe lidhjeve të tyre automatikisht me

✓ Rishikimi dhe përshtatja e modulit të konsultimit të faturës Online me ndryshimet e shtuara në sistemin Al-Billing dhe reflektimin e saktë të të dhënave

✓ Shtimi i opsionit të identifikimit nëpërmjet email dhe lehtësimi i konsultimit online

✓ Shtimi i identifikimit nëpërmjet përdorimit të 2FA me aktivizim nga email si dhe mundësimi i printimit të faturave në nivel abonenti

✓ Mundësojë që kur kërkohet vetëm anullimi i taksave të realizohet pa prekur kunsumin e ujit dhe ky proces të mund të bëhet nëpërmjet dhënien e të drejtës Drejtorisë së Taksave.

✓ Saktësimi i evidencës që pasqyron faturimin e taksave vendore të cdo muaji të ndarë për secilen taksë.

✓ Saktësimi i evidencës që pasqyron faturimin e kamatës progresive ditore dhe mujore.

✓ Saktësimi i evidencës që pasqyron faturimin e vlerës së rilidhjes

✓ Pasqyrimi i faturës së gjobës në SMI dhe rishikimi i procesit

✓ Krijimin e evidencës mujore që të përfshijë zerat e ndarë në nr. abonentesh, konsum ne m3, vlerë konsumi uji në lekë, tarifë dhe taksa vendore

✓ Shtimi i zërave tek raporti arkëtime ditore debitore sic janë të ndarë zërat tëk evidenca e arketimeve të grupuara

✓ Saktësimi dhe rishikimi i AKM ekzistuese dhe saktësimet e nevojshme

✓ Përmirësimi dhe regjistrimi i AKM të dyta, në rastet kur është respektuar AKM e parë

✓ Anullim i një AKM ekzistuese dhe rihedhje e AKM me ndryshime

✓ Mundësimi i cekimit të të gjithë periudhave gjatë regjistrimit të një AKM

✓ Mundësimi i ndryshimit të planit të pagesës së AKM dhe reflektimi i saj në këstet vijuese

✓ Rishikimi i raportit të debisë i cili të mund të nxirret për ditë të caktuara, sipas nevojës duke parë mundësinë e krijimit me procedurë në baza ditore

✓ Të shikohet mundësia që në raportin egzistues të debisë të përfshihen kolonat si me poshtë:

    - Konsumi mujor

- Taksat nga AKM
- Menyre faturimi
- Anomali

***<u>Përmirësimi dhe Implementim i Shërbimit të Pagesave (web service) me palet e treta</u>***

Në këtë kategori do të realizohen jo vetëm pikat e listuara lidhur me përmirësimet por do të përgatitet edhe një dokument teknik që do të përdoret nga operatorët e pagesave për integrimet e nevojshme me shërbimin e pagesave. UKT kërkon që ky shërbim të mos pësojë shumë ndryshime me qëllim që të mos kërkojë shumë punë dhe kohë implementimi nga bankat dhe kanalet e tjera të pagesave.

Pikat kryesore janë:

- ✓ Saktësimi i pagesës dhe realizimi i saj në kohë reale e jo me diferencë kohore
- ✓ Shtimin e kapacitetit të pagesave online si dhe lidhjeve të bankave tregtare apo kanaleve të tjera të pagesave
  - konsiston në zhvillimin e modulit të pagesave dhe ofrimin e këtij shërbimi online për të gjithë subjektet e interesuara në formën e shkëmbimit të të dhënave me web service
  - ky shërbim do të përfshijë metodat: kryej pagesë, konsulto faturën koherente, konsulto faturat e pa paguara të abonentit, etj sipas përcaktimeve të ujësjellësit si dhe shtimin e fushave të detyrueshme referuar adresës apo elementëve të tjerë sipas përcaktimeve të ujësjellësit

Sistemi i pagesave gjatë procesit të përmirësimit do të vendoset në punë dhe do të funksionojë për një kohë të përshtatshme paralel me atë egzistues me qëllim integrimin dhe kalimin e butë të bankave apo kanaleve të tjera të pagesave tek ky sistem.

- ✓ Sistemi duhet të percaktojë një standard bazë për marrjen e të dhënave të arkëtimeve dhe të pagesave nga insitucinoet e pagesave. Të dhënat e marra duhet të përmbajnë të dhënat si mëposhtë:
  - Bankën (Institucionin e Pagesës);
  - Numrin e llogarisë;
  - Monedhen e llogarisë së pagesave;
  - Datën e veprimit;
  - Shumën e arkëtimit (apo të pagesës);
  - Të dhënat e palës dërguese (NIPT apo kodin e klientit);
  - Përshkrimin e veprimit;
  - No e Faturës (faturave) për të cilën është kryer arkëtimi;

- ✓ Në mënyrë të njejtë të dhënat mundet të shkëmbehen me Bankat në disa versione të ndryshme. Format e të dhënave duhet të jenë në të paktën dy formate aktuale në perdorim masiv si ai json apo xml. Zgjedhja e formateve mundet të kryhet nga secila nga IP në veçanti. Çdo informacion e shkëmbyer në këtë mënyre duhet të kryhet vetëm pas idenfikimit të sigurtë midis sistemeve.
- ✓ Në mënyre periodike sistemi duhet të kryej marrjen e të dhënave nga Bankat. Kapacitetet duhet të mundësojne një marrje ditore të informacionit të pagesave. Për çdo të dhënë të marrë nga Bankat, sistemi duhet të mundësojë ruajtjen e tyre në formatin original të pa modifikuar. Sistemi duhet të ruaj këto të dhëna për të paktën një periudhë 1 mujore.

- ✓ Të dhënat e marra duhet të verifikohen (rikoncilohen) përkundrejt të faturave të lëshuara nga UKT. Gjatë këtij procesi sistemi duhet të mundësojë krahasimin e dhënave të pagesës me ato të faturës; dhe në bazë të këtij krahasimi (rikoncilimi) sistemi duhet të shënojë/kategorizojë :
    - Arkëtimet me kategoritë konfirmuar/pakonfirmuar nëse fatura dhe numri nuk përpudhet me ato te UKT;
    - Faturën me numrat serial të veprimeve të pagesës, si dhe datën dhe shumën e pageses se kryer.

- Ne kuadrin e ketij projekti kerkohet qe OE te ndjek te gjithe aspektin teknik te nderfaqes si testimi apo verifikimi nga ana sistemit Al-Billing. Bankat qe do te bejne raportimin, do te kerkohet te kryjne zhvillimet qe lidhet me sistemet e tyre.

Ky sherbim do te ofrohet nga komponente si dhe baza e te dhenave ne cloud. Aksesit *Web Service* ne te dhenat e UKT duhet te ofrohet nga database qe operon ne cloud. Sherbimi i monitorimit, mirëmbajtjen, përditesimin me versionet e reja, sigurise dhe kontrollit te aksesit apo aspekte të tjera të performances dhe te sigurise, duhet te ofrohen direkt nga prodhuesi. Operatori ekonomik ne keto sisteme cloud duhet te ofroje vetem sherbimin e linjes se pare te suportit (*first line of support*).

Te dhenat ne kete baze te dhenash duhet te replikohen ne kohe reale me ato te ruajtura ne bazen e te dhenave te AL-Billing te instaluar brenda serverave te UKT. Kjo ruajtje duhet te realizohen neperjet aplikimit teknologjive te fundit te replikimit te cilat garantojne mos humbje te te dhenave.

***<u>Permiresimi dhe Implementimi i Sistemit të administrimit te Leximeve dhe Taksave me PDA</u>***

Aktualisht sistemi i administrimit te leximeve eshte nje shtese e sistemit te Al-billing persa i perket panelit te administrimit dhe ka App mobile per kryerjen e disa proceseve qe lidhen me mbledhjen e te dhenave te matesve nga operatoret ne terren. Kjo menyre funksionimi nuk ofron fleksibilitet per te kryer ndarjen e akseseve te dy sistemeve. Meqenese App mobile per PDA komunikon me Al-billing nepermjet internetit, kjo konsiderohet nje mangesi sigurie pasi App mobile eshte nje sistem jashte rrjetit te brendshem te UKT. Per te rritur sigurine keto sisteme duhet te jene te ndara. Pra Al-billing dhe sistemi i adminstrimit te leximeve duhet te jene dy sisteme te ndara qe komuikojne mes tyre nepermjet web service te sigurta.

Ky sistem do te jete i instaluar i vecuar nga sistemi Al-Billing, ne cloud e ofertuar nga OE, meqenese ai do te komunikoje me pajisjet PDA me ane te web serviceve. Kjo arkitekture kerkohet per te garantuar qe ne cdo eventualitet sulmi, te ndikohet vetem ky sistem dhe jo sistemi i faturimit Al-Billing.

- ✓ Sistemi te bazohet plotesisht ne teknologji web lidhur me panelin e administrimit dhe te kete App mobile per operatoret qe mbledhin te dhenat ne terren.
- ✓ Leximet duhet te ruhen ne menyre te detajuar per ndryshimet qe administratoret e programit te kene mundesi te shikojne te dhena mbi vleren e vjeter, te re, perdoruesin dhe oren e sakte kur eshte kryer veprimi.
- ✓ Sistemi kryen procedura te qarta per Back Up periodik te te dhenave.

- ✓ Programi duhet te perdore teknika per optimizimin e perdorimit te bandes se internetit.
- ✓ Ne nderfaqen e administrimit perdoruesit te menaxhojne te dhenat te cilat mblidhen nga leximet ne terren, marrin raporte operacionale dhe gjithashtu reporte te ndryshme per leximet dhe raporte te tjera te nevojshme per mireorganizimin e punes.
- ✓ Gjate hedhjes se leximeve per abonentet programi duhet te mundesoje shtimin e problematikave ne nivel te palimituar nenkategorish. Ky informacion duhet te sherbeje per te ndertuar reporte te detajuar per te percaktuar sakte problemet qe kane abonentet dhe veshtiresite qe kane lexuesit gjate punes se tyre.
- ✓ Procesi i leximit duhet te mundesoje krijimin e ndarjes hierarkike zonale duke lejuar keshtu copezimin e zonave ne nen-zona me te menaxhueshme.
- ✓ Procesi i leximit duhet te ofroje mundesi per shtimin e nyjeve teknike ne menyre hierarkike. Tipologjia e nyjeve teknike duhet te jete dinamike per te mundesuar shtimin e metejshem. Per nyjet teknike duhet te ruhet edhe statusi ne te cilin ndodhet. Status i nyjes sherben psh: per te pare impaktin ne rast te riparimeve te ndryshme apo edhe per te gjeneruar njoftime automatike ne te ardhmen.
- ✓ Programi duhet te mundesoje caktimin e zonave lexuesve. Programi duhet te njoftoje ne nje zone i eshte caktuar mepare nje lexuesi tjeter ne menyre te tille qe te behet perdorimi me eficence i burimeve njerezore.
- ✓ Programi duhet te mundesoje percaktimin e itinerarit te leximeve per secilin lexues ne menyre kalendarike per cdo dite. Moduli duhet te siguroje shperndarjen e lexuesve ne menyre te tille qe te mos kete perplasje ndermjet tyre, nuk mund ti caktohet 2 lexuesve te njejtet abonente.
- ✓ Procesi i sinkronizimit duhet te jete automatik dhe real time. Programi duhet te realizoje kalim e te dhenave te marra nga lexuesit ne menyre automatike ne sistemin qendror.
- ✓ Nderveprimi midis aplikacionit per PDA-te dhe komponentes server te instaluar ne cloud duhet te jete i pavarur nga teknologjia e perdorur ne keto dy programe. Standarti i perdorur per komunikimin midis programeve duhet te jete psh: SOAP, REST ose ekuivalent.
- ✓ App mobile i PDA duhet te dergoje te dhena per vendodhje gjeografike te lexuesit ne momentin e marrjes se leximit. Te dhenat gjeografike duhet te dergohen me nje precision sa me te larte.
- ✓ Marrja e pozicionit gjeografik duhet te jete proces i optimizuar ne perdorimin e baterise.
- ✓ Marrja e pozicionit gjeografik duhet te parashikoje situatat kur lexuesit gjenden ne zona pa mbulim nga satelitet si psh: brendesia e godinave etj. Ne kete rast aplikacioni mbeshtetes duhet te raportoje vendodhjen e fundit te sakte qe ka percaktuar nga sinjali GPS.
- ✓ App mobile per PDA duhet te ofroje mundesine e sinkronizimit te mevonshem por gjithashtu duhet te sinkronizoje te dhenat ne kohe reale ne rastet kur gjendet ne zonat me mbulim te sinjalit celular ose wifi.
- ✓ App mobile per PDA duhet te kerkoje berjen e fotografive ne cdo rast ose bazuar mbi logjiken e percaktuar nga administratori i programit ne panelin e administrimit.
- ✓ App mobile per PDA duhet ti shfaqe lexuesit ne menyre te qarte itenerarin e planifikuar nga menaxheret e tyre nepermjet nderfaqes se administrimit.

- ✓ App mobile per PDA duhet te perdore teknikat e kompresimit te informacionit per dergimin e te dhenave ne serverin qendror duke perdorur sa me pak banden e internetit.
- ✓ App mobile per PDA duhet te perdore teknika te verifikimit te dergimit te sakte te te dhenave ne server dhe duhet gjithashtu te perdore teknika te menaxhimit te deshtimit te lidhjes me server apo te nderprerjes se dergimit te te dhenave.
- ✓ App mobile per PDA duhet te perdore teknika per kriptimin e te dhenave te cilat dergon ne server duke parandaluar keshtu interceptimin e tyre nga persona keqdashes.
- ✓ Nderfaqja web e administrimit duhet te ofroje mundesi per inventarizimin e pajisjeve PDA duke lejuar regjistrimin e informacioneve shtese per cdo pajisje si psh: status i pajisjes, personi i cili e ka ne dorezim pajisjen, version i aplikacionit te instaluar ne PDA etj.
- ✓ Nderfaqja web e administrimit duhet te mundesoje shfaqjen e fotografive te ngarkuara ne program nga aplikacioni per PDA.
- ✓ Per cdo leximi te raportuar ne program ne nderfaqen e administrimit duhet te jepet mundesia e paraqitjes ne harte te pozicionit te lexuesit ne momentin e leximit.
- ✓ Nderfaqja web e administrimit duhet te ofroje reporte per nxjerrjen e variacionit te distances nga abonenti ne momentin e leximit te matesit.
- ✓ Nderfaqja web e administrimit duhet te mundesoje shfaqjen ne harte te itinerarit te nje lexuesi ne nje segment kohor te caktuar.
- ✓ Sinkronizimi i te dhenave duhet te perdore teknika te menaxhimit te situatave te konkurences per te evituar rastet e bllokimit te ndersjellte (deadlocks).
- ✓ App mobile i PDA duhet te realizoje perditesimin e vetes nepermjet internetit pa perdorur sherbimet e Google Play ose ekuivalent.
- ✓ App mobile i PDA duhet te ruaje log-e te aktivitetit te perdoruesit dhe duhet te mund ti dergoje keto ne server ne momentin e dergimit te kerkeses nga server.
- ✓ App mobile i PDA duhet te implementoje mesazhet push te cilat mundesojne kryerjen e nje sere aktivitetesh ne PDA pa nevojen qe perdoruesi te kryeje ndonje veprim. Ky funksionalitet lehteson administrimin nga stafi qendror i IT te shoqerise dhe shmang lexuesin nga njohja me funksionalitetet teknike.
- ✓ App mobile i PDA duhet te ndryshoje automatikisht oren dhe daten e sistemit lokal duke bere te mundur sinkronizimin e ores dhe dates me oren dhe daten e server qendror.
- ✓ App mobile te instalohet ne aparatura PDA me sistem operimi Android versione te ndryshme meqenese kete PDA ekzistuese te UKT apo qe mund te prokurohen ne vijim mund te perdorin versione te ndryshme te sistemit te operimit Android.
- ✓ App mobile per PDA duhet te jete i optimizuar per te funksinouar me pajisje mobile te tipit PDA dhe te perdore ne menyre optimale burimet e saj ku nje nder burimet kryesore eshte energjia e baterise se PDA
- ✓ Saktësimi i sigurisë së aksesimit të sistemit nga përdoruesit duke shtuar 2FA
- ✓ Përmirësimi i funksionit për të përcaktuar Location te kontratës në mënyrë qe te mund te percaktojme zonen fiskale te sakte sipas te ciles te behet perllogaritja e takses se baneses.
- ✓ Percaktimi i burimit te informacionit mbi vetedeklarimin e takses se baneses.

- ✓ Te ofrohet raport per perjashtimet, rivendosjet te taksave.
- ✓ Te ofrohet raport mbi faturimin e taksave dhe tarifave vendore.
- ✓ Te ofrohet raport mbi arketimin e taksave dhe tarifave vendore.
- ✓ Te ofrohet raport mbi debine e taksave dhe tarifave vendore.
- ✓ Administrimi i formave të regjistrimit nga grupet e punës në terren
- ✓ Raportimi i faturimit në numrin e leximeve si dhe sasinë m3 referuar lexuesëve si dhe zonave
- ✓ Regjistrimi i të dhënave për verifikimin e ndërtesës së abonentëve duke bërë kontrollin e pikës në terren
- ✓ Raportimi i formularit të deklarimit të ndërtesës dhe vendosjes së taksës së ndërtesës sipas zonës dhe sipërfaqes që ajo mbulon.
- ✓ Ruajtja e historikut të ndryshimeve të informacionit
- ✓ Komunikimi dytrejtimor nepermjet web service SOAP ose REST, nepermjet https, me sistemin e faturimit Al-billing per te automatizuar proceset e marrjedhe dhe dhenies se te dhenave. Ky komunikim te zbatoje parimet e sigurise pe rte shmangur nderhyrjet e pa aurotizuara.
- ✓ Sistemi te mos lejoje akses ne bazen e te dhenave te perdoreusve te pa autorizuar.
- ✓ Baza e te dhenave te kete te konfiguruar perdoruesit me privilegjet minimale qe i duhet per te kryer detyrat e veta, si per perdoruesit e vet sistemit dhe atyre te jashtem qe mund te duhen per shkak te punes se specialisteve te UKT ose sistemeve te tjera qe mdun te duan akses direkt ne bazen e te dhenave.
- ✓ Sistemi te jete e mundur te instalohet si ne sistem operativ Linux ashtu edhe Windows ose ekuivalent me keto.
- ✓ Programi duhet te kete mundesine e krijimit te nje llogarie per secilin perdorues. Te dhenat e nevojshme per te krijuar nje llogari jane:

  · Emri - Emri i perdoruesit

  · Mbiemri – Mbiemri i perdoruesit

  · Perdoruesi - Emri me te cilin programi identifikon kete perdorues.

  · Email - Adresa e -mail e perdoruesit

  · Fjalekalimi - Fillimisht, vendoset nje fjalekalim standard, pastaj secili perdorues mund ta vendose ate te personalizuar.

  · Roli - Roli qe perdoruesi do te kete ne program

  · Statusi – Statusi i perdoruesit aktiv/jo aktiv. Ne momentin e krijimit te perdoruesit te jete automatikisht aktiv
- ✓ Bazuar ne rolin qe i eshte caktuar nje perdoruesi, kur krijohet nga Administratori i sistemit, te shfaqet nje nderfaqe specifike per rolin qe ai ka dhe qe i lejon atij te kryeje veprimet qe i takojne.
- ✓ Programi te ofroje opsione privilegjesh dhe politika aksesi per perdoruesit, rolet, leximin-shkrimin, vetem leximin, modifikimin etj. Programi te ofroje mekanizma te ndryshem vertetimi dhe mundesi te shumta sigurie.

- ✓ Programi te aplikoje politikat e aksesit mbi modulin; menune; nen-menune; skedarin, dokumentin ose objektin, veprime te caktuara, etj.
- ✓ Programi te aplikoje nivele te shumta te te drejtave te aksesit (Fshi / Modifiko / Shiko / Ngarko / Shkarko, etj.).
- ✓ Programi te mundesoje qe opsionet te jene dinamike sipas perdoruesve - per shembull, grupe te ndryshme mund te shikojne rekorde te ndryshme ne te njejten nderfaqe.
- ✓ Programi te mundesoje ndryshimin e dukshmerise/shfaqjes ne menyre dinamike ne nderfaqet.
- ✓ Programi te siguroje aftesine per te gjeneruar raporte per te gjitha nivelet e perdoruesve dhe skedareve.
- ✓ Programi te mundesoje qasje te kufizuar per perdorues te caktuar.
- ✓ Çdo veprim ne program te regjistrohet (permes logs) duke percaktuar qarte perdoruesin, kohen e veprimit (kohezgjatjen), llojin e veprimit (lexim, ndryshim, perditesim), te dhenat e ndryshuara, IP-ne e perdoruesit, etj.
- ✓ Programi te siguroje nderfaqet perkatese per paraqitjen e logs si dhe mundesine per filtrimin e tyre, per gjurmim te shpejte.
- ✓ Programi te siguroje aftesine per te gjurmuar per qellime auditimi, madje edhe objektet e bazes se te dhenave per veprimet qe manipulojne informacionin: krijimin, modifikimin dhe fshirjen ne nivelin e perdoruesit dhe skedarit.
- ✓ Ndryshimi i fjalekalimit nga perdoruesit te kryhet permes mekanizmave te cilat mundesojne siguri maksimale.
- ✓ Kodi burimor i programit duhet te ruhet ne nje sistem versionimi GIT/SVN/CVS ose ekuivalent. Aplikimi dhe menaxhimi i shtimeve apo modifikimeve te funksionaliteteve duhet te behet sipas procedurave operative te mirepercaktuara e transparente me AK-ne te cilat duhet te perfshijne plane per rikthimin ne gjendjen e meparshme te sistemit ne rast deshtimi.
- ✓ Licensa e perdorimit te programit gjate gjithe shtrirjes se kontrates sipas kohezgjatjes dhe kerkesave percaktuar ne keto terma reference duhet te jete e evidentuar edhe ne Aplikacion mobile dhe nderfaqen e administrimit.

### 4.1.2. Kërkesat teknike

Përmirësimet e mëtejshme të sistemit të Faturimit Al-Billing duhet të konsistojnë në përmirësimet cilësore të mbështetjes së proceseve të administrimit të abonentëve, faturimit dhe faturave, akt-marrveshjeve, monitorimit të faturimit si për leximet ashtu edhe taksat, pagesave jo vetëm në arkat e UKT por edhe atyre online nëpërmjet web service me palët e treta, leximeve dhe taksave, si dhe module të tjera të lidhura me to, duke qënë sa me e thjeshtë për përdoruesit.

Kërkesë teknike e kërkuar edhe nga auditimet është mbyllja e vulnerabiliteteve dhe rritja e sigurisë duke e kaluar sistemin në versionet më të fundit të Apache dhe PHP me minimalisht në versionin e fundit stabël 8.2.8, kjo duke ruajtur te gjitha funksionalitetet aktuale të sistemit të faturimit Al-Billing dhe funksionimin normal të tij sebashku me të gjithë modulet apo integrimet e nevojshme.

Implementimin dhe vendosjen e certifikatës së sigurisë HTTPS (HyperText Trasfer Protocol Secure) në mënyrë që të krijohet një kanal i sigurtë për aksesimin e sistemit të faturim-arkëtimit Al-Billing.

Referuar bazës së të dhënave kërkesë teknike është kalimi me Oracle Database 21c me suport në mënyrë që të mbyllen problematikat e sistemit lidhur me suportin, sigurinë dhe vulnerabilitetet. Shtuar këtu edhe implementimin e sistemit të auditimit me qëllim rritjen e sigurisë së përdoruesve dhe bllokimin e aksesit të pa autorizuar në bazën e të dhënave por edhe sistemit të faturimit Al-Billing në tërësi.

Pikat kryesore jane:

- ✓ Riorganizimi nga forma e aplikimit dhe organizimit të informacionit duke sjellë përshtatjen e ndërfaqeve të sistemit të faturimit Al-Billing




- ✓ Përmirësimet e ndërfaqeve responsive për përshtatje të shfaqjes së informacionit sipas pajisjeve përfshirë ato mobile
- ✓ Krijimin dhe shtimin e një dashboard ku të shfaqet pamja 360 gradë e Abonentit duke përfshirë të gjithë informacionin e tij sëbashku me historikun e ndryshimeve
- ✓ Ristrukturimi dhe normalizimi i bazës së të dhënave të sistemit të faturimit dhe moduleve
- ✓ Ndarja e të dhënave të pagesave duke mundësuar shtimin e tabelave referuese
- ✓ Ngritja e prcedurave automatike për procesimin e pagesave pjesore apo kreditore të abonentëve referuar kontratave
- ✓ Migrimi dhe kontrolli i kalimit të të dhënave të pagesave si dhe raportimi i tyre
- ✓ Dokumentim i bazës së të dhënave të sistemit të faturimit dhe moduleve
- ✓ Rishikimin i indekseve dhe të gjithë SQL-ve që vonojnë dhe kanë nevojë për normalizim
- ✓ Implementim i sistemit të auditimit të bazave të të dhënave Oracle si core audit application

- Konsiston në mbrojtjen kundër kërcënimeve të huaja dhe/ose të brendshme, akseset e paautorizuar dhe zbatim të ndarjes së detyrave në përmbushjen e kërkesave të pajtueshmërisë rregullatore, ato të jashtme ose të brendshme.
- Auditimit të vazhdueshëm dhe mbrojtjes në kohë reale, duke ofruar shikueshmëri dhe kontroll të qartë në aktivitetin e bazës së të dhënave, madje edhe për përdoruesit e privilegjuar dhe më shumë, DBA-të
- Limitimi i akseseve duke siguruar që baza e të dhënave aksesohet vetëm nga aplikimet dhe sipas përcaktimeve të orareve dhe procedurave të UKT
- Krijimi dhe prezantimi i raporteve standarte të auditit për përdoruesit, akseset, si dhe cdo aktivitet që kryhet në database sipas përcaktimeve të UKT

✓ Saktësim dhe implementim auditi në nivel aplikimi dhe raportimi adekuat i detajuar

✓ Saktësimi dhe draftimi i procedurës së backup dhe përfshirja e të gjithë skemave në këtë procedurë

✓ Shtimi i sigurisë së aksesimit të sistemit nga përdoruesit duke shtuar 2FA

✓ Implementimi i sistemit të faturimit Al-Billing, leximeve dhe bazës së të dhënave në sistemin operativ Linux

✓ Qendrueshmëria dhe Zgjerueshmëria e Sistemit

✓ Versionimi dhe aplikimi i modifikimeve të lidhura me zhvillimet

✓ Ruajtja e historikut të ndryshimeve të leximeve, faturimeve dhe arkëtimeve

✓ Trajnimin e IT për zhvillim dhe përshtatje të sistemit

### 4.1.3. Ambjenti cloud për shërbimet Online

Komponentet online të sistemit që lidhen me aksesin nga jashtë të sistemin AL-Billing kërkohet të instalohen në një ambjent të sigurtë në cloud. Komponentet e sistemit si baza e të dhënave dhe aplikimi për arsye sigurie kërkohet të zbatohen në dy ambjente të vecanta. Baza e të dhënave kërkohet të hostohet si shërbim, ndërsa aplikimi kërkohet të zbatohet në server të dedikuar për këtë qëllim.

Me konkretisht kërkesat janë:

✓ Server në cloud, kërkohet të jetë i personalizueshëm në OCPU dhe në memorie duke optimizuar performancën; Ai duhet të ofrojë, mundësi konfigurimi në mënyrë dinamike të performancës CPU apo RAM pa qenë e nevojshme të ndërpriten (shutdown) shërbimet.

✓ Të ofrojë maksimizim të sigurisë, për të kufuzuar aksesin nga persona të paautorizuar. Aksesi në infrasturkturën cloud duhet të përcaktohet nga personeli teknik i UKT.

✓ Infrastuktura cloud të mos ketë kufizime për sistemet e operimit apo bazat e të dhënave që operojnë në të. Në shtesë, Cloud duhet të ofrojë mundësinë për backup të të dhënave në një infrastukturë, server cloud që do të ruaj në mënyrë automatike kopje të të dhënave.

✓ Kapacitetet e kërkuara janë minimalisht Procesorë - 10 Core; Ram - 16 GB; Storage - 1TB;

- ✓ Makinë virtuale: Resources më sipër (procesor, ram, storage) të kenë mundësi dinamike për t'u konfigurar në makina dhe OS të ndryshëm sipas nevojës.

Ndërsa shërbimet kryesore të sigurisë së ofruar, janë:

- ✓ *VPN*: Lidhja Site to Site në mënyrë të sigurt rrjetin pajisjet on-premise dhe platformës Cloud.
- ✓ *Web Application Firewall (WAF)*: Platforma cloud duhet të mundesojë politikat e sigurisë WAF për (Threat Detection, Traffic Management)
- ✓ *Backup Policies*: Boot Volumes & Block Volumes: Politika për ruajten e backupe-ve ditor, javor, mujore, vjetore. Platforma cloud duhet të ofrojë mundësi dinamike për të konfiguruar dhe  ndryshuar politikat e backup-it sipas nevojës.
- ✓ *Monitorimi:* Platforma cloud duhet të ofrojë mundësin për të monitoruar shërbimet dhe ti dërgoj klientit alerts dhe njoftime nëpërmjet emailit dhe sms.
- ✓ *Hyrje nëpëmjet metodës se identifikimit të dyfishtë* – Cdo ndërhyrje apo mirëmbajtje në sistem duhet të mundësohet nëpërmjet idenfikimit të sigurtë të personelit teknik. Për këtë platforma duhet të mundësojë minimalisht mekanizëm të identifikimit të dyfishtë. Kjo duhet të mundësohet nëpëmjet konfirmimit me email, sms, aplikim celsash mobile.

### 4.1.4. Sistem i Hostuar i raportimit inteligjent online i tipit BI (Bussines Intelligence)

Pjesë e projektit është ofrimi i një plafrome të raportimit në formatin e sistemi Inteligjencë Raportimi. Sistemi duhet të ofrojë mundësi standarte të sigurisë si dhe mënyra të reja për të shpërndarë raporte apo analiza për përdorues të vecantë, grupe përdoruesish apo analiza të përgjitheshme për të gjitha njësite organizative në UKT.

Sistemi, duhet të ofrojë mjetet dhe teknikat për analizën dhe raportimin e të dhënave që nga marrja e të dhënave nga burime të ndryshme, në zbulimin e shpejtë dhë të rrjedhshëm deri tek ngarkimi dhe kombinimi i thjeshtë apo i sofistikuar i të dhënave, pregatitjen e të dhënave të linjës, pasurimin e të dhënave, pagaqitjen (vizualizimin) automatik, përshkrimin e të dhënave.

Sistemi i ri BI në cloud, kërkohet të ketë:

- ✓ Vetshërbim, qasjen për të mundësuar përdoruesit të krijojnë paraqitje grafike për shfaqjen e rezultateve dhe ndarjen e tyre me kolegët
- ✓ Pregatitjen dhe pasurimin e të dhënave, që do të ndërtohen në platformën e raportimit
- ✓ Modelimin e skenarëve të biznesit, për analizën multidimensionale dhe analitikës grafike/vizuale
- ✓ Akses në celular që mëson rutinen e përdoruesit dhe jep njohuri në kohën dhe vendndodhjen e duhur lidhur me aktivitetin e përditshëm
- ✓ Raportim të operacioneve si dhe sigurinë me një modelim analize që lidh kompleksitetin e të dhënave në terma operacionesh të njohura si dhe të mundësojë të dhëna të konsoliduara në nivele të ndryshme të organizatës (departamente; projekte apo shërbime).

- ✓ Burim i vetëm i të dhënave të rëndesishme dhe të verteta të ndërmarrjes duke përdorur një shtresë modelimi të të dhënave
- ✓ Analizë vet-mësimore që ofron njohuri proactive për paraqitje të dhënave në celularë
- ✓ Opsione për ngarkimin dhe përzierjen e të dhënave dhe integrimin midis të dhënave të sistemeve apo njësive të ndryshme
- ✓ Pregatitje dhe pasurimi (enrichment) i të dhënave operacionale me të dhënat personale, njësive organizative të vecanta apo ato në nivel organizate;
- ✓ Siguri të të dhënave ne nivel analitik. Prsh sistemi mundet të mundësojë paraqitjen e të dhënave në nivel të agreguar llogarie, por të ndalojë paraqitjen e veprimeve të vecanta
- ✓ Sistemi duhet të mundësojë zgjerimin në cdo kohë të kapaciteteve teknike (processor; disk apo memorie). Ky ndryshim i kapaciteteve duhet të mundësohet në mënyrë të vazhdueshme dhe pa sjell nevojën për ndërprerjen e shërbimit
- ✓ Modelimin e të dhënave të thjeshta apo në shtresa të ndryshme për të mbështetur analizën dhe përkufizimin e biznesit
- ✓ Lidhje e optimizuar në komunikimin/marrjen e të dhënave të ruajtura në sistemet on-premise; për të mundësuar marrjen e diferencuar të të dhënave duke evituar ri-marrjen e të dhënave të marra apo analizuara më parë
- ✓ Sistemi duhet të lejojë konektorë të ndryshem (pa kufizuar) për lidhje me baza të dhënash kryesore në treg përfshirë ato Oracle, MySQL, MSSQL; Postgress; MS ACCESS; Excel; CSV etj.. Vec aksesit direkt në baza të dhënash apo file të strukturuar sistemi duhet të mundësojë edhe lidhje nëpëmjet JDBC.
- ✓ Sistemi duhet të ofrojë paraqitje grafike/vizuale të të dhënave si dhe proceseve të përpunimit të të dhënave, duke mundësuar ndërhyrjen dhe ndryshimin apo përmirësimin e proceseve të pasurimin (enrichment) e të dhenave në mënyre sa me të thjeshtë, sigurtë dhe të kontroluar.

### 4.1.5. Hapësira gjeografike

Përmirësimet e moduleve dhe implementimet lidhur me Sistemin AL-BILLING, Pagesat Online me palët e treta dhe implementimi i Sistemit te administrimit te Leximeve për Leximet dhe Taksat me Mobile (PDA) do të mundësohen të realizohen edhe remote, ndërsa prezantimet, testimet e tyre dhe trajnimi i përdoruesëve do të bëhen fizikisht në zyrat e Ujësjellës Kanalizime Tiranë Sh.a. së bashku me stafin e IT dhe atë përgjegjës sipas moduleve.

### 4.1.6. Siguria e Sistemit

Kërkesat për sigurinë e sistemit janë të përcaktuara qartësisht në seksionet e kërkesave funksionale dhe atyre teknike, si përsa i përket sigurisë dhe roleve të përdoruesëve (moduli i hyrjes në system dhe moduli i roleve dhe përdoruesëve) ashtu edhe sigurinë e infrastrukturës, backup, etj.

Çdo përdorues do të njihet nga sistemi në mënyrë që ai të ketë të drejtë të hyjë në të me anë të identifikimit me përdorues unik dhe fjalëkalimin e tij personal. Vetëm pas identifikimit të tij me të drejta plotësisht të përcaktuar, ai mund të vijojë me punën.

Të gjithë të dhënat e ruajtura në aplikacion, përfshirë edhe ato të konfigurimeve si dhe të përdoruesëve të sistemit duhet të ruhen në një bazë të dhënash RDBMS e cila plotëson kërkesat në lidhje me integritetin e të dhënave dhe sigurisë. Baza e te dhenave duhet te jete e konfiguruar sipas nevojave te perdorimit te UKT per te qene e sigurt dhe performante. Skemat e bazave tete dhenave duhet te jene ndertuar te tilla per te plotesuar nevojat oepracionale por edhe ato te raportimit. Keto baza te dhenash duhet te kene te mirekonfiguruar perdoruesit qe te kene te drejta vetem ne objektet e nevojshme dhe te aksesojne me username dhe password te vecante. Keto baza te dhenash te mos lejohet te aksesohen nga perdorues te pa autorizuar pa kredecinalet perkatese.

Sistemi duhet të suportojë mjete efiçente auditimi, aktivizimin e ruajtjes së historikut dhe të ndryshimeve, përcaktimin e historikut të të gjithë veprimeve të të shkuarës dhe të ardhmes (modifikim, shtim, fshirje). Ruajtja të realizohet për të dhëna specifike në tabela dhe forma të cilat mund të zgjidhen nga administratorët e sistemit.

Sistemi i auditimit të bazave të të dhënave Oracle si Core Audit Application do të duhet të konfigurohet që të sigurojë bllokimin e aksesimit të bazës së të dhënave për ndërhyrje të pa autorizuara, dhe të mbrojë tabelat kryesore të sistemit të faturimit dhe pagesave duke mundësuar dhe dërguar njoftime sigurie tek stafi i IT të UKT.

Verifikimin e të gjithë përdoruesve në sistem duke saktësuar përdoruesit aktiv të lidhur me punonjës konkretë dhe implementuar të gjithë politikat e sigurisë dhe në rakordim me IT lidhur me aksesin dhe fjalkalimet.

Operatori Ekomomik detyrohet të zbatojë rregullat e sigurisë. UKT do te përcaktojë *Politike dhe Rregulla* baze te realizimit të lidhjes së sigurtë. Keto perfshinë raportimin e lidhjeve dhe aksesit VPN. Qëllimi i raportimit, është përdorimi i lidhjeve si dhe informimi/raportimi i problematikave për aksesin dhe përdorimin jo të sigurtë të aksesit dhe të dhënave. *Shkelje e rregullave të aksesit dhe lidhjes VPN do te rezultoje në ndërprerje të shërbimit VPN;*

Administrimi i përdoruesve, në sistemin Al-Billing;

(1) Në sistem, nuk duhet të lejohen përdorues të pa lidhur me një rol, funksion si dhe detyrë specifike.
(2) Cdo krijim i përdoruesve në sistem duhet të shoqërohet me logs të veprimtarisë. Keto duhet të përmbajnë User të sistem që krijoj, ndryshoj apo te fshi përdorues në sistem.
(3) Shtimi i funksionit, *First log-in*. Sipas ketij funksioni, përdoruesi i ri në sistem, duhet ti kërkohet ndryshimi i password fillestar përpara se të lejohet të aksesojë sistemin.
(4) Shtimi i kompleksitetit të password;
(5) Shtimi i funksionit “ndrysho fjalëkalimin në log-im e radhës’, sipas te cilit përdoruesit e përzgjedhur do të kenë të detyrueshme ndryshimin e fjale-kalimit përpara lejimit të aksesit në sistem (ne sesionin e ardhshem).

### 4.1.7. Trajnimi i perdoruesve

Sistemi i billing, permiresimet dhe komponentet e rinj software dhe infrastrukture qe mendohet te aplikohen, konsiderohen nga UKT si nje nder permiresimet kryesore operacionale te pritshme. Nderkohe qe suksesi i projektit si dhe i shkalles se adoptimit te permiresimeve eshte i lidhur ngushte me njohurite e perdoruesve te sistemit, qe eshte personel teknik dhe operacional.

Per kete, mendohet qe zbatimi i ndryshimeve te shoqerohet edhe me trajnimin e punonjesve kryesor. Ky trajnim duhet minimalisht te konsistoje ne organizimin e klasave te vecanta per cdo permiresim te realizuar. Trajnimi duhet te organizohet ne klasat te vecanta, ndersa disa nga kerkesat e organizimit, jane si meposhte:

(1) Klasat duhet te organizohen ne grupe jo me shume se 10 persona;
(2) Klasat duhet te konsistojne ne pjesen teorike te ndryshimeve te realizuara, si dhe ne pjesen praktike ku pjesmarresit ne klasa duhet te realizojne praktike te perdorimit te sistemit apo te permiresimeve te realizuara. Ndarja midis teorise dhe praktikes duhet te jete ne masen 50 me 50.
(3) Materialet duhet te perfshijne materiale elektronike per temat e trajnimit, dhe keto materiale duhet te konsultohen paraprakisht me ndjekesit e projektit nga UKT. Materialet duhet te dergohen pjesmarresve ne klasa perpara organizimit te klases perkatese.
(4) Ne organizimin e klasave, UKT do te ofroje amjentet dhe logjistiken per organzimin e trajnimit. Kjo do te perfshije projektore, tabele shkrimi si dhe kompjutera ne te paten 50% te pjesmarresve.
(5) Ne fund te trajnimit, sebashku me ndjekesin e kontrates nga UKT kerkohet te organizohet nje testim per ecurine e trajnimit.

## 5. KOHA E PËRGJIGJES PËR SHËRBIMET E OFRUARA

Koha e përgjigjes/veprimit për zgjidhjen e problemeve të mbeshtetur në përshkrimin e efektit përcaktohet në Tabela e Kohës së Përgjigjes për Shërbimet e Ofruara.

- Fillimi i shërbimit të mirëmbajtjes së sistemit duhet të fillojë jo më vonë se 15 ditë nga nënshkrimi i kontratës;

- Levrimi i sistemeve, licensave, ambjentit cloud si dhe opsioneve duhet të lëvrohen në jo me vone se 15 dite nga nënshkrimi i kontratës;

- Përmiresimet e Al-Billing dhe instalimi i sistemit te adminsitrimit te Leximeve dhe Taksave me PDA, do të duhet të kryhen sipas periudhës së përcaktuar në komponentet e sistemit dhe jo më vonë se 6 muaj nga nënshkrimi i kontratës.

## 6. MIRËMBAJTJA

Të gjitha konfigurimet që do të bëhen gjatë kohës së suportit do të dokumentohen dhe duhet të dorezohen nga kontraktuesi në format elektronik dhe në hard copy. Aksesi për përdorim të sistemit gjatë kohës së suportit duhet të kërkohet nga kontraktori tek përfituesi me formë zyrtare.

Kompania duhet të ofrojë shërbime të mirëmbajtjes sipas niveleve të shërbimit dhe metodikës së përshkruar më poshtë.

### 6.1 Shërbime të Mirëmbajtjes Parandaluese

Operatori ekonomik duhet të ndërmarrë, në mënyrë periodike një herë në muaj, Shërbime të Mirëmbajtjes Parandaluese për të gjitha aplikacionet e listuara në tabelen e listës së fumizimeve. Shërbimet Parandaluese, janë shërbime proaktive të cilat do të mundësojnë dedektimin në kohë të problematikave, dhe do mundësojnë ndërmarijen në kohë të hapave rekuperuese, për të mos patur ndërprerje të shërbimit.

Të gjitha shërbimet e mirëmbajtjes parandaluese do të kryhen pranë përfituesit të shërbimit, përvec rasteve kur përfituesi i shërbimit përcakton një vendndodhje të re për kryerijen e ketyre shërbimeve.

### 6.2 Shërbime Riparimi në Vendodhje

Operatori ekonomik duhet të jetë i disponueshëm gjatë intervaleve kohore nga e Hëna në të Premte, 8x5, për të ofruar Shërbime të Riparimit në përgjigje të “Alarmeve Madhore” të raportuara nga personeli i autorizuar i përfituesit të shërbimit ("Emergency On-Call Hours"). Për këtë qëllim, me termin Alarm Madhor do të kuptohet parashtrimi i kërkesës për Shërbime Riparimi të ndërmarra në rast të keqfunksionimit të software-ve të mbuluara, që i pengon ato të operojnë në përputhje me Specifikimet dhe shkaktojnë ndërprerje të menjëhereshëm e të konsiderueshme të sistemit dhe që, nuk mund të shmangeshin me anë të ndërhyrjeve dhe riparimeve minore të kryera nga stafi teknik i përfituesit të shërbimit dhe të rekomanduara nga operatori ekonomik. Problemet që nuk i përkasin “Alarmeve Madhore”, duhet të adresohen nën Shërbime të Mirëmbajtjes Parandaluese.

### 6.3 Njoftimi dhe Njohja e Alarmeve Madhore

Përfituesi i shërbimit do të njoftojë operatorin ekonomik me telefon, postë elektronike ose duke sinjalizuar nëpërmjet një ndërfaqeje web të vënë në dispozicion, dhe do të presë të kontaktohet nga operatori ekonomik me telefon, gjatë “Emergency On-Call Hours”. Operatori ekonomik duhet të kontaktojë përfituesin e shërbimit dhe të konfirmojnë marrjen e Alarmit Madhor brenda 30 minutave nga marrja e njoftimit nga personeli i autorizuar i përfituesit të shërbimit. Në momentin e njohjes së thirrjes nga operatori ekonomik, do të vërë në dispozicion informacione të paracaktuara në Procedurat e Troubleshooting nga operatori ekonomik, dhe do ta asistojë atë gjatë diagnostikimit të problemit të raportuar. Do të kooperojë me kërkesën e operatorit ekonomik për ta ndihmuar atë, në përcaktimin e

shkakut të problemit të raportuar dhe në përcaktimin e nevojës për vizitë në vendndodhje për të kryer Shërbimet e Riparimit.

### 6.4 Përgjigjja ndaj Alarmeve Madhore

Nëse operatori ekonomik nuk mund të përcaktojë nëpërmjet Informacionit të mbledhur nga Procedurat e Troubleshooting, shkakun e Alarmit madhor, atëherë ai duhet të dërgojnë një Teknik Shërbimi pranë përfituesit të shërbimit brenda intervalit kohor prej dy (2) orësh nga momenti i marrjes së njoftimit për Alarm Madhor. Me të mbërritur, tekniku i kompanisë do të mbështetet me asistencë nga përfituesi i shërbimit dhe do ti jepet liri veprimi në mjediset dhe sistemet e mbuluara, për të filluar mënjeherë procedurat e diagnostikimit dhe riparimit.

### 6.5 Veprimtaritë e Diagnostikimit dhe Riparimit

Me të mbërritur në vendndodhje, tekniku i shërbimit duhet të fillojë procedurat e diagnostikimit dhe riparimit. Këto veprimtari duhet të vazhdojnë deri sa (a) Alarmi madhor të jetë korrektuar ose të jetë "zgjidhur në mënyrë të tërthortë", (b) tekniku të jetë zëvendesuar nga një person tjetër, (c) Operatori ekonomik të përcaktojë se problemi i raportuar nuk është shkaktuar nga ndonjë keqfunksionim i Sistemeve të mbuluara ose (d) Operatori ekonomik arrin në konkluzion që diagnostikimi ose korrektimi i mëtejshëm mund të shtyhet deri në mbërritjen e pjeseve të këmbimit.

Tekniket e shërbimit të kompanisë duhet të jenë të trajnuar, certifikuar dhe autorizuar për të ndërvepruar në mënyrë direkte me prodhuesit.

Kompania duhet të krijojë/diskutojë me përfituesin e shërbimit një axhende periodike kontrollesh si më poshtë:

**Mujore**

- ✓ Testim / kontroll i kompletuar i komponteve softuerik së klientit
- ✓ Kontroll i detajuar i log-eve software
- ✓ Rishikim i të dhënave mbi performancën e komponteve softuerikë
- ✓ Rekomandime për upgrade të mundshme software

### 6.7 KATEGORIZIMI I PROBLEMEVE DHE KOHA E PËRGJIGJËS

Në tabelën e mëposhtme përcaktohet kategorizimi i seriozitetit të problemeve dhe koha e përgjigjes për zgjidhjen e tyre gjatë përiudhes së mirëmbajtjes.

| **Serioziteti 1 (Kritik/ i Lartë)** | **Serioziteti 2 (I Mesëm)** | **Serioziteti 3 (I Ulët)** |
|---|---|---|
| **Rrezikimi i aktivitetit ekonomik dhe detyrime financiare** | | |

| | | |
|---|---|---|
| Mos funksionimi i aplikacionit krijon detyrime finaciare të mëdha për përdoruesit ose rrezikon shumë aktivitetin ekonomik të përdoruesve | Mos funksionimi i aplikacionit krijon detyrime finaciare të konsiderushme për përdoruesit ose rrezikon konsiderueshëm aktivitetin ekonomik të përdoruesve | Mos funksionimi i aplikacionit krijon detyrime finaciare minimale për përdoruesit ose rrezikon në mënyrë minimal aktivitetin ekonomik të përdoruesve |
| **Pezullimi i punës** | | |
| Mos funksionimi i aplikacionit pengon përdoruesit të realizojnë pjesën më të madhe të punës së tyre. | Mos funksionimi i aplikacionit pengon përdoruesit të realizojnë disa pjesë të vogla të punës së tyre, por ata janë në gjendje të realizojnë pjesën tjetër. Mund të përfshijë gjithashtu pyetje dhe përgjigje për information. | Mos funksionimi i aplikacionit pengon përdoruesit të realizojnë një pjesë të vogël të punës së tyre, por ata janë në gjendje të realizojnë pjesën tjetër |
| **Numri i përdoruesve të ndikuar** | | |
| Mos funksionimi i aplikacionit ndikon një numër shumë të madh të përdoruesve | Mos funksionimi i aplikacionit ndikon një numër shumë të vogël të përdoruesve | Mos funksionimi i aplikacionit ndikon ne 1 (një) ose 2 (dy) përdorues |
| **Zgjidhje alternative e përkohshme [Kjo ka peshën më të madhe të karakteristikave të Seriozitetit 1 dhe 2]** | | |
| Nuk ka një mënyrë alternative të përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit (p.sh. puna nuk mund të realizohet në një mënyrë tjetër) | Mund të ketë ose jo një mënyrë alternative të përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit. | Potencialisht ekziston një mënyrë alternative e përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit. |
| **Koha e përgjigjes** | | |
| Brenda një ore | Brenda 8 (tetë) orëve ose ditën tjetër të punës. | Brenda 8 (tetë) orëve ose ditën tjetër të punës. |
| **Koha e zgjidhjes** | | |
| Maksimumi i pranimit të zgjidhjes është 24 orë të vazhdueshme pas kontaktit të parë. | Maksimumi i pranimit të zgjidhjes është brenda 20 ditëve të vazhdueshme të punës. | Maksimumi i pranimit të zgjidhjes është 45 ditë kalendarike. |

## 7. TABELA E ZËRAVE

Në tabelën e mëposhtme jepet lista e komponenteve objekt i shërbimeve nga Operatori Ekonomik.

| NR | EMËRTIMI | Njesia | SASIA | AFATI lëvrimit, nga nënshkrikimi |
|---|---|---|---|---|
| **1** | Përmirësimi dhe Përshtatja e Sistemit të Faturimit Al-Billing (ose ekuivalent) | Set | 1 | **4 muaj** |
| **2** | Përmirësimi dhe Implementim i Shërbimit të Pagesave (web service) me palët e treta. Lidhja me 1 nga Bankat (*). | Set | 1 | **6 muaj** |
| **3** | Permiresimi dhe Implementimi i Sistemit të administrimit te Leximeve dhe Taksave me PDA | Set | 1 | **6 muaj** |
| **4** | Oracle Database Enterprise Edition (Processor License, së bashku me shërbimin e Partitioning) ose ekuivalente, *përfshirë shërbimet që lidhen me zbatimin dhe migrimin, dhe* ***shërbimet e replikimit online me bazën e të dhënave Cloud***. | Procesore | 3 | **15 dite** |
| **5** | Sistemim i auditimit të bazave të të dhënave Oracle si Core Audit Application (Processor License) ose ekuivalente. | Procesore | 3 | **15 dite** |
| **6** | Server cloud së bashku me mbrotjen e të dhënave, për zbatimin e komponenteve online me bankat si dhe me klientet (vite) | Vite | 3 | **15 dite** |
| **7** | Bazë e të dhënave të hostura Oracle e integruar me bazën e të dhënave në on-premise (vite) | Vite | 3 | **15 dite** |
| **8** | Sistemi i hostuar i raportimit BI, me një numër minimal prej 10 përdoruesish (vite) | Vite | 3 | **15 dite** |
| **9** | Mirëmbajtje dhe garanci prodhuesi per Sistemit të Faturimit Al-Billing(ose ekuivalent), Reader, Taksa dhe WS të pagesave, **bazat e te dhenave enterprise edition**, **particionimit**, **core audit** për periudhë vjecare (vite) (**) | Vite | 3 | **15 dite** |
| **10** | Administrimi i Projektit si dhe levrimi i dokumentacioneve baze te sistemit :<br>- Draft rregullore per operimin e sistemit AL-Billing(ose ekuivalent);<br>- Draft rregullore per operimin e sistemit të administrimit te Leximeve dhe Taksave me PDA,<br>- Perditesimin e Manualin te perdorimit te sistemit, dhe perditesimin e tij, pas cdo nderhyrje permiresuese ne sistem. | Muaj | 6 | **6 muaj** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Vecanerisht lidhur me permiresimet e planifikuara ne kete projekt. Keto manual duhet te perfshine edhe komponentet e tjere te sistemit Al-Billing (ose ekuivalent), si Sistemit Raportimit BI, Shërbimit të Pagesave (web service) per shkembimin e te dhenave me Bankat, etj.;<br>- Diagrama e qarkullimit te Informacionit ne sistemin e Al-Billing(ose ekuivalent);<br>- Draft rregullore per krijimin dhe mirembatjen e perdoruesve ne sistemin AL-Billing(ose ekuivalent);<br>- Diagrama e qarkullimit te Informacionit ne sistemin e administrimit te Leximeve dhe Taksave me PDA;<br>- Draft rregullore per krijimin dhe mirembatjen e perdoruesve ne sistemin e administrimit te Leximeve dhe Taksave me PDA; | | | |
| **11** | Trajnim i vazhdueshem i perdoruesve te sistemeve | Klasa | 10 | **36 muaj** |

*Shenim:*

*(*): Numri i bankave, që do të bashkohen në këtë shërbim të përmirësuar është në varësi të vetë bankave apo vullnetit të tyre për t'ju bashkuar shërbimit. Numri maksimal i mundshëm është sa numri i bankave që do të operojnë në Shqipëri përgjatë kohes së zbatimit të kontratës; Gjatë lëvrimit të shërbimit, OE kërkohet që brenda 6 muajve të kryej të bëj lidhjen e suksesshme me njërën nga bankat; Në vijim (brenda shërbimit të mirëmbajtjes) operatori kërkohet të ofrojë Mbështetje teknike në procesin e lidhjes të cdo banke tjetër, që do të zbatojë këtë shërbim.*

*Plani i lidhjes per secilen nga Bankat, do te kryhet pergjate periudhes se mirembajtjes se sistemeve. Grupit te punes se UKT qe do te ndjek zbatimit te projektit, dhe koordinimin me Bankat per realizimin e lidhjeve. Plani i integrimeve, do te percaktohet nga UKT dhe OE do te njoftohet paraprakisht (per te lejuar pregatitjen e personelit te OE) te pakten dy jave para cdo fillim integrimi.*

*(**):Sherbimi i mirembajtjes se sistemit te faturimit fillon jo me vone se 15 dite nga nenshkrimi i kontrates, dhe eshte per nje periudhe 36 mujore (3 vite) (jo me vone se 15 dite nga nenshkrimi i kontrates).*

## 8. PRANIM I ISHËRBIMIT

Dokumentacioni që vërteton realizimin e shërbimit të përmirësimit si dhe të mirëmbajtjes (si: Raporte shërbimi, proces verbal shërbimi dhe faturimi) do të dorëzohet nga Ofruesi i shërbimit pranë UKT sipas periudhës dhe kohës që do të negociohet ndërmjet palëve, e cila do të jetë pjesë e kontratës. Ky proces verbal mbahet në tre kopje dhe nënshkruhet nga të tre anëtarët e saj.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

**Shtojca 6**

(*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit*)

**FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT**

**Shërbimi që kërkohet:**

**Afatet e ekzekutimit:**

| NR | EMËRTIMI | Njesia | SASIA | AFATI lëvrimit, nga nënshkrikimi |
|---|---|---|---|---|
| **1** | Përmirësimi dhe Përshtatja e Sistemit të Faturimit Al-Billing(ose ekuivalent) | Set | 1 | **4 muaj** |
| **2** | Përmirësimi dhe Implementim i Shërbimit të Pagesave (web service) me palët e treta. Lidhja me 1 nga Bankat (*). | Set | 1 | **6 muaj** |
| **3** | Permiresimi dhe Implementimi i Sistemit të administrimit te Leximeve dhe Taksave me PDA | Set | 1 | **6 muaj** |
| **4** | Oracle Database Enterprise Edition (Processor License, së bashku me shërbimin e Partitioning) ose ekuivalente, *përfshirë shërbimet që lidhen me zbatimin dhe migrimin, dhe* ***shërbimet e replikimit online me bazën e të dhënave Cloud***. | Procesore | 3 | **15 dite** |
| **5** | Sistemim i auditimit të bazave të të dhënave Oracle si Core Audit Application (Processor License) ose ekuivalente. | Procesore | 3 | **15 dite** |
| **6** | Server cloud së bashku me mbrotjen e të dhënave, për zbatimin e komponenteve online me bankat si dhe me klientet (vite) | Vite | 3 | **15 dite** |
| **7** | Bazë e të dhënave të hostura Oracle e integruar me bazën e të dhënave në on-premise (vite) | Vite | 3 | **15 dite** |
| **8** | Sistemi i hostuar i raportimit BI, me një numër minimal prej 10 përdoruesish (vite) | Vite | 3 | **15 dite** |
| **9** | Mirëmbajtje dhe garanci prodhuesi per Sistemit të Faturimit Al-Billing(ose ekuivalent), Reader, Taksa dhe WS të pagesave, **bazat e te dhenave enterprise edition**, **particionimit**, **core audit** për periudhë vjecare (vite) (**) | Vite | 3 | **15 dite** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **10** | Administrimi i Projektit si dhe levrimi i dokumentacioneve baze te sistemit :<br>- Draft rregullore per operimin e sistemit AL-Billing(ose ekuivalent);<br>- Draft rregullore per operimin e sistemit të administrimit te Leximeve dhe Taksave me PDA,<br>- Perditesimin e Manualin te perdorimit te sistemit, dhe perditesimin e tij, pas cdo nderhyrje permiresuese ne sistem. Vecanerisht lidhur me permiresimet e planifikuara ne kete projekt. Keto manual duhet te perfshine edhe komponentet e tjere te sistemit Al-Billing(ose ekuivalent), si Sistemit Raportimit BI, Shërbimit të Pagesave (web service) per shkembimin e te dhenave me Bankat, etj.;<br>- Diagrama e qarkullimit te Informacionit ne sistemin e Al-Billing(ose ekuivalent);<br>- Draft rregullore per krijimin dhe mirembatjen e perdoruesve ne sistemin AL-Billing(ose ekuivalent);<br>- Diagrama e qarkullimit te Informacionit ne sistemin e administrimit te Leximeve dhe Taksave me PDA;<br>- Draft rregullore per krijimin dhe mirembatjen e perdoruesve ne sistemin e administrimit te Leximeve dhe Taksave me PDA; | Muaj | 6 | **6 muaj** |
| **11** | Trajnim i vazhdueshem i perdoruesve te sistemeve | Klasa | 10 | **36 muaj** |

**Shtojca 7**

(*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)*

**FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS**

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

Detyrat:

Shpërndarja:

Vendi i kryerjes së shërbimeve:

**Shtojca 8**

[Shtojcë pr t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

## FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);

c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;

ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, oseqë ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;

d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;

dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;

gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomikt në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

**Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkm, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

***Shënim:*Në zbatim të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021"Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar me VKM-në nr.710, datë 24.11.2021 neni 26/6 me kërkesë të Autoritetit Kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë fizikisht pranë UKT sh.a dokumentacion provues të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të nenit 26/2 të VKM-së të sipërcituar , si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike[2]. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.**

***Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.***

***Në rast se operatorët ekonomikë të kualifikuar i pari janë bashkim operatorësh ekonomikë secili prej operatorëve ekonomikë duhet të dorëzojnë dokumentacionin e mësipërm, marrëveshjen e bashkëpunimit sipas së cilës janë krijuar bashkimi i operatorëve ekonomikë si dhe deklaratën për caktimin e përfaqësuesit të bashkimit të operatorëve ekonomikë.***

## 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. **Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

*b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3 përkatësisht në vlerën* 2.880.866,66 (dy milion e teteqind e tetedhjete mije e teteqind e gjashtedhjete e gjashte presje gjashtedhjete e gjashte ) leke pa TVSH.

Shuma e kerkuar e sigurimit te ofertes ne monedhen nderkombetare Euro sipas kursit te Bankes se Shqiperise eshte 29.017,59 (njezet e nente mije e shtatembedhjete presje pesedhjete e nente) euro pa TVSH.

**2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

**2.1Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të fondit limit.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

**2.2.2** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2021, 2022, 2023) të çertifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit.

**2.2.3.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2024 ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas ligjit nr.9632 datë 30.10.2006"Për sistemin e taksave vendore"i ndryshuar; **(lidhur me afatet e kryerjes se pagesave te caktuara nga njesite e veteqeverisjes vendore për vitin 2024),** në të cilën është regjistruar sipas QKB dhe vendimeve të Këshilleve Bashkiake të njësive vendore ku operatorët ushtrojnë aktivitetin.

(*Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime*.

**2.2.4.**Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2024 sipas ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**<u>Shënim</u>**: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar duhet te dorezojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të operatorëve ekonomikë të suksesshëm në marrëveshjen kuadër dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

**2.3Aftësitë teknike dhe profesionale:**

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate përkatësisht jo më e vogël se 57.617.333,32 (pesedhjete e shtate milion e gjashteqind e shtatembedhjete mije e treqind e tridhjete e tre presje tridhjete e dy) lekë pa tvsh.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

**a)** për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe te deklaruara ne orgamet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara,

**b)** për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

**Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim**

**2.4** Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Certifikuar sipas standardeve ISO te lëshuara nga organizmat e vlerësimit te konformitetit te cilat janë te akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues te njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht**:**

a) Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 **(ose ekuivalente)** (e vlefshme). *(*Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave që do të marre persiper sipas akt-marreveshjes*).*

b) Operatori Ekonomik duhet të disponoje Çertifikaten ISO 27001:2013 mbi "Sistemet menaxhimit te sigurise se informacionit ",e vlefshme **(ose ekuivalente)**. *(*Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave që do të marre persiper sipas akt-marreveshjes*).*

2.5. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin autorizimin e prodhuesit/distributorit të autorizuar për objektin e prokurimit ose kontratë bashkepunimi me prodhuesin e sistemeve (komponenteve te projektit si meposhte).

- Për sistemin Server Cloud
- Për sistemin e bazës së të dhënave
- Për sistemin e bazave të të dhënave të hostuara;
- Për sistemin e hostuar të raportimit BI;
- Për sistemin Core Audit Application të bazës së të dhënave;
- Për sistemin Al-Billing në përdorim nga UKT **(ose ekuivalente)**;
- Për sistemin e Leximeve me PDA të ofruar;

Autorizimi (ose Kontrata e Bashkepunimit) duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Ne autorizimin e prodhuesit duhet te percaktohet objekti i kesaj procedure dhe Nr references.

**2.6** Operatori ekonomik ofertues, duhet te kete certifikimet si me poshte:

- Infrastrukture Cloud;
- Sisteme audit te dhenash;
- Sisteme Faturimi Al-Billing **(ose ekuivalente)**;
- Sisteme administrimi te Leximeve me PDA

Për përmbushjen e ketij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin certifikimet e marra nga prodhuesit e programeve dhe teknologjive qe po ofertojne, ose certifikimet (ekuivalente), lëshuar nga autoritete të autorizuara/certifikuara për dhënien e tyre.

**2.7**. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar prej te pakten 3 (tre) muajt e fundit nga data e publikimit te njoftimit te kontrates, punonjes te diplomuar ne fusha si shkenca kompjuterike, teknologji informacioni, inxhinieri informatike ose ekuivalent me keto, qe do te angazhohen ne implementimin e projektit, duke pasur çertifikime te kombinuara sipas kerkesave te meposhtme:

a. Te pakten 2 (dy) punonjës, primar dhe backup, të certifikuar për programim ose implementim ne sistemin e faturimit AL-Billing ose ekuivalent;
b. Te pakten 2 (dy) punonjës, primar dhe backup, të certifikuar për programim ose implementim te sistemit te leximeve te ofruar;
c. Te pakten 1 (një) punonjës të certifikuar për sistemin infrastrukture cloud te ofertuar;
d. Te pakten 1 (një) punonjës të certifikuar për zgjidhjen BI te ofertuar;
e. Te pakten 1 (një) punonjës të certifikuar për administrator sisteme baze të dhënash relacionale Oracle ose ekuivalent;
f. Te pakten 2 (dy) punonjes te certifikuar për zhvillim në teknologji web;
g. Te pakten 1 (një) punonjes te certifikuar për zhvillim në android ose ekuivalent;
h. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar per arkitekture orientuar nga sherbimet SOACP ose ekuivalent;
i. Te pakten 2 (dy) punonjës të certifikuar për testues software;
j. Te pakten 1 (një) punonjës të certifikuar për menaxhim projektesh PMP ose ekuivalent;
k. Te pakten 1 (një) punonjës të certifikuar për ITIL ose ekuivalent per administrimin e sherbimeve IT;

l. Te pakten 1 (një) punonjës të certifikuar për administrim te sistemit te operimit per servera si Linux, Windows server ose ekuilvalent;
m. Te pakten 1 (nje) punonjes te certifikuar per te zhvilluar trajnime;

*Një punonjës mund të posedojë më shumë se një certifikim.*

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin për punonjësit e sipërcituar dokumentacionin e mëposhtëm:

a. Certifikatat përkatëse te personelit. Në rast se certifikatat janë në gjuhë të huaj (te ndryshme nga ato te percaktuara ne DT) operatori ekonomik duhet ti paraqesë të përkthyera sipas dispozitave ligjore në fuqi.

b. Listëpagesën e 3 muajve të fundit.

**Sqarim:** përmbushja e kësaj kërkese në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të **formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST,** sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Shënim**: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet te dorezojë pranë AK, ***përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit***, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit**.**

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin certifikimet e marra nga prodhuesit e programeve dhe teknologjive qe po ofertojne, ose certifikime ekuivalente lëshuar nga autoritete të autorizuara/certifikuara për dhënien e tyre nga prodhuesit e tyre ose te akredituara nga organizata akredituese.

2.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës, lidhur me produktet software te gatshem duhet të paraqesë Materiale teknike të prodhuesit (katalog teknik per produktet standarde te ofruara si database, partitioning, Audit Log, Sistem BI, Sistemi i leximeve, etj);

Gjithashtu App mobile i sistemit te leximeve duhet te jete i certifikuar nga te pakten nje prodhues pajisjesh mobile PDA. Ne certifikate te konfirmohet qe App mobile i zgjidhjes se ofruar eshte i pershtatshem per PDA e atij prodhuesi. Certifikata te jete leshuar brenda 3 viteve te fundit nga dita e shpalljes se kesaj procedure.

**Shënim:**

**1. OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, ku parashikohet se, "Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla", si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmues për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i**

**kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.".**

**Mosparaqitja e dokumentacionit provues, do të jetë kusht s'kualifikimi.**

**Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetedeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbën kusht s'kualifikimi.**

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

**Shtojca 9**

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

**FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

I. Unë i nënshkruari ______________ në cilësinë e ________________ të operatorit ekonomik _____________________ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

**A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik**

| **Identifikimi** | **Përgjigjja** |
|---|---|
| Emri i operatorit ekonomik:<br>(Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE | ------------------------------------------------- |
| Numri NIPT/et: | ---------------------------------------------------- |

| | |
|---|---|
| Adresa postare:<br>Qyteti / qyteti; Kodi postar | ----------------a-------------------------------------- |
| Përfaqësuesi (emri): | -------------------------------------------- |
| Telefoni: | ----------------------------------------------------- |
| E-mail: | ---------------------------------------------------------- |

**B: DEKLARATË**

**Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

| **Emri i nënkontraktorit të propozuar** | **NIPT –i** | **Përqindja e nënkontraktimit** | **Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar** |
|---|---|---|---|
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |

- **Informacione për nënkontraktorin**

- **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

| **Emri (at) e subjekteve** | **NIPT-i** | **Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik** | **Specifiko konkretisht kapacitetin/et** |
|---|---|---|---|
| | | | |
| | | | |
| | | | |

**Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit**

**A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT**

| **Deklarata** |
|---|
| Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.<br><br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* ____________________________________________________ |
| Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.<br><br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*_______________________________________ |
| Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:<br><br>___________________________________________<br><br>___________________________________________<br><br>etj.<br><br>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.<br><br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*____________________________________________________ |
| Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.<br><br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*__________________________________________________ |
| Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).<br><br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*_____________________________________________________ |
| Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.<br><br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*____________________________________________________ |
| Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.<br><br>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.<br><br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*_______________________________________________________ |
| Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.<br><br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* |
| Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike |

në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* ____________________________________________________

**B: DEKLARATA**

**Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura**

Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklarim dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

1. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;

2. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;

3. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;

4. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;

5. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:

   a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;
   b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.

6. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):

   a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër; ☐
   b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit). ☐

7. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6.a) dhe 6.b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:

   a) çmimet;
   b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
   c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
   d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

8. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).

9. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

**C: DEKLARATA**

**Mbi Konfliktin e Interesit**

| **Deklarata** |
|---|
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:<br><br>Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.<br><br>Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:<br><br>- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtori i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.<br><br>Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.<br><br>Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).<br><br>Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit**. |

| |
|---|
| Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimi dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".<br><br>Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu. |

**D: DEKLARATA**

**Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës**

| **Deklarata** |
|---|
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: |
| • Operatori ekonomik _________________________garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.<br><br>• Operatori ekonomik____________________lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.<br><br>• Operatori ekonomik ________________nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* ______________________________________________________ |

**Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit**

**A: DEKLARATË**

**Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:**

| **Deklarata** | **Përgjigje** |
|---|---|
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike dhe termat e referencës, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e shërbimeve dhe grafikun e ekzekutimit të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor. | Po [ ] Jo [ ] |

**B: DEKLARATË**

**Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)**

| **Deklarata** | **Përgjigje** |
|---|---|
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:<br><br>Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor. | <u>Punonjës</u><br><br>Po [ ] Jo [ ]<br><br>Nëse, po, numri i punonjësve:<br><br>Profili i punonjësve<br><br>___<br><br><u>Makineri e mjete</u><br><br>Po [ ] Jo [ ]<br><br>Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete: |
| **Emri, Mbiemri**___<br><br>**Firma** ___<br><br>**Vula**___<br><br>**Data e dorëzimit të deklaratës** ___ | |

**Ju lutemi sigurohuni që:**

- **Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.**
- **Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës**.
- **Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.**
- **Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.**

**Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.**

- ***Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.***

- ***Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.***

**Shtojca 10**

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

**Formulari i Njoftimit të Skualifikimit** [3]

[Vendndodhja dhe data]

[Emri dhe adresa e Autoritetit/entit Kontraktor]

[Adresa e Ofertuesit]

I nderuar, Z. / Znj. <Emri i kontaktit >

Ju falënderojmë për pjesëmarrjen tuaj në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit publik. Procedura u zhvillua në përputhje me Ligjin Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik".

Oferta juaj u vlerësua me kujdes në bazë të kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në Njoftimin e Kontratës dhe dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informojmë se jeni skualifikuar pasi oferta e paraqitur nga ju është refuzuar për arsyen (et) e mëposhtme:

______________________________________________________________________________

______________________________________________________________________________

______________________________________________________________________________

______________________________________________________________________________

Nëse mendoni se autoriteti/enti kontraktor ka shkelur LPP-në ose RPP-në gjatë procedurës së prokurimit publik, ju keni të drejtë të inicioni një procedurë rishikimi pas publikimit të njoftimit të fituesit sipas parashikimeve në Kapitullin XIV të Ligjit të Prokurimit Publik.

Megjithëse nuk mund t'i përdorim shërbimet tuaja në këtë rast, ne besojmë se do të mbeteni të interesuar për iniciativat tona të prokurimit.

Me respekt,

**Titullari i Autoritetit/Entit Kontraktor**

[3] *Ky njoftim do të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit të zhvilluara në rrugë shkresore*

**Shtojca 11**

[*Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor*]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT (PARAPRAK)**

*[Data]*

Drejtuar: *[Emri dhe adresa e Ofertuesit fitues]*

Procedura e prokurimit/lotit:

Numri i procedurës/referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës: *[Objekti, sasitë dhe kohëzgjatja e kontratës]*

Publikimet e mëparshme (*nëse është rasti*): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]*

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto □

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim □

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1.________________________________ ____________________________________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-t*

Vlera

__________________________________________________________________________________

*(e shprehur në shifra dhe fjalë)*

2.___________________________________ _____________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it*

Vlera

___________________________________________________________________________________

*(e shprehur në shifra dhe fjalë)*

Etj.___________________________________________________________________________________

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1.___________________________________ ___________________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it* *arsyet e mëposhtme*

2.___________________________________ ______________ ____________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it* *arsyet e mëposhtme*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [*emri dhe adresa e ofertuesit fitues*], se oferta e paraqitur me vlerë totale prej _____________ [*shuma përkatëse e shprehur me fjalë dhe shifra*] / totali i pikëve të marra [_____] është identifikuar si fitues (paraprak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik".

**Shtojca 12**

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

***(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIt)***

*[Data]*

Drejtuar: *[Emri dhe adresa e Ofertuesit fitues]*

Procedura e prokurimit/lotit

Numri i procedurës / referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës: *[Objekti,* S*asitë dhe kohëzgjatja e kontratës]* Publikimet e mëparshme (*nëse është rasti*): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]*

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto □

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim □

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

1.______________ _________________ ___________________________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-t* Vlera *(e shprehur në shifra dhe fjalë)*

2.____________________ _________ _____________________________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it* Vlera *(e shprehur në shifra dhe fjalë)*

Etj.____________________________________________________________________________

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1.________________________________ ________________ _____________

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it* *arsyet*

2.________________________________ _____________________ _________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-*it arsyet

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë *[emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]* se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej *[shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*/pikët totale të marra *[_____]*është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *[emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor dhe referenca e kontaktit]* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda ____________ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik".

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraprak)

PO ☐ JO☐

Nëse Po (*vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë*)___________________

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO ☐ JO☐

Nëse Po (*vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë*)___________________

**[TITULLARI I AUTORITETIT /ENTIT KONTRAKTOR]**

**Shtojca 13**

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/enti Kontraktor në rastin e Marrëveshjes Kuadër]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR (PARAPRAK)**

*[Data]*

Drejtuar: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të suksesshëm]

1.__________________________________________
*2.* __________________________________________
*3.*__________________________________________

* * *

Procedura e prokurimit:

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: [shuma, objekti, kohëzgjatja e kontratës, etj.]

Publikimet e mëparshme (nëse aplikohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto □
oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim □

Me anë të kësaj bëjmë me dije se, në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë të mëposhtëm me vlerat përkatëse si më poshtë:

1.__________________________________ ______________________________
*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it*

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme______________________________________________________________________
*(e shprehur në shifra dhe në fjalë)*

2.__________________________________ ______________________________
*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it*

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme) ______________________________
*e shprehur në shifra dhe në fjalë)*

Etj.____________________________

Janë skualifikuar Operatorët ekonomikë e mëposhtëm:

1.__________________________________ ______________

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it* *arsyet*

2.___________________________________                    __________________    ________________

*Emri i plotë i shoqërisë*                                                    *Numri i NIPT-it*          *arsyet*

* * *

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, ju informojmë se operatorët ekonomikë të mëposhtëm janë identifikuar si fitues (paraprak) të procedurës së prokurimit:

1.___________________________________                    _______________________________

*Emri i plotë i shoqërisë*                                                    *Numri i NIPT-it*

Vlera / Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme)

_______________________________

*(e shprehur në shifra dhe në fjalë)*

Totali i pikëve të marra ________________

2.__________________________________                    _______________________________

*Emri i plotë i shoqërisë*                                                    *Numri i NIPT-it*

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme)          _______________________________

*(e shprehur në shifra dhe në fjalë*

Totali i pikëve të marra ________________

Etj.________________________________

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit, sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik".

**Shtojca 14**

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/enti Kontraktor në rastin e Marrëveshjes Kuadër*]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR**

**(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT[4])**

*[Data]*

Drejtuar: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të suksesshëm]

1.________________________________________
*2.* ________________________________________
*3.*________________________________________

* * *

Procedura e prokurimit:

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: [shuma, objekti, kohëzgjatja e kontratës, etj.]

Publikimet e mëparshme (nëse aplikohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto □
oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim □

Me anë të kësaj bëjmë me dije se, në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë të mëposhtëm me vlerat përkatëse si më poshtë:

1._________________________________ ______________________________
*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it*

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme____________________________________________________________________
*(e shprehur në shifra dhe në fjalë)*

2._________________________________ ______________________________
*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it*

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme) ____________________________
*e shprehur në shifra dhe në fjalë)*

Etj.____________________________

[4] Ky Formulari është i aplikueshëm nëse ka ankime

Janë skualifikuar Operatorët ekonomikë e mëposhtëm:

1.__________________________________ ______________

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it* *arsyet*

2.__________________________________ _________________ _______________

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it* *arsyet*

* * *

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, ju informojmë se operatorët ekonomikë të mëposhtëm janë identifikuar si fitues (paraprak) të procedurës së prokurimit:

1.__________________________________ ______________________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it*

Vlera / Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme) ______________________________

*(e shprehur në shifra dhe në fjalë)*

Totali i pikëve të marra _______________

2.__________________________________ ______________________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *Numri i NIPT-it*

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme) ______________________________

*(e shprehur në shifra dhe në fjalë*

Totali i pikëve të marra _______________

Etj.______________________________

**[TITULLARI I AUTORITETIT /ENTIT KONTRAKTOR]**

## Seksioni III Termat dhe Kushtet e Kontratës (TKK)

Ky Seksion përmban :

Shtojca 15: Kushtet e Përgjithshme të Kontratës

Shtojca 16: Kushtet e Vecanta të Kontratës

Shtojca 17: Formulari i Sigurimit të Kontratës

Shtojca 18: Draftmarrëveshje kuadër ku përcaktohen të gjitha kushtet

Shtojca 19: Draftmarrëveshje kuadër ku nuk përcaktohen të gjitha kushtet

**Shtojca 15**

# Kushtet e Përgjithshme të Kontratës (KPK)

Këto Kushte të Përgjithshme të Kontratës (KPK), së bashku me Kushtet e Veçanta dhe dokumentet e tjera të renditura në to, përbëjnë një dokument të plotë që shpreh të drejtat dhe detyrimet e palëve.

**Neni 1 Dispozitat e përgjithshme**

**1.1 Përkufizimet**

Në Kushtet e Kontratës ("këto Kushte"), të cilat përfshijnë Kushtet e Veçanta dhe këto Kushte të Përgjithshme, fjalët dhe shprehjet e mëposhtme kanë këto kuptime:

**1.1.1 Kontrata**

**1.1.1.1** "Kontrata" do të thotë kontrata me shpërblim, e lidhur me shkrim, ndërmjet një apo më shumë operatorëve ekonomikë dhe një ose më shumë autoriteteve ose enteve kontraktore, që kanë si objekt kryerjen e punimeve, furnizimin e mallrave dhe shërbimeve, në përputhje me LPP.

**1.1.1.2** "Dokumentet e Kontratës" do të thotë dokumentet e renditura në Kontratë, përfshirë çdo ndryshim të saj.

**1.1.1.3** "Çmimi i Kontratës" do të thotë çmimi që i paguhet Furnizuesit siç specifikohet në kontratë.

**1.1.1.4** "Përfundimi" do të thotë përmbushja e të gjitha detyrimeve, me ose pa penalitet, nga Furnizuesi në përputhje me termat dhe kushtet e përcaktuara në Kontratë.

**1.1.1.5** "Ndërprerje e Kontratës" do të thotë mosvijimi i ekzekutimit të Kontratës sipas përcaktimeve në Nenin 23.

**1.1.1.6** "Specifikime teknike" do të thotë karakteristikat e Shërbimeve objekt kontrate dhe çdo shtesë dhe modifikim i këtyre karakteristikave në përputhje me Kontratën.

**1.1.1.7** "Termat e Referencës" shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojnë detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve që do të sigurohen.

**1.1.1.8** "Listat" do të thotë dokumenti (et) me titull Listat të plotësuara nga Furnizuesi dhe të dorëzuara me ofertën, siç janë të përfshira në Kontratë . Dokumente të tilla mund të përfshijnë Listat e Çmimeve të dhëna, Listat e tarifave dhe / ose çmimeve.

**1.1.1.9** "Ofertë" do të thotë oferta ekonomike dhe të gjitha dokumentet e tjera që Furnizuesi ka dorëzuar me ofertën ekonomike, siç janë përfshirë në Kontratë.

**1.1.1.10** "KPK" do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

**1.1.1.11** "KVK" do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

**1.1.2 Palët e Kontratës**

**1.1.2.1** “Palë" do të thotë nënshkruesit e kontratës, në cilësinë e Blerësit dhe Furnizuesit sipas kontekstit.

**1.1.2.2** “Blerës” do të thotë Autoriteti/Enti Kontraktor përfituesi i Shërbimeve objekt kontrate.

**1.1.2.3** "Furnizues" do të thotë operatori (ët) ekonomik që kryen furnizimine Shërbimeve objekt kontrate.

**1.1.2.4** "Nënkontraktor" do të thotë çdo subjekt i caktuar si nënkontraktor për kryerjen e një pjese të Shërbimeve.

**1.1.3 Llogaritja e afateve**

**1.1.3.1** "Ditë" do të thotë një ditë kalendarike.

**1.1.4 Shërbimet**

**1.1.4.1** "Shërbime" do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Furnizuesi sipas Kontratës.

**1.1.5 Përkufizime të tjera**

**1.1.5.1** "Adresa e Blerësit" është adresa e specifikuar në KVK.

**1.1.5.2** "Forca Madhore" është përcaktuar në Nenin 20 “Forca Madhore”.

**1.1.5.3** "Sigurimi i Kontratës" është sipas përcaktimeve të Nenit 11 “Sigurimi i Kontratës”.

**1.1.5.4** “Vendi i kryerjes së Shërbimeve", do të thotë vendi i përcaktuar në KVK.

**1.1.5.5** “E paparashikueshme" ose "E paparashikuar" do të thotë një ngjarje objektivisht e pamundur të parashikohet në momentin e publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE.

**1.1.5.6** Modifikimi i kontratës" është sipas përcaktimeve në Nenin 21.

**1.1.5.7** “Legjislacioni në fushën e prokurimit" do të thotë LPP-ja, Rregullat e Prokurimit Publik dhe akte të tjera nënligjore në bazë dhe për zbatim të LPP –së siç specifikohet në KVK.

**1.1.5.8** "Praktikat e Ndaluara" kanë kuptimin e përcaktuar në LPP.

**1.2 Interpretimi**

**1.2.1** Interpretimi i Kontratës, përveç kur konteksti kërkon ndryshe:

(a) fjalët që tregojnë një gjini përfshijnë të gjitha gjinitë;

(b) fjalët që tregojnë njëjësin përfshijnë edhe shumësin dhe fjalët që tregojnë shumësin përfshijnë edhe njëjësin;

(c) dispozitat që përfshijnë fjalën "bie dakord", "rënë dakord” ose "marrëveshje" kërkojnë që marrëveshja të dokumentohet me shkrim;

(d) "i shkruar" ose "me shkrim" do të thotë i shkruar me dorë, i shkruar me makinë, printuar ose i bërë në mënyrë elektronike.

**1.2.2 Modifikimi**

Çdo modifikim i Kontratës i cili nuk kryhet me shkrim, dhe nuk përmban datën, apo nuk i referohet shprehimisht Kontratës dhe nuk nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar rregullisht i secilës Palë është i pavlefshëm. Palët nuk mund të bëjnë modifikime të asnjë elementi të kontratës që do të

sillnin ndryshime thelbësore në kushtet mbi bazën e të cilave është përzgjedhur Furnizuesi.

**1.2.3 Heqja dorë**

Çdo heqje dorë nga të drejtat, kompetencat ose mjetet ligjore të një Pale sipas Kontratës duhet të bëhet me shkrim, me datë dhe e nënshkruar nga një përfaqësues i autorizuar i Palës që bën këtë dorëheqje, dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën nga e cila po hiqet dorë.

**1.2.4 Ndikimi i pavarur i dispozitave të kontratës**

Nëse ndonjë dispozitë ose kusht i Kontratës është i ndaluar ose bëhet i pavlefshëm ose i pazbatueshëm, një ndalim, pavlefshmëri apo pazbatueshmëri e tillë nuk ndikon në vlefshmërinë ose zbatueshmërinë e ndonjë dispozite dhe kushti tjetër të Kontratës.

**1.3 Komunikimet**

Kurdo këto Kushte parashikojnë dhënien ose lëshimin e miratimeve, certifikatave, pëlqimeve, përcaktimeve, njoftimeve, kërkesave dhe shlyerjeve këto komunikime do të jenë:

(a) me shkrim dhe të dorëzuara dorazi (kundrejt marrjes), dërguar me postë ose korrier, ose transmetuar duke përdorur ndonjë nga sistemet e rëna dakord të transmetimit elektronik siç përshkruhet në KVK;

Dhe

(b) dorëzuar, dërguar ose transmetuar në adresën për komunikimet e marrësit siç përshkruhet në KVK. Sidoqoftë:

(i) nëse marrësi njofton një adresë tjetër, komunikimet do të dorëzohen në përputhje me rrethanat; dhe

(ii) nëse marrësi nuk ka deklaruar ndryshe kur kërkon një miratim ose pëlqim, mund të dërgohet në adresën nga e cila është lëshuar kërkesa.

Miratimet, pëlqimet dhe përcaktimet nuk do të mbahen ose vonohen pa arsye.

**1.4 Ligji dhe gjuha**

Kontrata do të rregullohet dhe interpretohet sipas legjislacionit Shqiptar në fuqi.

Gjuha e Kontratës do të jetë ajo e deklaruar në KVK.

Gjuha për komunikime do të jetë ajo e deklaruar në KVK. Nëse aty nuk përcaktohet asnjë gjuhë, gjuha për komunikime do të jetë gjuha e përcaktuar e Kontratës.

Dokumentet mbështetëse dhe literatura e shtypur që janë pjesë e Kontratës mund të jenë në një gjuhë tjetër me kusht që ato të shoqërohen nga një përkthim zyrtar i fragmenteve përkatëse dhe, për qëllime të interpretimit të Kontratës, ky përkthim do të mbizotërojë.

Furnizuesi do të përballojë të gjitha kostot e përkthimit dhe të gjitha risqet e saktësisë së një përkthimi të tillë, për dokumentet e siguruara nga Furnizuesi.

**1.5 Prioriteti i Dokumenteve**

Dokumentet që formojnë Kontratën duhet të konsiderohen reciprokisht shpjeguese të njëri-tjetrit. Nëse në dokumente gjendet një paqartësi ose mospërputhje, Blerësi lëshon çdo sqarim ose udhëzim të nevojshëm.

**1.6 Hartimi i Kontratës**

**1.6.1** Njoftimi i ofertës fituese në përfundim të afateve të ankimit do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të parashikuar në Dokumentat e Tenderit.

**1.6.2** Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës.

**1.7 E drejta e autorit**

**1.7.1** Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, e drejta e autorit në të gjitha dokumentet dhe materialet e tjera që përmbajnë të dhëna dhe informacione të dhëna Blerësit nga Furnizuesi këtu do t'i mbeten Blerësit, edhe nëse ato i janë furnizuar Blerësit drejtpërdrejt ose përmes Furnizuesit nga ndonjë pale të tretë, përfshirë furnizuesit e materialeve.

**1.8 Detaje Konfidenciale**

Furnizuesi dhe personeli i Blerësit do të zbulojnë çdo informacion të tillë konfidencial dhe informacione të tjera që mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme për të verifikuar pajtueshmërinë e Furnizuesit me Kontratën dhe për të lejuar zbatimin e duhur të saj.

Secili prej tyre do t'i trajtojë të dhënat e kontratës në mënyrë konfidenciale, deri në masën e nevojshme për të kryer detyrimet e tyre përkatëse sipas Kontratës ose për të qenë në përputhje me ligjet në fuqi. Asnjë prej tyre nuk do të publikojë ose zbulojë të dhëna të veçanta të Shërbimeve të përgatitura nga Pala tjetër pa marrëveshjen paraprake të Palës tjetër. Sidoqoftë, Furnizuesit lejohen të zbulojnë çdo informacion publikisht të disponueshëm, ose informacion që kërkohet për të provuar kualifikimet e tij për të konkurruar në procedura të tjera.

Pavarësisht nga sa më sipër, Furnizuesi mund t'i sigurojë Nënkontraktorit (eve) të tij dokumente, të dhëna dhe informacione të tjera që merr nga Blerësi në masën e kërkuar që Nënkontraktori (ët) të kryejë punën e tij sipas Kontratës. Në rast të tillë, Furnizuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me Nënkontraktorin/ët një dispozitë që parashikon ruajtjen e konfidencialitetit sikurse parashikohet në adresë të Furnizuesit sipas këtij neni.

**1.9 Pajtueshmëria me ligjet**

Gjatë realizimit të Kontratës Furnizuesi respekton ligjet në fuqi.

Nëse nuk përcaktohet ndryshe në Kushtet e Veçanta:

(a) Blerësi siguron dhe paguan të gjitha lejet, miratimet dhe / ose licencat nga të gjitha autoritetet lokale, shtetërore ose kombëtare ose ndërmarrjet e shërbimeve publike në vendin e Blerësit që (i) autoritete ose ndërmarrje të tilla i kërkojnë Blerësit të sigurojë në emër të tij dhe (ii) janë të domosdoshëm për ekzekutimin e Kontratës, përfshirë ato që kërkohen për përmbushjen e detyrimeve përkatëse si nga Furnizuesi ashtu dhe Blerësi sipas Kontratës;

(b) Furnizuesi siguron dhe paguan të gjitha lejet, miratimet dhe / ose licencat nga të gjitha autoritetet lokale, shtetërore ose kombëtare ose ndërmarrjet e shërbimeve publike në vendin e Blerësit që autoritete ose ndërmarrje të tilla i kërkojnë Furnizuesit të sigurojë në emër të tij dhe që janë të nevojshme për kryerjen e Kontratës, duke përfshirë, pa u kufizuar, vizat për personelin e Furnizuesit dhe Nënkontraktorit dhe lejet e hyrjes për të gjitha pajisjet e importuara të Furnizuesit. Furnizuesi siguron të gjitha lejet, miratimet dhe / ose licencat e tjera që nuk janë përgjegjësi e Blerësit sipas pikës (a) te ketij neni këtu dhe që janë të nevojshme për ekzekutimin e Kontratës. Furnizuesi do të dëmshpërblejë dhe zhdëmtojë Blerësin nga dhe kundër çdo dhe të gjitha detyrimeve, dëmeve, pretendimeve, gjobave, penaliteteve dhe shpenzimeve të çfarëdo natyre që lindin ose rezultojnë nga shkelja e ligjeve të tilla nga Furnizuesi ose personeli i tij, duke përfshirë Nënkontraktorët dhe personelin e tyre, por pa cënuar Nenin 9.1.

**1.10 Përgjegjësia e përbashkët dhe solidare**

Nëse Furnizuesi është një bashkim i Operatorëve Ekonomikë, të gjithë këta Operatorë Ekonomikë do të jenë bashkërisht dhe solidarisht përgjegjës ndaj Blerësit për përmbushjen e dispozitave të

Kontratës.

**1.11 Inspektimet dhe Auditimi nga Blerësi**

Furnizuesi i përgjigjet pyetjeve dhe i jep Blerësit çdo informacion ose dokument të nevojshëm për (i) hetimin e pretendimeve të Praktikave të Ndaluara, ose (ii) ) monitorimin dhe vlerësimin nga ana e Blerësit të Kontratës dhe për t'i dhënë mundësi Blerësit të shqyrtojë dhe adresojë çdo problematikë në lidhje me Kontratën.

Furnizuesi mban të gjithë dokumentacionin në lidhje me zbatimin e Kontratës në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Neni 2 Praktikat e Ndaluara**

**2.1** Furnizuesi nuk do të autorizojë ose lejojë asnjë nga punonjësit ose përfaqësuesit e tij, të angazhohen në Praktika të Ndaluara në lidhje me prokurimin, dhënien ose ekzekutimin e Kontratës.

**2.2** Nëse Blerësi konstaton se dhënia e kontratës është bërë në kushtet e konfiktit të interesit dhe ky fakt nuk ka qenë i mundur të identifikohej më parë, i kërkon Komisionit të Prokurimit Publik të deklarojë kontratën absolutisht të pavlefshme.

Nëse Blerësi gjatë zbatimit të kontratës ka informacion për veprime korruptive informon organet kompetente.

**Neni 3 Njoftimet**

**3.1** Çdo njoftim i dhënë nga njëra Palë tek tjetra, në përputhje me Kontratën, do të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në KVK.

**3.2** Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

**Neni 4 Objekti i Furnizimit**

**4.1** Shërbimet që do të furnizohen duhet të jenë sipas termave të referencës dhe kushteve të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit.

**4.2** Kushtet e kontratës nuk ndryshojnë nga ato të përshkruara në dokumentet e tenderit dhe në ofertën fituese, me përjashtim të rasteve kur Furnizuesi, për arsye objektive dhe të pavarura prej tij në kohën e ofertimit ofron, me të njëjtin çmim, kushte më të mira se ato të tenderuara.

**Neni 5 Dorëzimi**

**5.1** Dorëzimi i Shërbimeve do të jetë në përputhje me kërkesat e specifikuara në Dokumentet e Tenderit.

**Neni 6 Përgjegjësitë e Furnizuesit**

**6.1** Furnizuesi do të jetë përgjegjës për kryerjen e e të gjitha Shërbimeve në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Dokumentet e Tenderit.

**Neni 7 Detyrimet e Përgjithshme të Furnizuesit**

7.1 Furnizuesi duhet t’i kryejë Shërbimet dhe përmbushë detyrimet e tij me të gjitha përpjekjet, eficiente dhe ekonomike në pajtim me teknikat dhe praktikat profesionale të pranuara në përgjithësi.

7.2 Furnizuesi duhet të ndjekë praktika të shëndosha të biznesit dhe të përdorë teknologji të avancuar dhe të përshtatshme si dhe metoda të sigurta.

7.3 Nëse kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Furnizuesi duhet të veprojë gjithmonë si një këshillues besnik i Blerësit, në pajtim me rregullat dhe kodin e sjelljes të profesionit të tij dhe duhet që të mbështesë dhe ruajë gjithmonë interesin publik.

7.4 Nëse kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Furnizuesi duhet të ushtrojë kujdes të plotë në marrëdhëniet me palët e treta duke përfshirë median dhe nuk duhet të marrë pjesë në veprime që janë jashtë kompetencës së tij në përfaqësimin e Blerësit.

**Neni 8 Detyrimet e Veçanta të Furnizuesit**

**8.18.2** Furnizuesi duhet të kryejë të gjitha Shërbimet siç specifikohet tek Termat e Referencës.

**8.3** Furnizuesi duhet t’i paraqesë Blerësit të gjitha shërbimet, në sasitë e përcaktuara, siç kërkohen nga kontrata duke përfshirë, por jo të kufizuara nga, të gjitha raportet, dokumentat, studimet, skicimet dhe planimetritë.

Furnizuesi duhet të sigurojë raportet e lidhura me zbatimin e Shërbimeve siç kërkohet në kontratë.

**Neni 9 Çmimi i Kontratës**

**9.1** Çmimi i kontratës do të jetë i pandryshueshëm përgjatë kohëzgjatjes së realizimit të Kontratës, përveç rasteve të parashikuara në Nenin 19.

**Neni 10 Kushtet e Pagesës**

**10.1** Çmimi i Kontratës do të paguhet siç specifikohet në KVK.

Furnizuesi duhet të paguhet nga Blerësi për Shërbimet e kryera, në përmbushjen e të gjitha detyrimeve të parashikuara në Kontratë.

**10.2** Pagesat do të kryhen menjëherë nga Blerësi, jo më vonë se periudha kohore e specifikuar në KVK pas dorëzimit të një fature ose kërkese për pagesë nga Furnizuesi, dhe pasi Blerësi ta ketë pranuar atë.

**10.3** Nëse nuk përcaktohet ndryshe në KVK, pagesa duhet bërë në monedhë Shqiptare. Kursi i këmbimit të monedhave të ndryshme do të jetë kursi i Bankës së Shqipërisë i fiksuar në ditën e dërgimit për publikim të njoftimit të kontratës.

**10.4** Në rast të verifikimit të vonesave në kryerjen e pagesave nga ana e Blerësit, megjithëse Furnizuesi ka përmbushur të gjitha detyrimet e tij në përputhje me kushtet e kontratës, detyrimet e prapambetura dhe kamatëvonesat përkatëse do të kryhen në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”.

**Neni 11 Sigurimi i Kontratës**

**11.1** Furnizuesi, brenda afatit të caktuar nga Blerësi në njoftimin e fituesit, paraqet Sigurimin e Kontratës në shumën e specifikuar në KVK.

**11.2** Në përputhje me Nenin 11.1, Sigurimi i Kontratës do të shprehet në monedhën e Kontratës dhe do të jetë në formën e përcaktuar nga Blerësi në KVK.

**11.3** Shuma nga Sigurimi i Kontratës do t'i paguhet Blerësit si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga mospërmbushja e detyrimeve sipas Kontratës nga ana e Furnizuesit.

**11.4** Sigurimi i Kontratës do t'i kthehet Furnizuesit jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas datës së përmbushjes së detyrimeve së Furnizuesit sipas Kontratës, përfshirë çdo detyrim garancie, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe në KVK.

**Neni 12 Nënkontraktimi**

**12.1** Nënkontraktimi nuk duhet të bëhet pa aprovimin paraprak me shkrim të Blerësit dhe jo më shumë se 50% të vlerës së kontratës.

**12.2** Blerësi lejohet të bëjë pagesa drejtpërsëdrejti tek nënkontraktori për shërbimet që do të kryejë, me miratimin paraprak me shkrim të Furnizuesit.

**12.3** Parashikimet e Nenit 2 zbatohen edhe për nënkontraktimin.

**Neni 13 Specifikime dhe Skicime**

**13.1** Nëse kontrata kërkon shërbime skicimi, Furnizuesi duhet të përgatisë të gjitha specifikimet dhe skicimet duke përdorur sisteme të pranuara dhe të njohura në përgjithësi të pranueshme për Blerësin dhe të marrë parasysh standartet më të fundit.

**13.2** Nëse kontrata kërkon shërbime skicimi, Furnizuesi duhet të sigurojë se të gjitha specifikimet, skicimet dhe kërkesat e tjera janë përgatitur në bazë asnjanëse përsa i përket nxitjes së konkurrencës në prokurimin e objekteve të skicimit.

**Neni 14 Siguracioni i Përgjegjësisë Profesionale**

**14.1** Furnizuesi duhet të mbajë siguracion për përgjegjësi profesionale sipas rregullave dhe praktikave të njohura në përgjithësi për profesionin për ta zhdëmtuar Blerësin për dëme të rezultuara nga neglizhenca, gabimet ose mangësitë, në kryerjen e Shërbimeve.

**14.2** Nëse nuk është përcaktuar në kontratë shuma minimale e siguracionit, Furnizuesi duhet të sigurojë siguracion në shumën e njohur në përgjithësi si të mjaftueshme nën rrethanat e Shrbimeve që po sigurohen.

**Neni 15 Dëmet e likujduara**

**15.1** Dëmet e likujduara për kryerjen e vonuar të shërbimeve do të llogariten me tarifat e mëposhtme ditore:

a) Për kontratat me periudhë zbatimi, jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 e vlerës përkatëse të mbetur, nga çmimi i përgjithshëm i Kontratës, por jo më pak se 25% e vlerës së Kontratës.

b) Për kontratat me periudhë zbatimi, jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 e vlerës përkatëse të mbetur, nga çmimi i përgjithshëm i Kontratës, por jo më pak se 25% e vlerës së kontratës.

c) Për kontratat me periudhë zbatimi më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 1/1000 e vlerës përkatëse të mbetur, nga çmimi i përgjithshëm i Kontratës, por jo më pak se 25% e vlerës së kontratës.

**Neni 16 Heqja dhe Zëvendësimi i Personelit Kryesor**

**16.1** Furnizuesi duhet të sigurojë aprovim paraprak me shkrim nga Blerësi përpara heqjes ose zëvendësimit të personelit kryesor siç përshkruhet në ofertën e Furnizuesit.

**16.2** Furnizuesi do të zëvendësojë çdo punonjës nëse Blerësi zbulon se personi ka kryer veprime të jashtëligjshme ose Blerësi është mjaft i pakënaqur nga puna e personit.

**16.3** Nëse bëhet e nevojshme të zëvendësohet ndonjë nga personeli kryesor, Furnizuesi duhet të sigurojë si zëvendësues një person me kualifikime ekuivalente ose më të mira.

**16.4** Furnizuesi do të paguajë kosto shtesë për zëvendësimin e personelit kryesor me përjashtim kur shkaku i zëvendësimit ka ardhur nga neglizhenca ose mungesa e kujdesit të Blerësit.

**Neni 17 Zhdëmtimi i Patentës**

**17.1** Furnizuesi dëmshpërblen dhe zhdëmton Blerësin dhe zyrtarët e tij nga dhe kundër padive, veprimeve ose procedurave administrative, pretendimeve, kërkesave, humbjeve, dëmeve, kostove dhe shpenzime të çdo natyre, përfshirë tarifat e avokatit dhe shpenzimet, të cilat Blerësi mund të pësojë si rezultat i çdo shkelje ose shkelje të pretenduar të ndonjë patente, modeli, skice të regjistruar, marke tregtare, të drejte autori ose një të drejte tjetër të pronësisë intelektuale të regjistruar ose që përndryshe ekzistonte në datën e kontratës për shkak të:

(a) ofrimit të shërbimeve nga Furnizuesi ose përdorimit të shërbimeve në vendin e dorëzimit të Shërbimeve;

dhe

(b) shitjen në çdo vend të produkteve të prodhuara nga Shërbimet.

Një zhdëmtim i tillë nuk aplikohet nëse Shërbimet ose ndonjë pjesë e tyre përdoren përtej kushteve të kontratës ose përdorimi i tyre ose i një pjese të tyre bëhet në kombinim me ndonjë pajisje, impiant ose material tjetër që nuk është furnizuar nga Furnizuesi, në përputhje me Kontratën.

**17.2** Nëse është nisur ndonjë procedurë apo ngritur ndonjë kërkesë kundër Blerësit që del nga çështjet e përmendura në Nenin 15.1, Blerësi do të njoftojë menjëherë Furnizuesin, dhe Furnizuesi mundet me shpenzimet e tij dhe në emër të Blerësit të ndërmarrë të gjitha veprimet për zgjidhjen e ndonjë procedure apo pretendimi të tillë.

**17.3** Nëse Furnizuesi nuk e njofton Blerësin brenda tridhjetë (30) ditëve pas marrjes së një njoftimi të tillë, atëherë Blerësi do të jetë i lirë të kryejë të njëjtën gjë në emër dhe për llogari të tij.

Blerësi, me kërkesën e Furnizuesit, do ti japë Furnizuesit të gjithë ndihmën në dispozicion në kryerjen e procedurave të tilla dhe do të rimbursohet nga Furnizuesi për të gjitha shpenzimet e arsyeshme të kryera në këtë mënyrë.

Blerësi dëmshpërblen dhe zhdëmton Furnizuesin dhe punonjësit, dhe nënkontraktorët e tij nga

dhe kundër çdo padie, veprimi apo procedure administrative, që Furnizuesi mund të pësojë si rezultat i çdo shkelje ose shkelje të pretenduar të ndonjë patente, modeli, skice të regjistruar, marke tregtare, të drejte autori ose një të drejte tjetër të pronësisë intelektuale të regjistruar ose që ekzistonte në datën e kontratës që lind nga ose në lidhje me çdo skicim, të dhënë, vizatim, specifikim apo dokument apo materiale të tjera të ofruara apo skicuara nga ose në emër të Blerësit.

**Neni 18 Kufizimi i Përgjegjësisë**

**18.1** Me përjashtim të rasteve të neglizhencës së rëndë ose shkelje me dashje:

(a) Furnizuesi nuk do të jetë përgjegjës ndaj Blerësit, për ndonjë humbje apo dëm indirekt ose që ka si pasojë, humbje të përdorimit, humbje të prodhimit, ose humbje të fitimeve ose kostove të interesit, me kusht që ky përjashtim të mos zbatohet për asnjë detyrim të Furnizuesit për t'i paguar Blerësit dëmet e likujduara; dhe

(b) përgjegjësia e përgjithshme e Furnizuesit ndaj Blerësit, nuk duhet të kalojë Çmimin e Kontratës, me përjashtim të rasteve për koston e dëmeve të rezultuara nga gabimet ose mangësitë në kryerjen e shërbimeve, ose çdo detyrim të Furnizuesit për të zhdëmtuar Blerësin në lidhje me shkeljen e patentës.

**Neni 19 Ndryshime në aktet ligjore dhe nënligjorë**

**19.1** Nëse pas datës së dorëzimit të ofertave ose datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj ose akt nënligjor në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa Furnizuesi është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

**Neni 20 Forca madhore**

**20.1** Mos kryerja apo kryerja me vonesë nga ana e një Pale të ndonjë prej detyrimeve të saj sipas kësaj Kontrate nuk do të konsiderohet shkelje e kësaj Kontrate nëse një mospërmbushje apo vonesë e tillë vjen drejtpërdrejt për shkak të ndonjë ngjarje të Forcës Madhore.

**20.2** Për qëllime të këtij neni, "Ngjarja e Forcës Madhore" do të thotë një ngjarje ose situatë përtej kontrollit të një Pale që nuk është e parashikueshme, është e pashmangshme dhe nuk shkaktohet nga neglizhenca ose mungesa e kujdesit nga njëra Palë. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk kufizohen në, veprime të një Pale qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, luftërat ose revolucionet, zjarret, përmbytjet, epidemitë/pandemitë, kufizimet e karantinës dhe embargo e mallrave.

**20.3** Nëse ndodh një Ngjarje e Forcës Madhore, Pala e prekur do të njoftojë menjëherë Palën tjetër me shkrim për gjendjen e tillë dhe shkakun e saj. Në qoftë se nuk udhëzohet ndryshe nga Pala tjetër me shkrim, Pala e prekur do të vazhdojë të kryejë detyrimet e saj sipas Kontratës për aq sa është e arsyeshme e praktikueshme dhe do të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për realizimin që nuk pengohen nga Ngjarja e Forcës Madhore

**Neni 21 Modifikimi i Kontratës**

**21.1** Palët mund të modifikojnë kontratën gjatë afatit të saj, vetëm nëse ndodhen në ndonjë nga rastet e parashikuara në LPP.

**21.2** Kur modifikimi shoqërohet me rritje të vlerës së Kontratës, vlera totale e modifikimeve nuk duhet

të tejkalojë 20% të vlerës së kontratës fillestare. Kur kryhen disa modifikime të njëpasnjëshme, ky kufizim duhet të aplikohet për vlerën e përgjithshme të të gjitha modifikimeve. Kur kontrata përmban një klauzolë të rishikimit të çmimit, baza për përllogaritjen e vlerës maksimale të lejuar për modifikimet do të jetë vlera e kontratës me çmimin e përditësuar.

**21.3** Asnjë modifikim i Kontratës nuk do të bëhet pa miratimin paraprak të Blerësit, shoqëruar me një marrëveshje me shkrim dhe të nënshkruar nga një përfaqësues i autorizuar i Furnizuesit dhe Blerësit.

**Neni 22 Zgjatja e afatit**

**22.1** Nëse në çdo kohë gjatë ekzekutimit të Kontratës, Furnizuesi ose nënkontraktorët e tij hasin kushte që pengojnë kryerjen në kohë të Shërbimeve në përputhje me Nenin 5, Furnizuesi njofton menjëherë Blerësin me shkrim për vonesën, kohëzgjatjen e mundshme dhe shkakun e saj. Sa më shpejt që të jetë e mundur pas marrjes së njoftimit të Furnizuesit, Blerësi vlerëson situatën dhe në bazë të diskrecionit të tij mund të zgjasë kohën e realizimit nga ana e Furnizuesit. Në këtë rast zgjatja miratohet nga Palët dhe reflektohet në modifikimin e Kontratës.

**22.2** Me përjashtim të rastit të Forcës Madhore, siç parashikohet në Nenin 20, një vonesë nga Furnizuesi në kryerjen e detyrimeve të Dorëzimit dhe Përfundimit do ta bëjë Furnizuesin përgjegjës për pagesën e dëmeve të likujduara në përputhje me parashikimet në kontratë.

**Neni 23 Ndërprerja e Kontratës**

**23.1 Njoftim për të korrigjuar**

Nëse Furnizuesi nuk përmbush ndonjë detyrim sipas Kontratës, Blerësi mund ti kërkojë me Njoftim që Furnizuesi të ndreqë mospërmbushjen brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve.

**23.2 Ndërprerja për mospërmbushje**

Blerësi, pa cenuar ndonjë mjet tjetër ligjor në lidhje me shkeljen e Kontratës, mundet me anë të një Njoftimi me shkrim për mospërmbushje që i dërgohet Furnizuesit, ta përfundojë Kontratën në tërësi ose pjesërisht:

(i) nëse Furnizuesi nuk ka përmbushur detyrimin edhe pas Njoftimit të bërë sipas pikës 23.1 të këtij neni;

(ii) Nëse Furnizuesi nuk ka arritur të kryejë Shërbimet brenda periudhës së specifikuar në Kontratë, ose brenda ndonjë zgjatjeje të dhënë nga Blerësi në përputhje me Nenin 22; ose

(iii) Nëse provohet se Furnizuesi është angazhuar në Praktika të Ndaluara, siç përcaktohet në Nenin 2, gjatë konkurrimit për Kontratën apo ekzekutimit të saj.

**23.3 Ndërprerja për paaftësi paguese**

Blerësi ndërpret në çdo kohë Kontratën duke njoftuar Furnizuesin nëse Furnizuesi falimenton. Furnizuesi ndërpret në çdo kohë Kontratën nëse Blerësi nuk ka aftësi paguese. Në një rast të tillë, ndërprerja do të bëhet pa kompensim për Furnizuesin, me kusht që kjo ndërprerje nuk do të cenojë ose ndikojë në ndonjë të drejtë padie apo mjeti ligjor që ka lindur apo do të lindë më pas për Blerësin.

**23.4**

**Ndërprerja për Shkak të Interesit Publik**

a) Blerësi mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik.

b) Blerësi duhet të njoftojë me shkrim Furnizuesin për ndërprerjen.

c) Blerësi duhet të paguajë Furnizuesin për të gjitha Shërbimet e kryera përpara ndërprerjes dhe duhet t'i paguajë Furnizuesit dëmet e shkaktuara për kryerjen e pjesshme të Shërbimeve. Në llogaritjen e shumës së dëmeve, Furnizuesit do t'i kërkohet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet.

**Neni 24 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

**24.1** Blerësi dhe Furnizuesi do të bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore përmes bisedimeve të drejtpërdrejta çdo mosmarrëveshje që lind midis tyre gjatë ekzekutimit të Kontratës.

**24.2** Nëse, palët nuk arrijnë të zgjidhin mosmarrëveshjen e tyre me një konsultim të tillë të ndërsjellë, atëherë secila Palë mund t'i njoftojë Palës tjetër për qëllimin e saj për të shkuar në Gjykatë.

## Shtojca 16

**Kushtet e Veçanta të Kontratës**

Kushtet e mëposhtme të veçanta të Kontratës do të plotësojnë KPK. Nëse ka një konflikt, dispozitat e KVK do të mbizotërojnë mbi ato në KPK.

**Neni 1 Dispozitat e Përgjithshme**

**1.1** Blerësi është: ***[vendos emrin e Blerësit ]***

Adresa: ________________________________________

Telefoni: ________________________________________

Numri i faksit: ________________________________________

E-mail: ________________________________________

**1.2** Furnizuesi është: ***[vendos emrin e Furnizuesit]***

Adresa: ________________________________________

Telefoni: ________________________________________

Numri i faksit: ________________________________________

E-mail: ________________________________________

*Të dhënat e mësipërme duhet të jenë të sakta për qëllime të komunikimeve gjatë zbatimit të kontratës.*

**1.3** Gjuha për komunikimet është ***[specifiko gjuhën për komunikime]****:*

Gjuha është: ***[specifiko gjuhën]***

**Neni 2 Sigurimi i Kontratës**

**2.1** Sigurimi i Kontratës në shumën prej *(10% të vlerës së saj)* duhet të ofrohet nga Furnizuesi për të siguruar ekzekutimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.

**2.2** Monedha do të jetë: ***[*****specifikoni monedhën*****]***

**2.3** Sigurimi i Kontratës do t'i lëshohet ose kthehet, menjëherë Furnizuesit sipas formularit të mëposhtëm

**2.4** Nëse parashikohet një ulje periodike e sigurimit të Kontratës, ajo kryhet si më poshtë: ________________________________________________________________________

*Nëse nuk plotësohet, sigurimi mbetet i pandryshuar.*

**Neni 3 Vendndodhja e Shërbimeve**

**3.1** Shërbimet do të kryhen në: ________________________________

**Neni 4 Informacion që duhet dhënë nga Blerësi**

**4.1** Brenda 15 ditësh nga marrja e sigurimit të kontratës, Blerësi duhet t'i japë Furnizuesit informacionin dhe dokumentat e mëposhtme:

5.1

## Neni 5 Kërkesat e Raportimit

Gjatë zgjatjes së kontratës, Furnizuesi duhet të sigurojë raporte për Blerësin sipas formularit të mëposhtëm: ___________________________________________________________________________

**Neni 6 Siguracioni i Përgjegjësisë Profesionale**

**6.1** Përpara fillimit të zbatimit të kontratës, Kontraktuesi duhet të sigurojë Autoritetin/entin Kontraktor me prova për siguracionin e përgjegjësisë profesionale me shumë minimale si vijon: ___________________________________________________________________________

**Neni 7 Çmimi i Kontratës**

**Çmimi i Kontratës është: _________________________**

**8.1**

**Neni 8 Kushtet e pagesës**

(a) Pagesa për Shërbimet do të bëhet brenda _________ ditëve nga data e pranimit të Shërbimeve ose nga data e marrjes së kërkesës për pagesë me shkrim, pavarësisht nga dita e ardhjes. Nëse nuk specifikohet, periudha kohore do të jetë 30 ditë.

(b) Pagesa do të bëhet në monedhën______. Nëse lihet e paplotësuar, pagesa do të bëhet në monedhën Shqiptare.

**8.2** Të gjitha pagesat e shumave që i detyrohen Furnizuesit mund të bëhen vetëm në llogarinë bankare të Furnizuesit të detajuar në mënyrë të qartë në Kontratë.

**9.1** **Neni 9 Garancia**

Periudha e vlefshmërisë së garancisë do të jetë si më poshtë:

**Shtojca 17**

[ *Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik*]

**FORMULARI I SIGURIMIT TË KONTRATËS**

*[Data]*

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit: *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[ objekti]*

Publikimi *(nëse zbatohet):* Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, dhe me kusht që [*emri i ofertuesit të përcaktuar fitues*] t'i jetë akorduar kontrata,

Ne vërtetojmë se [*emri i ofertuesit të përcaktuar fitues*] ka derdhur një depozitë pranë [*emri dhe adresa e bankës / kompanisë së sigurimeve*] në një shumë prej [*monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra*] si kusht për sigurimin e ekzekutimit të kontratës, që do të nënshkruhet me [*emri i autoritetit/entit kontraktor*]

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [*emri i autoritetit /entit kontraktor*] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mos-përmbushjen e kushteve të kontratës.

Ky Sigurim është i vlefshëm deri në zbatimin plotë të kontratës.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimeve]

## Shtojca 18

# Draft i Marrëveshjes Kuadër (Ku përcaktohen të gjitha kushtet)

**PER PUNË / MALLRA/ SHËRBIME**

[Përdorimi i kësaj drafte marrëveshje është i detyrueshëm për të gjithë autoritetet/entet kontraktore që do të përdorin Marrëveshjen Kuadër]

**Nr . __**
**datë :**

Kjo Marrëveshje është lidhur më [datë] ndërmjet [emri dhe adresa e Autoritetit /Entit Kontraktor], këtu e tutje referuar si "Autoriteti /Enti Kontraktor" dhe [emri dhe adresa e Kontraktorit] përfaqësuar nga [përfaqësuesi], këtu e më tej referuar si "Kontraktori ".

Kontraktori, përmes ofertës së tij, me datë [data] pajtohet të furnizojë shërbimet, siç specifikohet në kushtet e përcaktuara në:
-Këtë Formular;
-Formularin e Deklarimit të Ofertës të paraqitur nga Ofertuesi;
Specifikimet Teknike;
Listën e Çmimeve të Sherbime.

Të gjitha këto dokumente janë të bashkangjitura, si pjesë integrale e kësaj marrëveshje.

**Neni 1 Objekti**

1.1 Objekti i Marrëveshjes Kuadër është të përcaktojë kushtet, përfshirë çmimet për njësi dhe rregullat për dërgimin e mallrave / shërbimeve / punëve të mëposhtme.

[ Përshkrim i përgjithshëm ]

1.2 Marrëveshja Kuadër do të zbatohet duke dërguar ftesa për oferta tek Operatorët Ekonomikë, palë në marrëveshje sipas nevojave të Autoritetit/entit kontraktor.

1.3 Shumat e dhëna këtu janë vetëm për qëllime orientimi dhe NUK e detyrojnë Autoritetin/Entin Kontraktor t'i blejë ato. Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të blejë më pak ose më shumë sasi sesa ato të parashikuara.

1.4 Kontraktori nuk do të ketë të drejtë për kompensim dhe nuk do të lejohet të bëjë ndryshime në çmimet për njësi, për shembull nëse Autoriteti/Enti Kontraktor vendos të blejë më pak ose më shumë sasi sesa ato të parashikuara të specifikuara dhe / ose nëse Autoriteti/enti Kontraktor vendos të mos blejë cilëndo nga këto sasi për disa artikuj.

1.5 Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuadër:_______________________________________________

**Neni 2 Çmimi**

2.1 Çmimet për njësi për punë / mallra / shërbime përshkruhen në Listen e Çmimit të Sherbime.

2.2 Çmimet për njësi do të jenë fikse dhe nuk do të ndryshojnë për porositë e bëra në bazë të kësaj Marrëveshje Kuadër.

**Nënshkrimet dhe datat**

**Për Kontraktorin** **Për Autoritetin /Entin Kontraktor**

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Emri:** | | **Emri:** | |
| Pozicioni: | | Pozicioni: | |
| Firma: | | Firma: | |
| Data: | | Data: | |
| **Vula:** | | **Vula:** | |

## Shtojca 19

# Draft Marrëveshja Kuadër (Ku nuk përcaktohen të gjitha kushtet)

**PËR PUNËT/ MALLRAT / SHËRBIMET**

Emri i Autoritetit/Enti Kontraktor,

dhe

Emri i Kontraktorit

Bien dakord si më poshtë:

**Të nënshkruajnë Marrëveshjen Kuadër për objektin**: <shëno titullin> me numrin identifikues: <*shëno numrin e prokurimit*>

**Neni 1 Objekti**.
1 Objekti i kësaj marrëveshje kuadër është të vendosë rregullat për kontratat që do të lidhen përmes procesit të Mini – konkurrimit vetëm midis Operatorëve Ekonomik që janë palë në këtë Marrëveshje Kuadër.

1.2 Kjo Marrëveshje Kuadër nuk është një kontratë në vetvete, por përcakton kushtet për kontratat që do të lidhen, bazuar në të.

1.3 Kontraktori është vetëm një prej palëve të Marrëveshjes Kuadër.

**Neni 2 Detyrimet e Palëve**

2.1 Autoriteti /Enti Kontraktor, palë në këtë marrëveshje, do t'i dërgojë Kontraktuesit një "Ftesë për Ofertë" sa herë që ka nevojë për punë / mallra / shërbime.

2.2 Kontraktori është i detyruar të paraqesë një Ofertë sa herë që kërkohet nga Autoriteti /enti Kontraktor.

### Neni 3 Kontratat në zbatimin e Marrëveshjes Kuadër

1.1 Kontratat do të nënshkruhen vetëm pas procesit të mini-konkurrimit.

**Neni 4 Procesi i mini-konkurrimit**

4.1 Procesi i mini-konkurrimit do të zhvillohet me të gjithë operatorët ekonomik, palë në Marrëveshjen Kuadër, kurdoherë që ka nevojë për punë / mallra / shërbime nga ana e Autoritetet/entet Kontraktore.

4.2 Autoriteti/Enti Kontraktor do të rihapë konkurrimin në të njëjtat kushte ose kushte të tjera të përcaktuara në Ftesën për Oferta, siç përcaktohet në Dokumentet e Tenderit.

4.3 Sa herë që ka nevojë për punë / mallra / shërbime, Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit Ftesat për Oferta dhe i dërgon ato te të gjithë Operatorët Ekonomik, palë në Marrëveshjen Kuadër. Vlerësimi i Ofertave do të bazohet në kriteret e përcaktuara në Ftesën për Oferta.

**Neni 5 Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuadër ___________________________________**

**Firmat dhe Data______________________________________________________________**

**Për Kontraktorin** **Për Autoritetin/Entin Kontraktor**

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Emri:** | | **Emri:** | |
| Pozicioni: | | Pozicioni: | |
| Firma: | | Firma: | |
| Data: | | Data: | |
| **Vula:** | | **Vula:** | |

## SEKSIONI IV

## Ankimi dhe Njoftimet për mbylljen e procesit

**Shtojca 20**: Formulari i Ankesës pranë Autoritetit/Entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

**Shtojca 21**: Formulari i paraqitjes së argumentave nga operatorët ekonomikë të interesuar pranë Autoritetit/Entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

**Shtojca 22** : Njoftimi i Kontratës së nënshkruar

**Shtojca: 23** : Njoftimi i kontratës së nënshkruar që publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike

**Shtojca 24:** Formulari i anulimit te procedurës

**Shtojca 20**

## FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Ankesë drejtuar: Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik ☐

**Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit**

*Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatoresh ekonomike)*

________________________________________
Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

________________________________________
Nuis/Nipt

________________________________________
Adresa

| | | |
|---|---|---|
| Qyteti | Shteti | Kodi Postar / Posta |

| | |
|---|---|
| Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës) | Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës) |

________________________________________
E-mail

________________________________________
Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

| | |
|---|---|
| Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar | Data (viti/muaji/dita) |
| Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës) | Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës) |

**Seksioni II. Informacion mbi procedurën**

1. **Numri i referencës së procedurës/Lotit**

*Plotësoni numrin e references se kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentet e tenderit.*

2. **Lloji i Procedurës**

*Plotësoni llojin e procedurës së përdorur për prokurimin në fjalë.*

| | |
|---|---|
| Procedurë e hapur ☐ | Procedurë e hapur e thjeshtuar ☐ |
| Procedurë e kufizuar ☐ | Procedurë konkurruese me negocim ☐ |
| Partneritet për inovacion ☐ | Dialog konkurrues ☐ |
| Procedurë me negocim me shpallje paraprake të njoftimit ☐ | Procedurë me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës ☐ |
| Shërbim Konsulence ☐ | |
| Kontratë e lidhur pa zhvilluar ndonjë nga procedurat e prokurimit të parashikuara në LPP ☐ | |

3. Autoriteti /Enti Kontraktor

*Emri i autoritetit/entit kontraktor që administron procesin e prokurimit.*

---

4. Vlera e përllogaritur e prokurimit

(*Vlera e përllogaritur e kontratës/marrëveshjes kuadër) (shuma në shifra dhe fjalë)*

---

5. Objekti i kontratës/Marreveshjes Kuadër

(*Përshkrimi i shkurtër i punëve / mallrave / shërbimeve objekt kontrate/marreveshje kuader).*

---

6. Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

(*Data (viti/muaji/dita*)

7. Data e publikimit te Njoftimit te Fituesit
(*Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme*)

8. **Data e nënshkrimit të kontratës**

(*Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavlefshmërinë e kontratës*)

**Seksioni III. Përshkrimi i ankesës**

1.Baza ligjore (Shkelje ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)

2. **Objekti i ankesës**

- Modifikim i dokumentave të tenderit

☐

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj.

☐

*(Citoni këtu arsyet e skualifikimit)*

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/disa operatori/ve ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

☐

*(Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime)*

- Pavlefshmëri kontrate

☐

*(Citoni kontratën për të cilën kërkoni pavlefshmërinë)*

- Tjetër

☐

*(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)*

**3. Rrethanat dhe faktet**
*Përshkruani rrethanat e faktit.*

**4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara**
*Përshkruani në mënyrë koncize shkelejt e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit/entit kontraktor.*

**5. Kërkesë për ekspertizë të posacme**

| Po | Jo |
|---|---|
| ☐ | ☐ |

*(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkoni)*
________________________________________________________________________
________________________________________________________________________

**6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:**

________________________________________________________________________
________________________________________________________________________

7. **Lista e informacionit konfidencial**:
________________________________________________________________________

________________________________________________________________________

*Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes.*

***Kujdes :Ankimuesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/ entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik***

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit /Enti Kontraktor dhe Komisionit te Prokurimit Publik.**

Shënim: Ankimuesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/ entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

**Nr. i faksit:**

**E-mail:**

**Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit**

**Administratori/ Përfaqësuesi i autorizuar**

**Shtojca 21**

## FORMULARI I PARAQITJES SË ARGUMENTAVE NGA OPERATORËT EKONOMIKË TE INTERESUAR PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

**Paraqitja e argumentave nga operatorët ekonomikë të interesuar drejtuar**:

Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik ☐

**Seksioni I. Identifikimi i Operatorit/ëve Ekonomikë/Bashkimit të operatorëve ekonomikë**

___

Emri i plotë i Operatorit Ekonomik/Operatorëve Ekonomikë (ju lutem shtypeni)
Nuis/Nipt

___

Adresa

___ ___ ___

Qyteti Shteti Kodi Postar / Posta

___ ___

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës) Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

___

E-mail

___

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për dërgimin e këyre kundërshtimeve (ju lutemi shkruani)

___ ___

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar Data (viti/muaji/dita)

___ ___

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës) Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

**Seksioni II. Informacion mbi procedurën**

1. Numri i referencës së procedurës/Lotit

___

*Plotësoni numrin e references se kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentet e tenderit.*

---

**2. Lloji i Procedurës**

| | |
|---|---|
| Procedurë e hapur ☐ | Procedurë e hapur e thjeshtuar ☐ |
| Procedurë e kufizuar ☐ | Procedurë konkurruese me negocim ☐ |
| Partneritet për inovacion ☐ | Dialog konkurrues ☐ |
| Procedurë me negocim me shpallje paraprake të njoftimit ☐ | Procedurë me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës ☐ |
| Shërbim Konsulence ☐ | |

3. Autoriteti /Enti Kontraktor
*Emri i autoritetit/entit kontraktor që administron procesin e prokurimit.*

---

4. Vlera e përllogaritur e prokurimit

___________________________________________________________

*Vlera e përllogaritur e kontratës/* Marrëveshjes Kuadër *(shuma në shifra dhe fjalë)*

5. Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër

___________________________________________________________

*Përshkrimi i shkurtër i punëve / mallrave / shërbimeve objekt kontrate/marreveshje kuader.*

6. Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

___________________________________________________________

Data (viti/muaji/dita)

7. Ankesa që po shqyrtohet:

(*emri i Operatorit ekonomik që ka paraqitur ankesë për këtë procedurë prokurimi*)

____________________________________________

8. Data e Publikimit të Njoftimit të Fituesit

Data (viti/muaji/dita)

**Seksioni III. Argumentat mbi ankesën e paraqitur nga Operatori/ët ekonomikë**

1. Baza ligjore

(Shkelje/arsyetime ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)

2. Deklaratë e hollësishme e argumenteve mbi ankesën e paraqitur

*Jepni një deklaratë të hollësishme të fakteve dhe argumenteve që mbështesin argumentimet tuaja. Për çfarëdo arsye, specifikoni datën në të cilën u vutë në dijeni për faktet e lidhura me arsyet e ketyre srgumenteve. Përmendni seksionet përkatëse të Dokumenteve të Tenderit, nëse është e zbatueshme. Përdorni faqe shtesë nëse është e nevojshme.*

3. Lista e informacionit konfidencial

*Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes.*

Dërgojeni formularin e plotësuar të argumentimevemeve tuaja, si dhe të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit /Enti Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik**

**Shënim: Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentat e tyre që kundërshtojnë ankesën, sipas parashikimeve të LPP, nuk mund të ushtrojnë më pas të drejtën e ankimit për vendimin e dhënë lidhur me ankesën për këtë procedurë prokurimi.**

**Nr. i faksit:**

**E-mail:**

**Nënshkrimi dhe vula e Operatorit /eve Ekonomikë**

**Shtojca 22**

# Formulari i Njoftimit të Kontratës së Nënshkruar

**Seksioni 1 Autoriteti/Enti Kontraktor**

## 1.1 Emri dhe adresa e Autoritetit /Entit Kontraktor

Emri ______________________________

Adresa ______________________________

Tel/Faks ______________________________

E-mail ______________________________

Ueb-faqe ______________________________

**I.2 Lloji i Autoritetit/Entit Kontraktor:**

| | |
|---|---|
| Institucion qendror ☐ | Institucion i pavarur ☐ |
| Njësia e Qeverisjes Vendore ☐ | Të tjera ☐ |

1.3 **Kategoria e Autoritetit/Entit Kontraktor:**

| | |
|---|---|
| Autoritet/ent kontraktor që prokuron për nevoja të veta ☐ | Organ Qendror blerës ☐ |
| I deleguar ☐ | Të tjera ☐ |

**Seksioni 2. Objekti i Kontratës**

**2.1 Numri i referencës së procedurës / Lotit**

______________________________

**2.2 Lloji i Kontratës: "Kontratë Publike për Shërbime"**

**2. Kontratë në bazë të Marrëveshjes Kuadër**

Po ☐ Jo ☐

**Nëse Po, lloji i Marrëveshjes Kuadër**

**Me një Operator Ekonomik** ☐

**Me disa operatorë ekonomik** ☐

**Të gjitha kushtet janë të vendosura** Po ☐ Jo ☐

**2.4 Përshkrimi i shkurtër i kontratës**

2. Fondi limit________________________________________________
3. Burimi i financimit ____________________________________________
4. Objekti i Kontratës ______________________________

**2. 5 Kohëzgjatja e Kontratës ose afati i përfundimit:**

Kohëzgjatja në **muaj** ☐☐☐ **ose ditë** ☐☐☐☐

ose

Duke nisur ☐☐/☐☐/☐☐☐☐ dhe përfunduar në ☐☐/☐☐/☐☐☐☐

**2.6 Ndarja në LOTE:**

Po ☐ Jo ☐

*Nëse po,* numri i LOTEVE**:** ☐☐

**2.7 Kontrata me nënkontraktim:**

Po ☐ Jo ☐

**Seksioni 3.** **<u>Procedura</u>**

**3.1 Lloji i procedurës: E hapur**

**3.2 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:**

**A) oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto □**

Sipas rëndësisë: Çmimi □□ **pikët □**

etj. □□ **pikë**

*ose*

**B) oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim □**

**3.3 Numri i ofertave të paraqitura: □□□**

**Numri i ofertave të rregullta: □□□**

**3.4. Gjatë procesit të prokurimit në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) janë përdorur standardet e përgatitura nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit:**

Po □ Jo □

**3.5. Gjatë procesit të prokurimit në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK), kur standardet nuk janë të zbatueshme, aprovimi paraprak merret nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit.**

Po □ Jo □

**Seksioni 4** **<u>Informacion rreth Kontratës</u>**

**4.1 Numri i kontratës: ___________________________________ Data e kontratës** □□/□□/□□□□

**4.2 Emri dhe adresa e Kontraktorit**

Emri ___________________________________________________________________

Adresa ___________________________________________________________________

Nipti ___________________________________________________________________

Tel/Faks

E-mail ______________________________________________

Ueb-faqe ______________________________________________

4.2.1 **Emri dhe adresa e nënkontraktorit**

Emri ______________________________________________

Adresa ______________________________________________

Nipti ______________________________________________

Tel/Faks

E-mail ______________________________________________

Ueb-faqe ______________________________________________

**4.3 Vlera totale përfundimtare e Kontratës** *(përfshirë shumë, opsione dhe nënkontraktime):*

Vlera ____________ *(pa TVSH)* Monedha ____________________

Vlera ____________ *(me TVSH)* Monedha ____________________

**4.3.1** Vlera totale e **nënkontraktimit:** ____

Vlera ____________ *(pa TVSH)* Monedha ____________________

Vlera ____________ *(me TVSH)* Monedha ____________________

**4.4 Informacion Shtesë**

______________________________________________

______________________________________________

Data e dorëzimit të këtij njoftimi □□/□□/□□□□

**Shtojca 23**

*[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike]*

# Formulari i Njoftimit të Kontratës së Nënshkruar

**1. Emri dhe adresa e Autoritetit /Enti Kontraktor**

Emri ______________________________

Adresa ______________________________

Tel/Faks ______________________________

E-mail ______________________________

Ueb-faqe ______________________________

**2. Lloji i procedurës: ______________________________**

**3. Objekti i kontratës ______________________________**

**4. Numri i referencës së procedurës / Lotit ______________________________**

**5. Fondi Limit**

**______________________________**

**6. Vlera totale përfundimtare e kontratës (***përfshirë Lotet, opsionet dhe nënkontraktimin)*:

Vlera ______________ *(me TVSH)* Monedha ______________

Vlera e nënkontraktimit ______________ *me TVSH* Monedha ______________

**7. Data e nënshkrimit të kontratës**

**______________________________**

**8. Emri dhe adresa e Kontraktorit / nënkontraktorit**

Emri ______________________________

Adresa ______________________________

Numri i NIPT-it ______________________________

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)*

**Shtojca 24**

# Formulari i Njoftimit të Anulimit

**1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor**

Emri ______________________________

Adresa ______________________________

Tel/Faks ______________________________

E-mail ______________________________

Ueb-faqe ______________________________

**2. Lloji i procedurës: ______________________________**

**3. Numri i Referencës së procedurës/lotit:**

**4. Objekti i Kontratës ______________________________**

**5. Fondi Limit______________________________**

**6. Arsyet e Anulimit:**

Bazuar në Ligjin Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", Neni 98, pika 1:

**a) ;**
**b) ;**
**c) ;**
**ç) ;**
**d) ;**
**Etj. ______________________________**

**7. Informacion shtesë**

______________________________
______________________________

Data e dorëzimit të këtij njoftimi